

bulevardi: Gjergj Fishta, (ish npv nr.2)
tel: 068 20 16 616
info@uet.edu.al
www.uet.edu.al



DOSJA E VETËVLERËSIMIT

TIRANË, JANAR – SHKURT 2009

TABELA E LËNDËS

HYRJJE

MENDIMI ME SHKRIM I REKTORIT TË UNIVERISTETIT EUROPIAN TË TIRANËS

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

PJESA E PARË: PJESA PËRSHKRUESE

- I. Misioni dhe Objektivat e UET, programi, kurrikula etj.
- II. Struktura organizative e UET, njësitë përbërëse dhe menaxhimi i tij
- III. Analiza e kurseve të studimit, diplomave, masterave etj.
- IV. Programet e studimit, organizimi i kurrikulave, kreditet
- V. Stafi mësimdhënës dhe mbështetës
- VI. Mësimdhënia
- VII. Kërkimi shkencor
- VIII. Studentët dhe pasuniversitarët (klientët)
- IX. Fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit
- X. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare
- XI. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë
- XII. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun e tregun e punës
- XIII. Analiza SWOT

PJESA E DYTË: INFORMACIONE SASIORE

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR NË MBËSHTETJE TË VLERËSIMIT

HYRJE

Vetëvlerësimi është faza e parë e vlerësimit. Ai është ndërmarrë nga stafi i Universitetit European të Tiranës, në kuadrin e një procesi periodik vlerësimi dhe akreditimi. Kjo përputhet edhe me qëllimet e vetë UET-it.

Ky proces i rëndësishëm ka kaluar në disa hapa:

- Takimi i APAAL me stafin e UET-it dhe njohja me afatet dhe detyrimet e vlerësimit.
- Ngritja e Grupit të Vetëvlerësimit dhe funksionimi i tij është kryer në përputhje me Udhëzimin e miratuar nga Senati, më datë 02.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe organizimit të sistemit të vlerësimit të brendshëm”¹.

Në zbatim të këtij Udhëzimi, Grupi i Vetëvlerësimit është ngritur nën përgjegjësinë e Rektorit, pasi ky i fundit ka marrë mendimin edhe të Senatit. Në përzgjedhjen e grupit të vetëvlerësimit janë pasur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria dhe mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit. Brenda grupit janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo anëtar. Në Grupin e Vetëvlerësimit është përfshirë edhe Kryetari i Këshillit Studentor.

Synohet që grupi i vetëvlerësimit të kthehet në një grup vlerësimi permanent dhe të institucionalizuar. Në terma afatgjatë, krijimi i një përvoje të vlerësimit do të shërbejë si një hap i rëndësishëm për të ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UET dhe instalimin e kulturës së cilësisë.

Grupi i Vetëvlerësimit ka përgatitur Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës është dhe Raporti i Vetëvlerësimit.

- Grupi i Vetëvlerësimit është trajnuar nga stafi i APAAL dhe i janë vënë në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe të punës në grup, si dhe njohja me procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
- Vetëvlerësimi është kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të udhëzimeve të dhëna nga APAAL. Grupi i Vetëvlerësimit ka qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues dhe specialistë të APAAL dhe ka ndërur nga afër asistencën e tyre, sa herë kjo ka qenë e nevojshme.
- Produkt i këtij procesi të vetëvlerësimit është Dosja e Vetëvlerësimit, në përbërje të së cilës, vend qendror zë Raporti i Vetëvlerësimit, i cili është hartuar në përputhje dhe zbatim të udhëzimeve të APAAL dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e UET-it. Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit janë përfshirë:
 - Mendimi me shkrim i Rektorit;
 - Raporti i Vetëvlerësimit, i ndarë në dy pjesë:
 - Pjesa e Parë: Pjesa përshkuese e raportit
 - Pjesa e Dytë: Informacione sasiore
 - Dokumentacioni i kërkuar në mbështetje të vlerësimit

¹ Shih në dokumentet mbështetës bashkëngjitur këtij Raporti

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Gjatë gjithë procesit të përgatitjes së raportit, Grupi i Vetëvlerësimit ka pasur parasysh që të përfshijë në raport mendimet më të vyera të stafit akademik dhe atij ndihmës, si dhe të studentëve, çka ka shërbyer edhe si një fushatë informimi në lidhje me përmbajtjen e raportit. Për mbledhjen e mendimeve të stafit dhe studentëve janë organizuar takime formale dhe informale, ndërsa njohja përfundimtare me Raportin e Vetëvlerësimit është bërë në një takim të të gjithë njësisë ku janë diskutuar të dhënat, mendimet, komentet dhe rekomandimet e shprehura në raport. Edhe në këtë fazë, Grupi i Vetëvlerësimit ka qenë i hapur ndaj mendimeve të ndryshme dhe ka përfshirë në versionin përfundimtar të raportit mendimet, sugjerimet apo komentet e argumentuara.

Në mbyllje të fazave të mësipërme, është hartuar versioni përfundimtar i Raportit të Vetëvlerësimit.

MENDIMI ME SHKRIM I REKTORIT TË UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

Në mendimin me shkrim të Rektorit të Universitetit Europian të Tiranës janë dhënë opinionet e tij personale mbi arritjet e UET-it, hapësirat ku mund të bëhen përmirësime të mëtejshme, si dhe vizionin afatgjatë të zhvillimit. Po ashtu, Rektori ka shprehur mendimin e tij rreth programit, kurrikulës si dhe diplomave që lëshon institucioni që ai drejton.

Universiteti Europian i Tiranës (UET) është hapur dhe ushtron aktivitetin e tij në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 636, datë 20.09.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Private "Universiteti Europian i Tiranës"; VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, "Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë shkollës së lartë universitare private "Universiteti Europian i Tiranës" si dhe lejes së posaçme për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, të dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 74, date 21.1.2009, "Për hapjen e hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë në Shkollën e Lartë Universitare Private "Universiteti Evropian i Tiranës".

UET-i është ndërtuar dhe funksionon totalisht në përputhje me kërkesat e "Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", detyrimeve të procesit të Bolonjës dhe sfidave të garantimit të cilësisë në çdo hallkë e aktivitetit të tij. UET e zhvillon aktivitetin e tij duke u mbështetur në strategjinë e tij të zhvillimit, synimet kryesore të së cilës janë : (1)garantimin e funksionimit të gjithë sistemit në përputhje të plotë me «Procesin e Bolonjës» dhe kërkesat e ligjit «Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë», (2) plotësimin e programeve dhe ofrimin e të tri cikleve të studimit së bashku me diplomat përkatëse (DNP, DND, MNP, MND, Doktoraturë); (3) konsolidimin e personelit akademik të brendshëm dhe atij ndihmës me pedagogë me tituj dhe grada shkencore; (4) konsolidimin e gjithë strukturave pedagogjike, kërkimore-shkencore e administrative; (5) krijimin e kushteve dhe shërbimeve sa më të plota e cilësore për studentët dhe pedagogët; etj.

Aktualisht, UET-i përbëhet nga tre fakultete dhe konkretisht: Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik në të cilët studiojnë 1354 studentë, shifër kjo tetë herë më e lartë se numri i studentëve në vitin e parë të fillimit të universitetit. UET ka 131 pedagogë nga të cilët 35 të brendshëm dhe 96 të jashtëm të ndihmuar nga 39 punonjës të strukturave administrative, ekip që garanton një funksionim mjaft cilësor të institucionit. UET-i ofron 9 programe studimi të ciklit të parë (DNP) dhe 7 programe studimi (të ndarë në 15 profile) të ciklit të dytë (DND) dhe 11 programe Master të nivelit të parë (MNP), të ndarë në 19 profile, ndërkohë që po përgatitet për aplikimin dhe fillimin e dhe të programeve të ciklit të tretë (MND dhe Doktoraturë).

Qëllimi kryesor i UET-it është realizimi i një procesi mësimdhënës sa më efektiv duke synuar transmetimin tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor, për t'i bërë ndër të tjera, të diplomuar cilësorë sa më të përshtatur e të kërkuar në tregun e punës. Në funksion të këtij qëllimi, UET-i i kushton një vëmendje të veçantë edhe aftësisë të pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor e botues, si dhe përfshirjen sa më të gjerë të studentëve në këtë proces. Kërkesat ndaj stafit akademik në raport me kualifikimin akademik-pedagogjik të tyre janë maksimale, ndërkohë që edhe vetë UET-i zhvillon një proces të kualifikimit të vazhdueshëm me të gjithë stafin akademik dhe atë ndihmës.

Politika dhe vendim-marrja në UET zhvillohen në përputhje me respektimin e të drejtave dhe detyrave të miratuara të të gjithë organeve përbërëse të saj. I gjithë procesi i vendim-marrjes dhe kompletimit të strukturave është zhvilluar në një dinamikë intensive, sidomos gjatë dy viteve të fundit duke arritur që aktualisht UET-i të jetë i kompletuar në këtë drejtim. Detyrat, të drejtat, fushat e kompetencës dhe mënyrat e funksionimit të organeve vendim-marrëse janë të përcaktuara e miratuara konform kërkesave të "Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", akteve nënligjore, rregulloreve e

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

udhëzimeve specifike të MASH-it, statutit, rregulloreve dhe udhëzimeve të veçanta, etj. Politikën kryesore të zhvillimit dhe rekomandimet me karakter strategjik i realizon Bordi i Besimit, si organi bazë këshillues i UET-it.

Drejtimi dhe vendim-marrja realizohet tërësisht nga organet drejtuese të tij si: Senati Akademik, Rektorati, Këshillat e Fakulteteve, Këshilli i Etikës, dhe autoritetet drejtuese si Rektori, Dekanët dhe Përgjegjësit e departamenteve. Për sa i përket kërkimit shkencor, vendim-marrja realizohet nga drejtorët e Instituteve të kërkimit dhe përgjegjësit e Qendrave të Kërkimit.

Raporti i vetëvlerësimit mendoj se shpreh në mënyrë të detajuar e reale situatën, ecurinë dhe problematikën e funksionimit të UET-it. Aty analizohen dhe jepen me detaje të gjitha aspektet akademike, ligjore e organizative, duke filluar nga strategjia e objektivat e tij, vazhduar me problematikën e përditshme të funksionimit të të gjithë hallkave e strukturave të tij, ecurinë dhe dinamikën gjatë tre viteve të ekzistencës së UET-it. Në raport janë pasqyruar me vërtetësi si anët pozitive të funksionimit dhe ecurisë së UET-it ashtu dhe dobësitë e sfidat kryesore për të ardhmen, duke e bërë atë një dokument real e mjaft të vlefshëm për të gjykuar e vlerësuar stadin aktual të tij, cilësinë dhe dinamikën e ndryshimeve gjatë kësaj periudhe pothuajse 3 vjeçare të ekzistencës së tij, si dhe mbi të gjitha, evidentimin e dobësive, duke propozuar dhe masat përkatëse për rregullimin e shpejtë e përfundimtar të tyre.

REKTORI

Prof. Asoc. Dr. Adrian CIVICI

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

Raporti i Vetëvlerësimit përbëhet nga dy pjesë: (i) Pjesa përshkuese dhe (ii) Pjesa e treguesve të matshëm me të dhënat sasiore (referuar materialit të APAAL "Aspektet dhe Treguesit e Vlerësimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", Janar 2005)

PJESA E PARË: PJESA PËRSHKRUESE

Në pjesën e parë, Grupi i Vetëvlerësimit ka përshkruar UET-in si institucion të arsimit të lartë, programin, kurrikulën dhe diplomën/at në përputhje me aspektet e vlerësimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Më konkretisht në këtë pjesë janë përshkruar:

- I. *Misioni dhe Objektivat e UET-it*, ku është pasur parasysh të sqarohen qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për UET-in (historiku, statusi, të dhëna numerike për punonjësit, për numrin e studentëve, për kurset e studimit të niveleve të ndryshme, të dhëna për vendin e UET-it në kuadrin kombëtar e ndërkombëtar, etj.
- II. *Struktura organizative e UET-it, e njësive përbërëse dhe menaxhimi i tij*, duke pasur fokus të veçantë skemën organizative, organizimin hierarkik, çështje të politikave në nivelin e vendimmarrjes, cilësia e stafit mbështetës, përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, kontratat e punës dhe marrëdhëniet e tjera të punës, mbledhja dhe përdorimi i informacionit për personelin, etj.
- III. *Analiza e kurseve të studimit, diplomave, masterave, etj.* Në këtë komponent është pasur parasysh të sqarohen të dhëna për pranimet, shpërndarjen e studentëve në kurset dhe vitet e studimit, të dhëna për ecurinë e studentëve dhe kalueshmërinë, të dhëna për stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm, koordinimi i mësimdhënies me institucione të tjera, etj.
- IV. *Programet e studimit, organizimi i kurrikulave, marrëveshja e Bolonjës, kreditet.* Konkretisht janë analizuar qëllimet e programeve të studimit, përmbajtja e programeve, shpërndarja e ngarkesës midis njësive të ndryshme mësimore, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor, harmonizimi i kursit të studimit, literatura dhe materialet e tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.
- V. *Stafi mësimdhënës dhe mbështetës:* struktura e stafit mësimdhënës në kurrikulën e çdo kursi studimi, raportet staf mësimor, staf ndihmës, student; nevojat për staf, shpërndarja e ngarkesës, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, të dhëna për kualifikimin e stafit, për moshën, kriteret e rekrutimit të tij, etj.
- VI. *Mësimdhënia*, duke u ndalur tek organizimi, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive, numri i studentëve në hyrje, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria dhe probleme të tjera që lidhen me të, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies.
- VII. *Kërkimi shkencor*, analiza e të cilit përmbledh politikat e kërkimit, botimet, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara, bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, lidhja e kërkimit me mësimdhënien, prania e kurseve master, pjesëmarrja institucionale apo individuale në to, vlerësime zyrtare të aktivitetit kërkimor individual ose për njësinë etj.

- VIII. *Studentët*, të cilët konsiderohen si një nga komponentët më të rëndësishëm në veprimtarinë e UET-it. Me këtë janë pasur parasysh procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, statistika, kontrolli i dijeve, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, informimi i studentëve etj.
- IX. *Fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit*. Koncretisht janë dhënë informacione rreth mjediseve, infrastrukturës, teknologjive të informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët etj.
- X. *Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare*, në të cilat janë përfshirë burimet e financimit, të dhëna në vite, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese, etj.
- XI. *Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë*, rëndësi e veçantë i është dhënë institucionalizimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, funksionimit të tij, vetëvlërësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, etj.
- XII. *Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun*, i cili ka të bëjë me kontaktet me mjedisin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, mobiliteti i stafit në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës etj.
- XIII. *Analiza SWOT*, e cila në mënyrë të përmbledhur pasqyron pikat e forta të UET-it, komponentët që kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm, mundësitë për t'u zhvilluar dhe risqet në kushtet e sotme të arsimit të lartë në vendin tonë. Kjo analizë shoqërohet me rekomandimet përkatëse që Grupi i Vetëvlërësimit u adreson strukturave drejtuese dhe gjithë stafit të UET-it. Të gjitha këto janë bërë në kontekstin e moshës së re të këtij institucioni të arsimit të lartë.

I. MISIONI DHE OBJEKTIVAT

a) Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor

Qëllimi themelor i UET-it *në fushën e mësimdhënies* është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter të theksuar praktik, duke realizuar ciklin «informacion-njohuri-dije-aftësi».

Qëllimi bazë i mësimdhënies është përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të aftë që të debatojnë e marrin vendime të sakta, të aftë që të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.

Ky objektivi realizohet: (1) duke përpunuar e seleksionuar programe disiplinash sa më cilësore për çdo lëndë e për çdo pedagog që zhvillon mësim në UET; (2) duke përdorur si literaturë bazë dhe plotësuese libra, autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës, të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar; (3) zhvillimi i leksioneve dhe seminareve bëhet me metoda e forma didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, duke përdorur gjerësisht prezantimet problemore, analizën logjike e sasiore, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj; (4) trajnimi i vazhdueshëm i stafit pedagogjik dhe atij ndihmës administrativ nëpërmjet seminareve, workshopeve e konferencave, për të qenë sa më performant në realizimin e objektivave të mësipërme; (5) zhvillimi i një pune të gjerë e me kontakte të vazhdueshme me studentët për t'iu shpjeguar qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies në UET, dhe njëkohësisht për t'i bërë ata sa më aktivë në këtë proces.

Qëllimi kryesor *i kërkimit shkencor* është pjesëmarrja dhe aftësimi i pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor, angazhimi i tyre sa më i gjerë në botime e studime shkencore, organizimi periodik i konferencave shkencore nga çdo departament, botimi i katër revistave shkencore (Polis, Jus & Justicia, Economicus, "Sociological Analysis" (Studime sociologjike, në anglisht), botimi i monografive, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët tanë, etj. Në UET funksionojnë gjithashtu institute të mirëfillta kërkimore-shkencore, disa grupe kërkimore, etj.

Qëllim tjetër i punës shkencore është vënia e rezultateve të kërkimit shkencor në shërbim të studentëve dhe procesit akademik.

Gjithashtu, një tjetër qëllim është angazhimi dhe përfshirja e studentëve në këtë proces duke synuar përgatitjen sa më të mirë të tyre edhe si kërkues të ardhshëm në fushën e shkencës e dijës.

b) Strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për arritjen e objektivave

Për realizimin e objektivave, është ndërtuar një strategji në tre nivele:

Strategjia afatshkurtër (1 – 3 vjeçare) synon: (1) konsolidimin dhe garantimin e funksionimit të gjithë sistemit në përputhje të plotë me «Procesin e Bolonjës» dhe kërkesat e ligjit «Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë», përfshirë këtu dhe udhëzimet dhe urdhëresat e veçanta të MASH-it apo Ministrive të tjera; (2) plotësimin e programeve dhe ofrimin e të tri cikleve të studimit së bashku me diplomat përkatëse (DNP, DND, MNP, MND, Doktoraturë); (3) konsolidimin e personelit akademik dhe atij ndihmës me pedagogë me tituj dhe grada shkencore të fituara në universitete prestigjioze brenda e

jashtë vendit; (4) plotësimin dhe konsolidimin e gjithë strukturave pedagogjike, kërkimore-shkencore e administrative; (5) krijimin e kushteve dhe shërbimeve sa më të plota e cilësore për studentët dhe pedagogët.

Strategjia afatmesme (3 – 5 vjeçare) synon: (1) garantimin e një stafi mësimor të qëndrueshëm e cilësor në masën mbi 75% i brendshëm; shtimin e konsiderueshëm dhe përmirësimin cilësor të ambienteve mësimore dhe atyre të shërbimit për studentët dhe pedagogët; (2) realizimin e mbi 10 marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa universitete e institucione të tjera universitare ballkanike, europiane e amerikane prestigjioze dhe realizimin e një sërë aktivitetesh akademike të përbashkëta me këto institucione; (3) pjesëmarrjen në programet europiane të arsimit të lartë si Erasmus, etj., për të realizuar shkëmbimin reciprok të studentëve e pedagogëve; (4) realizimin e një sërë botimesh akademike - shkencore e monografish nga stafi akademik dhe shtëpia botuese UET – PRESS; (5) organizimin e të paktën 2 masterave të përbashkët me departamente apo universitete evropiane, duke i shoqëruar këto me diploma të përbashkëta europiane; (6) kompletimin i Bibliotekës së UET-it me mbi 5.000 libra në funksion të drejtimeve të diplomave, me periodikë revistash të specializuara, si dhe garantimin e përdorimit masiv nga ana e studentëve dhe pedagogëve të bibliotekave elektronike, duke vënë në dispozicion të tyre mbi 25.000 tituj specifikë; (7) studimin e mundësive për hapjen e profileve, degëve ose fakulteteve të reja, në përputhje me kërkesat e tregut dhe mundësitë financiare dhe organizative.

Strategjia afatgjatë (6 – 10 vjeçare) synon: profilizimin e universitetit dhe fakulteteve të tij në dy drejtime themelore:

(1) Universitet / fakultet i specializuar në lidhjet me biznesin dhe tregun e punës. Një universitet i këtij tipi nënkupton një profilizim më të ngushtë të diplomave në funksion të llojeve kryesore të degëve të biznesit (p.sh., “marketing makineri-pajisje”, “fiskalitet”, “menaxhimi i mediave”, “reklama-promocion”, “jurist biznesi”, “drejtim bankar”, “kontabiliteti kompanive”, “menaxher kredie & risku”, etj.), apo kërkesave evidente të tregut (p.sh., “menaxher projektesh”, “administrim sistemesh informatike”, “gazetari e profilizuar”, “diplomaci ekonomike”, “administrim sektorial – në sistemin shëndetësor, arsimor, pushtet lokal, biznese të ndryshme, etj.”, “jurist për kontrata dhe marrëdhëniet me klientët”, “komunikim & publicitet”, “audit”, etj).

Ky drejtim strategjik i zhvillimit të universitetit kërkon një lidhje të ngushtë me të gjitha llojet e biznesit (marrëveshje të veçanta me shoqata biznesi, me dhomat e tregtisë, shqiptare dhe të huaja, me biznese të mëdha, me shoqatën e bankave, me Ministrinë përkatëse sipas sektorëve kryesore të ekonomisë, me organizmat dhe institucionet ndërkombëtare që kanë projekte të mëdha në Shqipëri dhe rajon, me universitete analoge në rajon dhe Europë, etj.) Përfaqësuesit e këtyre bizneseve dhe dhomave të tregtisë do të jenë gjerësisht të përfaqësuar në Bord, Senat, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Dekanatet dhe Departamentet e UET-it. Përfaqësuesit e bizneseve dhe shoqatave të tyre do të jenë influencues të fuqishëm në hartimin dhe përmbajtjen e programeve të një pjese të madhe disiplinash, që kanë të bëjnë direkt me funksionimin e bizneseve. Synohet që e gjithë gama e bizneseve që do të kishte marrëdhënie të ngushta me UET-in të bëhet pjesë edhe e financimeve për shërbime të ndryshme që mund të realizonte UET për këto biznese, ose të financonte lëndë apo programe speciale për studentë të seleksionuar paraprakisht nga ana e tyre për t'i punësuar në mbarim të studimeve. Studentët do të kenë lidhje të ngushta me këto biznese gjatë gjithë periudhës së shkollës për të marrë pjesë në aktivitetet e tyre të përditshme, në panairë të ndryshme, në përgatitjen e revistave dhe faqeve të tyre të internetit, për t'u seleksionuar gradualisht prej tyre si të punësuar të ardhshëm. Konferencat, kërkimi shkencor, institutet dhe qendrat e kërkimit, si dhe botimet kryesore të UET-it, do të orientohen nga problematika e biznesit, tregut të punës, projekteve kryesore të zhvillimit, si dhe tendencave kryesore të punësimit në tregun e brendshëm dhe atë rajonal e evropian.

(2) Universitet elitë në fushën akademike dhe shkencore. Një universitet/fakultet i këtij tipi nënkupton një orientim të dukshëm dhe të qartë në elitën akademike dhe shkencore, duke synuar përgatitje dhe diplomim të studentëve në fusha më akademike dhe shkencore, të tilla si: "Ekonomiks", "Administrim publik", "Sociologji", "Psikologji", "Jurist për të drejtën penale... civile... kushtetuese.... apo europiane", "Marrëdhënie Ndërkombëtare", "Filozofi", "Antropologji", "Komunikim", "Banka-tregje financiare", "E drejtë ndërkombëtare", "Zhvillimi i qëndrueshëm", "Diplomaci-gjeopolitikë", "Tregje & biznes ndërkombëtar", "Negocim konfliktesh", "Media", "Komunikim", "Politika ekonomike & zhvillim", "Studime europiane", "Studime mesdhetare", "Shkenca politike", etj. Ky universitet do t'i kushtojë rëndësi themelore formimit të studentëve cilësorë në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor. Gjatë gjithë përgatitjes së studentëve do të synohet me shumë përparësi cilësia e informacionit, mësimdhënies dhe aftësitë analitiko-kritike të studentëve. Ky vizion strategjik për UET-in apo fakultete të veçanta të tij, kërkon lidhje të ngushta me qendra kërkimore shkencore me reputacion, universitete elitë të këtij lloji në Europë dhe SHBA, angazhimin e pedagogëve të nivelit të lartë dhe me reputacion shkencor, lidhje me institute kërkimore-shkencore dhe qendra të mëdha akademike, etj; kërkon përfshirjen e shpejtë të UET-it në programet e mëdha europiane në funksion të diversifikimit të burimeve të financimit si Erasmus, etj; ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitete apo departamente analoge në BE e SHBA, etj. Studentët/të diplomuarit e këtij universiteti do të evidentohen në tregun e punës si ekspertë cilësorë të nivelit të lartë. Pjesa më e madhe e tyre do të mbarojë edhe studimet e ciklit të dytë DND, si dhe do të inkurajohet të vazhdojë ciklin e tretë të studimeve (Doktoraturë ose MND). Aktivitetet në UET do të jenë në nivel shkencor e polemizues në raport me debatet më të rëndësishme bashkëkohore kombëtare e ndërkombëtare; institutet kërkimore-shkencore brenda UET-it do të funksionojnë si qendra të mirëfillta kërkimore; UET-i do të përfshihet gjerësisht në rrjete dhe qendra ndërkombëtare kërkimi të specializuara. Financimet më të rëndësishme do të vijnë nga "porositë" për shërbime kërkimore-shkencore të institucioneve qendrore kombëtare e ndërkombëtare, si p.sh., UNDP, Banka Botërore, UNICEF, OBSH, OBT, etj.

Të dy vizionet e mësipërme në lidhje me strategjinë afat-gjatë reflektojnë këndvështrimin strategjik për 5 - 10 vitet e ardhshme. Duke pasur parasysh specifikat dhe kërkesat e tregut të punës në Shqipëri, por dhe më gjerë në rajon e Europë, duke u mbështetur në veçoritë e drejtëve të diplomimit dhe programeve të studimit në UET, si dhe duke pasur si objektiv të afërt ofrimin e programeve të studimit të ciklit të tretë, vlerësojmë se kombinimi i të dy strategjive të mësipërme është rruga e duhur që na garanton performancën e kërkuar. Në këtë kuadër, për Fakultetin Ekonomik do synohet me përparësi atashimi me profilizimin si fakultet i specializuar në lidhje të ngushtë me biznesin dhe tregun e punës drejt krijimit dhe të një modeli "business school"; për Fakultetin Juridik dhe atë të Shkencave Sociale do të synohet atashimi në profilizimin si fakultete elite në fushën akademike dhe shkencore.

c) Si i ndjek UET ndryshimet në institucione homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

UET ndjek me vëmendje e kujdes parësor zhvillimet institucionale, ligjore dhe të zhvillimit në universitetet dhe institucionet arsimore analoge shqiptare, ato të trevave shqiptare në rajon si dhe në universitetet europiane dhe ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është azhurnimi me zhvillimet pozitive e arritjet e homologëve tanë shqiptarë e të huaj në fushën e përmirësimit të programeve e kurrikulave, metodave të mësimdhënies, kërkimit shkencor, organizimit institucional, botimeve, përshtatjen me tregun e punës, etj.

Ky proces zhvillohet nëpërmjet formave e instrumenteve të mëposhtme: (i) pjesëmarrje në shoqatën e universiteteve të gjithë hapësirës shqiptare në rajon dhe shkëmbim i rregullt takimesh e aktiviteteve reciproke me to; (ii) pjesëmarrje aktive në Konferencën e Rektorëve të universiteteve shqiptare, duke

synuar një shkëmbim sa më efektiv të eksperiencës dhe zhvillimeve reciproke; (iii) nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe; (iv) nëpërmjet një informacioni të rregullt nga faqet e internetit të universiteteve homologe shqiptare apo të huaja në lidhje me zhvillimet më të fundit të tyre; (v) nëpërmjet ndjekjes dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare e ndërkombëtare mbi problematikën dhe zhvillimin e arsimit të lartë; (vi) nëpërmjet analizës dhe studimit të kujdesshëm të raporteve ndërkombëtare mbi analizat krahasuese dhe zhvillimet në arsimin e lartë në botë, të përgatitura periodikisht nga OECD, Banka Botërore, BE, SHBA, Organizata e frankonisë, etj.; (vii) nëpërmjet abonimit në disa revista e periodikë që trajtojnë çështjet e universiteteve dhe arsimit të lartë në përgjithësi; (viii) nëpërmjet blerjes dhe studimit të hollësishëm të dokumenteve e botimeve specifike mbi ecurinë dhe problematikën e procesit të Bolonjës, reformave në sistemin arsimor evropian dhe amerikan, etj.

d) Të dhënat e përgjithshme të UET-it

i) Historiku

Ideja për krijimin e Universitetit Evropian të Tiranës u ngjiz nga një grup pedagogësh të angazhuar kryesisht në universitetet e kryeqytetit, në kontekstin e konstatimit të problemeve të shumta të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri. Grupi i themeluesve vendosi krijimin e një universiteti të menaxhuar në formë private për të zgjidhur problemet e konstatuara dhe për të dhënë një kontribut substancial në arsimin e lartë shqiptar.

Strukturat e para akademike, të burimeve njerëzore dhe ndihmëse, morën formë të qartë që në fund të vitit 2005. UET-i mori licencën si shkollë e lartë për hapjen e Fakultetit Juridik dhe atë të Shkencave Sociale në shtator 2006 dhe filloi menjëherë veprimtarinë e tij me një numër relativisht të vogël studentësh. Që në ditët e tij të para, UET-i u angazhua në dhënien e një kontributi të rëndësishëm social, duke ofruar bursa të plota studimi për një sërë kategorish studentësh, të ardhur nga grupe sociale të pafavorizuara apo të diskriminuara, të rinj të evidentuar në fusha të caktuara të artit, sportit, medias, kulturës etj.

Në vitin e tij të dytë UET-i arriti të përshtatë ambiciet e zhvillimit me infrastrukturën e nevojshme, duke kaluar në mjedise që pasqyronin nevojat e reja dhe përballonin interesin e studentëve të rinj, si dhe duke plotësuar dhe përmirësuar burimet e tij njerëzore me staf akademik të diplomuar kryesisht në universitete perëndimore. Ndërkohë, UET-i tashmë fuqizoi ndjeshëm veprimtaritë e organizuara jashtë kurrikulare duke ofruar për studentët e tij (dhe jo vetëm) një seri aktivitetsesh si: konferenca lokale dhe ndërkombëtare, tryeza diskutimi, grupe të leximit tematik, trajnime, etj.

Licencimi i Fakultetit Ekonomik në vitin akademik 2007 – 2008, plotësoi objektivat fillestare për orientimin e studimeve të ofruara. Marrja e licencave për studimet e nivelit Master të Nivelit të Parë dhe ato të Diplomës së Nivelit të Dytë në vitin akademik 2008 – 2009 i ka dhënë një përmasë të re dhe të rëndësishme strukturimit dhe koherencës së studimeve në UET.

Numri i studentëve të UET-i aktualisht është rreth 8 herë më i lartë se ai i vitit të parë. Paralelisht me të është rritur edhe stafi akademik i brendshëm dhe i jashtëm, (rreth 4.5 herë), dhe ai administrativ (rreth 3.5 herë). Ndërkohë, në veprimtaritë shkencore (dhe jo vetëm) të UET-it angazhohen edhe shumë studentë nga universitete të tjera private e publike, sidomos në tryezat e rumbullakëta teorike.

ii) Statusi i UET-it në kuadrin kombëtar

Shkolla e Lartë Universitare Private "Universiteti Evropian i Tiranës" është një shkollë e lartë private e nivelit universitar, e krijuar në bazë të Ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e Lartë në

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Republikën e Shqipërisë", i shfuqizuar me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 22.03.2001, "Për shkollat private në Republikën e Shqipërisë"; lejes së posaçme për hapjen e kësaj shkolle, të dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 636, datë 20.09.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Private "Universiteti Europian i Tiranës"; VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, "Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë shkollës së lartë universitare private "Universiteti Europian i Tiranës" dhe lejes së posaçme për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, të dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 74, date 21.1.2009, "Për hapjen e hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë në Shkollën e Lartë Universitare Private "Universiteti Europian i Tiranës".

Shkolla e Lartë Universitare Private "Universiteti Europian i Tiranës" është person juridik i njohur me Vendimin Nr. 36117, Datë 07.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me Vendimin Nr. 36117/1, Datë 05.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar me Vendimin e Gjyqarit të Vetëm, Nr. 36117/2, Datë 05.07.2007.

Shkolla ushtron një veprimtari të pavarur ekonomike, e cila rregullohet nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

iii) Numri i punonjësve: mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ

Në vitin akademik 2006-2007 në UET janë angazhuar në mësimdhënie 29 pedagogë, nga të cilët 10 në Fakultetin Juridik dhe 19 në Fakultetin e Shkencave Sociale; 7 të brendshëm dhe 22 të jashtëm. Në vitin akademik 2007-2008 numri i personelit akademik u rrit rreth 2.5 herë, si pasojë e hapjes së vitit të dytë të studimeve në dy fakultetet e para dhe hapjes së një Fakulteti të ri, atij Ekonomik. Për këtë vit akademik Fakulteti Juridik numëronte 23 anëtarë të personelit mësimdhënës, Fakulteti i Shkencave Sociale 37 dhe Fakulteti Ekonomik 12 anëtarë, për një total prej 72 anëtarësh të personelit mësimdhënës, nga të cilët 19 të brendshëm dhe 53 të jashtëm. Në vitin akademik, 2008-2009, në UET është plotësuar cikli i parë i studimeve për Fakultetin Juridik dhe atë të Shkencave Sociale, ndërkohë që viti i tretë i studimeve për Fakultetin Ekonomik do të hapet vitin e ardhshëm akademik. Për këtë vit akademik janë angazhuar në mësimdhënie 131 pedagogë, nga të cilët 28 në Fakultetin Juridik, 47 në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe 56 në Fakultetin Ekonomik; 35 prej tyre është personel i brendshëm dhe 96 i jashtëm. Siç shihet, personeli akademik i UET-it është 1.8 herë më i madh se ai i vitit akademik 2007-2008 dhe 4.5 herë më i madh, krahasuar me atë të vitit akademik 2006-2007.

Edhe personeli administrativ i punësuar në UET i është përgjigjur rritjes së përmasave të shkollës dhe objektivit për të ofruar një shërbim sa më cilësor dhe në kohë për studentët. Në vitin akademik 2006-2007 ky personel numëronte 11 punonjës; në vitin akademik 2007-2008, 28 punonjës dhe këtë vit akademik ky numër është rritur në 39 punonjës. Pra, shihet se sot, administrata e UET-it është rreth 3.5 herë më e madhe se ajo e vitit 2006-2007, kur UET-i nisi aktivitetin e tij.

iv) Numri i studentëve


Tabela më poshtë tregon totalin e numrit të studentëve të regjistruar sipas vitit akademik dhe Fakultetit. Sikurse mund të vihet re numri studentëve në UET brenda një kuadri kohor akademik tre vjeçar është gati 8-fishuar. I hapur në një ambient modest, me një numër modest studentësh (175) në vitin e tij të parë akademik 2006-2007, UET-i tregoi potenciale profesionale të larta dhe premtuese për të ardhmen. Me zgjerimin e ambienteve mësimore, shkencore dhe administrative, numri i studentëve që i besuan shkollimin e tyre UET-it u rrit ndjeshëm. Kjo përkoi edhe me hapjen e Fakultetit Ekonomik. Sot numërohen 1 353 studentë të regjistruar për të ndjekur studimet në programet e ciklit të parë DNP.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Fakulteti	Viti akademik			Totali
	2006-2007	2007 – 2008	2008 - 2009	
Fakulteti Juridik	61	179	177	417
Fakulteti i Shkencave Sociale	114	161	181	456
Ekonomik	-	74	407	481
TOTALI	175	414	765	1 354

Ecuria e numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në UET, i shtrirë që në vitin e parë të fillimit të studimeve në UET e deri në vitin e tretë akademik, sipas Fakulteteve paraqitet si vijon:

Shpërndarja e numrit të studentëve të regjistruar në vite dhe sipas fakulteteve



v) Numri i kurseve në ciklin e parë të studimeve (DNP)

Universiteti Europian i Tiranës, në bazë të V. K. M. Nr. 636, datë 20.09.2006, ofron këto programe studimi të ciklit të parë, Diplomë e Nivelit të Parë (DNP):

1. DNP "Jurist i përgjithshëm," ose i shoqëruar me profilet:
 - a. Juridik biznesi
 - b. Juridik, e drejta publike dhe kushtetuese
 - c. Juridik, e drejta europiane dhe ndërkombëtare
2. DNP "Komunikim – Marrëdhënie publike"
3. DNP "Shkenca politike"
4. DNP "Marrëdhënie ndërkombëtare"

Në bazë të V. K. M. Nr. 255, datë 27.02.2008, ofrohen këto programe studimi:

5. DNP "Ekonomik"
6. DNP "Financë Bankë"
7. DNP "Menaxhim Biznesi"
8. DNP "Administrim publik."

Të gjitha këto programe studimi ofrohen me kohë të plotë; me kohëzgjatje normale 3 vite akademike; dhe realizohen me së paku 180 ECTS.

vi) Numri i kurseve në ciklin e dytë të studimeve (MNP & DND)

Universiteti European i Tiranës, bazuar në V. K. M. Nr. 74, datë 21.01.2009, ofron programe studimi: Diplomë e Nivelit të Dytë dhe Master i Nivelit të Parë, si më poshtë vijon:

A. Diploma të Nivelit të Dytë, DND në:

1. E drejtë private dhe biznesi; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. E drejtë private
 - b. E drejtë biznesi
2. E drejtë publike dhe ndërkombëtare
3. Komunikim – Marrëdhënie publike; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Studime dhe teoritë e komunikimit
 - b. Marrëdhënie Publike
4. Shkenca Politike; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Politikë e krahasuar
 - b. Teoritë politike
5. Marrëdhënie ndërkombëtare; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Organizatat ndërkombëtare
 - b. Studime strategjike
6. Financë Banka; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Banka dhe Tregje financiare
 - b. Ekonomi – Financë
7. Administrim biznesi; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Biznes – Marketing
 - b. Administrim publik
 - c. Ekonomi europiane

Programet e studimit Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) ofrohen me kohë të plotë; kanë kohëzgjatje normale 2 vite akademike; dhe realizohen me së paku 120 ECTS.

B. Diploma Master të Nivelit të Parë në:

1. E drejtë administrative
2. E drejtë ndërkombëtare
3. E drejtë europiane
4. Gazetari; ose shoqëruar me profilet:
 - a. Gazetari televizive
 - b. Gazetari për çështje politike
5. Marrëdhënie publike; ose shoqëruar me një nga profilet:

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

- a. MP për sektorin komercial
 - b. MP politike dhe institucionale
6. Shkenca politike; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Sjellja dhe strategjitë politike
 - b. Politika publike
 7. Marrëdhënie ndërkombëtare – Diplomaci; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Çështjet e Ballkanit
 - b. Studime amerikane
 8. Studime Europiane; ose shoqëruar me një nga profilet
 - a. Politika në BE
 - b. Ekonomia në BE
 9. Banka dhe sigurime; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Banka
 - b. Sigurime
 - c. Politika fiskale
 10. Marketing; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Shërbime dhe turizëm
 - b. Inovacion dhe tregje strategjike
 - c. Marketing bankar dhe financiar
 11. Menaxhim dhe administrim; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Menaxhimi i SME-ve
 - b. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe karrierës
 - c. Institucione dhe administrim publik

Programet e studimit Master i Nivelit të Parë (MNP) ofrohen me kohë të plotë; kanë kohëzgjatje normale 1 vit akademik; dhe realizohen me së paku 60 ECTS.

vii) Numri i kurseve në ciklin e tretë të studimeve

UET synon në një të ardhme të afërt hapjen e ciklit të tretë të studimeve (MND & Doktoraturë).

viii) Format e kualifikimit të vazhdueshëm

Trajnimet dhe kualifikimet profesionale të stafit akademik në UET

Trajnime të rregullta:

Këto trajnime zhvillohen sipas një rendi të paracaktuar në fillim të çdo viti akademik. Përfituesit e tyre kryesorë janë pedagogët e ardhur rishtas në UET, por shpesh edhe pedagogët ekzistues, të cilët e kanë të nevojshme të njihen me ndryshimet në organizimin e studimeve në UET.

Trajnimet për familjarizimin me filozofinë akademike të UET-it organizohen përpara fillimit të vitit akademik. Drejtuesit e universitetit paraqesin dokumentet themelore të universitetit që përmbledhin

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

filozofinë e funksionimit, strukturimin e përgjithshëm, parimet kryesore të rregullores dhe parimet etike të zbatuara në UET.

Trajnimet për metodat e mësimdhënies me pedagogët e rinj, drejtohen nga pedagogët me më tepër përvojë në mësimdhënien universitare. Ato synojnë rritjen e aftësive mësimdhënëse të stafit dhe nxitjen e një komunikimi sa më efikas me studentët. Këto trajnime organizohen në prag të fillimit të vitit akademik.

Trajnime për përgatitjen në lidhje me zbatimin e Procesit të Bolonjës, organizohen kryesisht për pedagogët e rinj, por edhe për të tjerët, madje edhe për stafin administrativ. Këto trajnime organizohen në prag të fillimit të vitit akademik.

Trajnime specifike:

Këto trajnime zhvillohen kryesisht mbi bazë individuale, brenda ose jashtë shtetit. Në disa raste ato nxiten apo parashikohen nga vetë UET-i; në raste të tjera ato ndërmerren mbi baza personale nga vetë pedagogët, por në këtë rast UET-i merr përsipër vazhdimin e pagesës normale për pedagogun, si dhe zëvendësimin e tij për periudhën e trajnimit. Tematika e këtyre trajnimeve është e larmishme. *Këto trajnime në të dyja rastet kanë pasur në qendër rritjen profesionale të stafit, njohjen apo përditësimin me të rejat e shkencës, njohja me metodat bashkëkohore të mësimdhënies, punës me studentin, komunikimit, kërkimit shkencor, njohje me sistemet e reja të përpunimit statistikor (SPSS), njohja me sisteme të arsimit të lartë në shtete të tjera etj.* Një shembull për t'u përmendur: UET-ia ka qenë bashkë-organizator i një trajnimi me pedagogë të tij dhe të universiteteve të tjera në lidhje me zbatimin e parimit të interdisiplinaritetit në shkencat sociale, me theks të veçantë në shfrytëzimin e elementëve të shkencave politike në kurrikulumet e degëve të përafërta.

ix) Vendi i UET në kuadrin e shkollave të larta kombëtare


Megjithëse për shkollat e larta në Republikën e Shqipërisë nuk ka një sistem renditjeje, në synojmë përfshirjen e UET-it ndër shkollat e larta elitare në vend.

e) Dokumentacioni përkatës:

1. Dosja e trajnimit të APAAL;
2. Urdhri i Rektorit për ngritjen dhe përbërjen e Grupit të Vetëvlerësimit;
3. Udhëzimi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë;
4. Dokumentacioni i takimit me të gjithë njësinë për njohjen me Raportin;
5. Strategjia e zhvillimit UET;
6. Tabela e burimeve njerëzore;
7. Dosja e trajnimeve në UET.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E UET, NJËSITË PËRBËRËSE DHE MENAXHIMI I TIJ

a) Skema organizative e UET-it; organizimi hierarkik



b) Politika dhe vendimmarrja

Politika dhe vendim-marrja në UET zhvillohen në përputhje të plotë me respektimin e të drejtave dhe detyrave të miratuara të organeve përbërëse. Të gjitha detyrat, të drejtat, fushat e kompetencës dhe mënyrat e funksionimit të organeve vendim-marrëse janë të përcaktuara qartë e të miratuara në funksion e sipas kërkesave të "Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", akteve nënligjore, rregulloreve e udhëzimeve specifike të MASH-it, statutit, rregulloreve dhe udhëzimeve të veçanta të UET-it, etj.

Politikën kryesore të zhvillimit dhe rekomandimet me karakter strategjik i realizon Bordi i Besimit, si organi bazë këshillues i UET-it.

Drejtimi dhe vendim-marrja realizohet tërësisht nga organet drejtuese të tij si: Senati Akademik, Rektorati, Këshillat e Fakulteteve, Këshilli i Etikës, dhe autoritetet drejtuese si Rektori, Dekanët dhe Përgjegjësit e departamenteve. Për sa i përket kërkimit shkencor, vendim-marrja realizohet nga drejtorët e Instituteve të kërkimit, përgjegjësit e Qendrave të Kërkimit, etj.

Vendimet për funksionimin dhe drejtimin e UET-it në aspektin akademik dhe shkencor merren nga autoritetet dhe organet drejtuese të tij. Administratori i Shoqërisë "U.E.T." shpk gëzon të drejtën e informimit në lidhje me këto vendime. Për vendimet e organeve drejtuese të UET-it me pasoja financiare ose që përfaqësojnë devijim nga misioni, parimet dhe filozofia e UET-it, nevojitet në çdo rast edhe miratimi i Asamblesë së Ortakëve.

c) Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet

Organet e zgjedhura dhe të emëruara ndërtohen dhe funksionojnë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, aktet nënligjore dhe Statutin e UET-it. Ato ndahen në organe këshilluese, drejtuese, autoritete drejtuese, si dhe autoritete të tjerë. Organe këshilluese janë Bordi i Besimit dhe Këshilli i Etikës, organe drejtuese janë Senati Akademik, Rektorati, Këshillat e fakultetit; ndërsa autoritetet drejtuese janë Rektori, Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve dhe të Instituteve. Në UET ka dhe autoritete të tjerë si Zëvendësrektorët, Kancelari dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Bordi i Besimit është një organ këshillues, i përbërë nga 7 deri në 9 personalitete të fushave të ndryshme. Përbërja dhe numri i anëtarëve të Bordit përcaktohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve në konsultim me Rektordin.

Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës për çështje të drejtimit dhe organizimit të veprimtarisë akademike; ai merr vendim për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statutin e UET-it. Senati programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik mblidhet periodikisht, së paku 4 herë në vit dhe drejtohet nga Kryetari i Senatit, i cili është Rektori. Senati Akademik përbëhet nga së paku 13 anëtarë. Anëtarë të Senatit Akademik janë Rektori dhe Dekanët e Fakulteteve, të emëruar për shkak të detyrës, të cilët nuk përbëjnë më shumë se 1/3 e anëtarëve; anëtarët e zgjedhur, të cilët përbëjnë jo më pak se 2/3 e anëtarëve, janë përfaqësues të personelit mësimor shkencor të brendshëm dhe të jashtëm, të zgjedhur nga departamentet; përfaqësues të Asamblesë së Ortakëve me status akademik; si dhe përfaqësues të studentëve. Përfaqësuesi i studentëve zgjidhet nga Këshilli Studentor. Anëtarët e zgjedhur të Senatit Akademik kanë mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Organ tjetër kolegjal është Rektori i cili është organ ekzekutiv dhe përbëhet nga Rektori, Zëvendësrektorët, Dekanët e Fakulteteve, Kancelari, Sekretari i Përgjithshëm dhe një nga drejtorët e Instituteve të Kërkimit. Rektori kryesohet nga Rektori.

Këshillat e Fakulteteve janë organe kolegjinale vendimmarrëse, të cilët marrin vendime për çështje brenda kompetencave të tyre me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statutin e UET-it. Këshillat e fakulteteve përbëhen nga Dekani, Përgjegjësit e departamenteve dhe Përgjegjësi i qendrës së kërkimit. Këshilli i fakultetit kryesohet nga Dekani.

Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët përzgjidhen nga Senati Akademik, përmes një procedure përzgjedhëse të bërë zyrtare paraprakisht.

Autoriteti i parë është Rektori, i cili është autoriteti drejtues i UET-it, e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij. Rektori zgjidhet dhe emërohet nga Asambleja Përgjithshme e Ortakëve me pëlqimin e Bordit të Besimit, ka mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Rektori duhet të ketë të paktën titullin Profesor i asociuar.

Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit dhe përfaqësuesi i tij. Dekani emërohet nga Rektori me mandat 5 vjeçar, me të drejtë riemërimi. Ai duhet të ketë të paktën titullin Profesor i asociuar.

Autoriteti më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Institutit Kërkimit është Drejtori i Institutit. Drejtori emërohet nga Rektori, me mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ai duhet të ketë të paktën gradën "Doktor".

Përgjegjësi i departamentit, është autoriteti më i lartë për këtë njësi bazë të punës mësimore kërkimore. Ai propozohet nga dekani dhe emërohet nga Rektori; duhet të ketë të paktën titullin Doktor.

Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit është autoriteti më i lartë për këtë njësi. Propozohet nga dekani dhe emërohet nga Rektori; duhet të ketë të paktën titullin Doktor.

Kancelari duhet të ketë formim universitar, juridik ose ekonomik dhe së paku 5 vjet përvojë pune; emërohet nga Asambleja e Ortakëve e "U. E. T." Sh. p. k.

Zëvendësrektori emërohet dhe shkarkohet nga Rektori, pas miratimit të kandidaturës të propozuar prej tij në Senatin Akademik.

Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Rektori.

d) Fakultetet, departamentet, seksionet

Universiteti European i Tiranës është i organizuar në 3 Fakultete, 6 departamente, 2 institute dhe 3 qendra, si më poshtë vijon:

1. Fakulteti Juridik
 - a. Departamenti i së Drejtës Private

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

- b. Departamenti i së Drejtës Publike
 - c. Qendra e Studimeve dhe Trajnimeve Juridike
2. Fakulteti i Shkencave Sociale
 - a. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit
 - b. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
 - c. Qendra e Studimeve Politike dhe Sociale
 3. Fakulteti Ekonomik
 - a. Departamenti Ekonomi dhe Financë
 - b. Departamenti Biznes dhe Administrim
 - c. Qendra e Studimeve Ekonomiko-Financiare dhe e Trajnimeve
 4. Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave
 5. Instituti i Historisë Bashkëkohore

Me zgjerimin e stafit akademik, në një të ardhme të afërt, çdo departament do të kompletojë strukturën e vet edhe me seksionet përkatëse.

e) Numri i stafit drejtues, mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ për çdo njësi

Sot UET-i përbëhet nga 3 fakultete, 2 institute dhe 6 departamente, nga dy për çdo fakultet. Në dy vitet e para të aktivitetit të UET-it, numri i personelit drejtues ka qenë i vogël, kushtëzuar edhe nga përmasat modeste të tij; ai përbëhej nga Rektori, Zëvendësrektori, një Dekan për çdo fakultet, Administratori, Kancelari dhe Sekretari i Përgjithshëm - ky i fundit i shtuar në strukturë në tetor 2007. Në fillim të vitit akademik 2008-2009, me rritjen e numrit të studentëve dhe hapjen e të tre viteve të studimit për Fakultetin Juridik dhe atë të Shkencave Sociale, rritjen e Fakultetit Ekonomik, UET-i plotësoi strukturën e tij drejtuese me ngritjen e dy departamenteve për secilin Fakultet. Në afatshkurtër pritet të aktivizohen edhe Qendrat kërkimore pranë çdo Fakulteti. Kështu, këtë vit akademik çdo Fakultet ka 3 drejtues, Dekanin dhe 2 Përgjegjësit e Departamenteve. Për këtë vit akademik, në total stafi drejtues numëron 15 drejtues.

Në vitin akademik 2006-2007 personeli akademik i Fakultetit Juridik ka pasur 10 anëtarë, nga të cilët 4 në Departamentin e së Drejtës Civile dhe 6 në Departamentin e së Drejtës Publike; në vitin akademik 2007-2008 numri i personelit akademik u rrit në 23, nga të cilët 15 në Departamentin e të Drejtës Civile dhe të Biznesit dhe 8 në atë të së Drejtës Publike dhe Ndërkombëtare; ndërsa këtë vit akademik ky fakultet numëron një personel akademik prej 28 anëtarësh, nga të cilët 9 në Departamentin e së Drejtës Private dhe 19 në atë të së Drejtës Publike (*shënim: emërtimi i departamenteve është ruajtur siç ka qenë në vitin akademik përkatës*).

Fakulteti i Shkencave Sociale në vitin akademik 2006-2007 kishte një personel akademik prej 19 anëtarësh, nga të cilët 9 në Departamentin e Gazetari-Komunikimit dhe 10 në atë të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; në vitin akademik 2007-2008 numri i personelit akademik u rrit në 37, nga të cilët 17 në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit dhe 20 në atë të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; për vitin akademik 2008-2009 ky fakultet numëron një personel akademik prej 47 anëtarësh, nga të cilët 21 në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit dhe 26 në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Fakulteti Ekonomik në vitin akademik 2007-2008 kishte një personel akademik prej 12 anëtarësh, nga të cilët 8 në Departamentin Financë dhe Banka dhe 4 në Departamentin Biznes dhe Administrim. Këtë vit akademik ky numër është rritur në 56, nga të cilët 45 në Departamentin Ekonomi dhe Financë dhe 11 në Departamentin Biznes dhe Administrim. Ky shpërpjesëtim i numrit të personelit akademik në dy departamentet e këtij Fakulteti, vjen si pasojë e numrit më të lartë të studentëve të regjistruar në programin e studimit Financë-Banka, krahasuar me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit Menaxhim biznesi, dhe mos-hapjes së programit të studimit DNP në Administrim Publik.

Personeli mbështetës dhe administrativ për njësi: Në vitin akademik 2008-2009, në strukturën e 3 fakulteteve është krijuar një pozicioni i ri, ai i koordinatores së Fakultetit, e cila asiston Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësit e departamenteve për organizimin dhe sigurimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë së përditshme të Fakultetit. Gjithashtu, zhvillimi i procesit mësimor të çdo Fakulteti mbështetet nga sekretarja përkatëse në Sekretarinë Mësimore.

f) Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për çdo njësi

UET-i i ka kushtuar rëndësi të veçantë cilësisë së stafit drejtues mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ. Synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve/klientëve nga të gjitha njësitë përbërëse. Kujdesi fillon me procesin e përzgjedhjes dhe rekrutimit të stafit drejtues mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ. Ndër kriteret bazë të rekrutimit të personelit akademik që zbatohen janë (i) eksperiencia në mësimdhënien universitare, (ii) grada e titulli shkencor i kandidatit për pedagog dhe (iii) aktiviteti kërkimor shkencor e botues i tij.

Në këtë drejtim, është pasur parasysh që stafi drejtues dhe mësimdhënës të plotësojë kriteret e duhura, të karakterizohet nga profesionalizmi dhe të ketë edhe aftësi drejtuese dhe menaxhuese. Stafi drejtues përbëhet nga pedagogë të njohur dhe me eksperiencë, me tituj dhe grada shkencore. Për drejtimin me efikasitet të fakulteteve dhe departamenteve theksi është vënë tek nxitja, bashkërendimi dhe administrimi i mësimdhënies, veprimtarive kërkimore-shkencore, duke respektuar lirinë akademike të stafit akademik.

Përbërja e personelit akademik tregon për një angazhim të një stafi të kualifikuar, me eksperiencë veçanërisht në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, si dhe për aktivizimin e pedagogëve të rinj në proces kualifikimi shkencor dhe ngritje profesionale akademike. Synimi ka qenë dhe mbetet përthithja e stafit sa më të kualifikuar, me eksperiencë, profesionistë të njohur në fushën ekonomike, sociale dhe juridike, si dhe të rinj premtues apo që janë duke avancuar në rrugën e karrierës profesionale.

Për lehtësimin e koordinimit të punës mes departamenteve, si dhe të departamenteve me dekanin, pranë çdo fakulteti është ngritur edhe pozicioni i koordinatorit të fakultetit. Koordinatori ndihmon dhe mbështet dekanatin në procesin akademik dhe mësimdhënës, si dhe kryen detyra administrative dhe shërbime për studentët e Fakultetit. Në mbështetje të punës së fakulteteve është edhe sekretaria mësimore, ku punët e çdo fakulteti mbulohen nga një sekretare e veçantë. Stafi administrativ në shërbim të njëjësive kryesore dhe bazë është me shkollë të lartë.

Fakulteti Ekonomik

Këtë vit akademik numri i personelit akademik të brendshëm i Fakultetit Ekonomik është rritur në 10. Prej tyre 2 janë profesorë të asociuar, 2 doktorë, dhe 6 lektorë, nga të cilët një në proces doktorature.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe përbërjes dhe cilësisë së stafit me kohë të pjesshme. Në vitin akademik 2008 – 2009 llogariten 46 pedagogë me kohë të pjesshme, nga të cilët 5 profesorë, 3 Profesorë të Asociuar, 10 doktorë. Pedagogët që nuk kanë tituj akademikë janë të angazhuar vetëm në lëndët e përgjithshme bazë, siç është p.sh. Matematika.

Në total personeli akademik i Fakultetit Ekonomik është rritur më shumë se 4.5 herë në krahasim me vitin paraardhës akademik. Shpërndarja sipas departamenteve, është si më poshtë:

Në Departamentin Ekonomi dhe Financë janë: 4 pedagogë të brendshëm dhe 41 të jashtëm. Nga këta, 4 mbajnë titullin “Profesor” (të jashtëm); 5 janë me titullin “Prof. Asoc.” (2 të brendshëm dhe 3 të jashtëm); 10 janë me gradën “Doktor” (të jashtëm), dhe 26 lektorë (2 të brendshëm dhe 24 të jashtëm).

Në Departamentin Biznes dhe Administrim janë: 6 pedagogë të brendshëm dhe 5 të jashtëm. Nga këta, 1 është me titullin “Profesor”, (i jashtëm), 2 janë me gradën “Doktor” (të brendshëm), dhe 8 lektorë (4 të brendshëm dhe 4 të jashtëm).

Fakulteti Juridik

Në Fakultetin Juridik, aktivizohet një numër i konsiderueshëm pedagogësh, që në total janë 28. Në këtë staf përfshihen pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm. Nga këta, 9 janë pedagogë të brendshëm dhe 19 të jashtëm. Ky numër është rritur 2.8 herë krahasuar me numrin e personelit akademik të angazhuar në vitin akademik 2006-2007, dhe 1.2 herë krahasuar me vitin akademik 2007-2008.

Shpërndarja sipas departamenteve, është si më poshtë:

Në Departamentin e së Drejtës Private janë: 4 pedagogë të brendshëm dhe 5 të jashtëm, nga të cilët 3 janë me gradën “Doktor” (1 i brendshëm dhe 2 të jashtëm). Në këtë Fakultet janë të angazhuar edhe 6 lektorë (3 të brendshëm dhe 3 të jashtëm).

Në Departamentin e së Drejtës Publike janë: 5 pedagogë të brendshëm dhe 14 të jashtëm. Nga këta, 4 janë me titullin “Profesor”, (1 i brendshëm dhe 3 të jashtëm), 2 me titullin “Profesor i asociuar” (të jashtëm), 4 janë me gradën “Doktor” (1 i brendshëm dhe 3 të jashtëm), 9 lektorë, 3 të brendshëm, nga të cilët 2 janë në proces doktorature, dhe 6 të jashtëm.

Fakulteti i Shkencave Sociale

Në këtë fakultet, aktivizohet një numër i konsiderueshëm pedagogësh, që në total janë 47. Këtu përfshihen pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm. Aktualisht 16 janë pedagogë të brendshëm dhe 31 të jashtëm. Ky numër është rritur 2.5 herë krahasuar me numrin e personelit akademik të angazhuar në vitin akademik 2006-2007, dhe rreth 1.3 herë krahasuar me vitin e kaluar akademik 2007-2008.

Shpërndarja sipas departamenteve, është si më poshtë:

Në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë: 9 pedagogë të brendshëm dhe 17 të jashtëm. Nga këta, 1 mban titullin “Profesor” (i jashtëm), një mban titullin “Profesor i

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Asociuar” (i brendshëm); 4 janë me gradën “Doktor” (2 të brendshëm dhe 2 të jashtëm), dhe nga 20 lektorët e angazhuar, 6 janë të brendshëm.

Në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit aktualisht janë: 7 pedagogë të brendshëm dhe 14 të jashtëm. Nga këta, 1 është me titullin “Profesor”, (i jashtëm), 1 me titullin “Profesor i asociuar” (i jashtëm), 4 janë me gradën “Doktor” (të brendshëm), 3 janë në proces doktorature (2 të brendshëm dhe 1 i jashtëm).

g) Kompetencat dhe përgjegjësitë, njohja me to

Kompetencat kryesore të Bordit të Besimit janë konsultimi mbi zgjedhjet dhe politikat strategjike të zhvillimit të UET-it, konsultim mbi projektet e zhvillimit dhe zgjerimit të aktivitetit të tij, lobim për imazhin dhe njohjen sa më të mirë publike të UET-it dhe lidhjet e tij me tregjet e punës, lobim për sa i përket reformimit dhe përmirësimit të politikave të arsimit të lartë në Shqipëri, si edhe dhënia e pëlqimit për kandidaturën e Rektorit.

Senati akademik garanton respektimin e parimeve të autonomisë, të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve. Miraton planin disaveçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij si dhe i propozon Asamblesë së Ortakëve projektbuxhetin e UET-it. Senati miraton rregulloret e institucionit që janë kompetencë e tij dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Ai miraton programet e studimit dhe programet e kërkimit e zhvillimit dhe, me propozim të njësisë kryesore të UET-it miraton ndryshimet në këto programe. Senati u propozon institucioneve përgjegjëse hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore. Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës, si dhe shpreh vlerësime e rekomandime në lidhje me programet e zhvillimit të UET-it. Senati akademik përcakton politikat e zhvillimit akademik, mësimor e administrativ, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor si dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Ai jep vlerësimet e tij periodike lidhur me personelin akademik dhe atë ndihmës akademik të institucionit.

Rektorati harton planin disaveçar të zhvillimit të institucionit, programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik. Paraqet propozime e rekomandime për projektet, për programet e studimeve, të kërkimit shkencor e aktivitetit botues dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre. Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik, të cilat i drejtohen atij, monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit, si dhe propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet.

Këshillat e Fakulteteve programojnë dhe përcaktojnë, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit përkatës. Bëjnë propozime për programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor si dhe propozojnë hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësive të tjera. Përgatisin rregulloren mësimore për çdo program studimi të njësive të tyre, dhe e dërgojnë për miratim në Senatin Akademik. Japin mendim për rregulloren e institucionit dhe për çështje brenda fushave të tyre të kompetencës. Japin mendim për rregullore apo akte të tjera të institucionit, mbështetur në kërkesën e Rektorit. Këshillat marrin vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar, shqyrtojnë dhe miratojnë raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor si dhe i propozojnë Senatin Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyrin realizimin e tij.

Këshilli i Etikës analizon e diskuton probleme të etikës së jetës universitare. Këshilli i etikës shqyrton sjellje të ndryshme të personelit akademik dhe atij ndihmës të institucionit nëse ato përbëjnë shkelje të etikës ose

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

jo, gjithashtu shqyrton edhe sjellje të studentëve gjatë veprimtarisë së tyre mësimore në institucion nëse ato përbëjnë shkelje të etikës së studentit. Këshilli i Etikës merr vendim me shumicë të thjeshtë (50%+1) dhe i bën propozime Rektorit për këto çështje.

Rektori kryeson Senatin Akademik, drejton dhe koordinon aktivitetin mësimor dhe shkencor dhe botues të UET-it, ndjek dhe zbaton vendimet e Senatit Akademik dhe Administratorit të Shoqërisë dhe nxjerr akte të nevojshme në vijim të tyre. Garanton lirinë akademike e kërkimore të stafit, nënshkruan diplomat dhe certifikatat e tjera. Merr pjesë në hartimin dhe miratimin e rregullores dhe akteve rregullatorë të UET-it. Ai miraton kandidaturat e stafit akademik, merr vendim për propozimet e Këshillit të Etikës si dhe vepron në emër të UET-it dhe e përfaqëson para publikut të gjerë, në ceremoni e organizime të ndryshme dhe me të tretët; gjithashtu merr pjesë dhe përfaqëson UET-in në Konferencën e Rektorëve.

Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit dhe përfaqësuesi i tij. Ai organizon, koordinon dhe drejton punën mësimore e shkencore të fakultetit, si dhe ngre dhe miraton komisionet për përzgjedhjen e studentëve të rinj që pranohen çdo vit akademik. Është pjesë e komisionit për vlerësimin e kandidaturave të stafit akademik të UET-it, bën deklaratën e vlerësimin akademik të kandidaturës së përzgjedhur si pjesë e stafit akademik, e cila është kusht për lidhjen e Kontratës së punës mes pedagogut dhe UET-it; kur e sheh të arsyeshme, bën vlerësimin e pedagogëve gjatë vitit akademik. Dekani cakton persona për kryerjen e monitorimit dhe provimeve, si dhe drejton komisionet e transferimit dhe mobilitetit të studentëve, sipas parashikimeve të Rregullores së UET-it. Së bashku me Rektorin, Kryetarin e Komisionit të Diplomës, nënshkruan diplomat e studentëve, gjithashtu propozon masat disiplinore në Këshillin e Etikës për studentët dhe/ose për anëtarë të personelit akademik dhe atij ndihmës që kanë kryer veprime në kundërshtim me statutin dhe rregulloren e UET-it, kanë thyer kodin etik, apo nuk kanë respektuar detyrimet e përcaktuara në Kodin e Punës apo në kontratën e punës.

Drejtori i Institutit të Kërkimit organizon, koordinon, drejton dhe mbikëqyr punën kërkimore dhe shkencore të institutit. Ai ka të njëjtat kompetenca me ato të dekanit, brenda fushës së autoritetit të tij.

Përgjegjësi i Departamentit shqyrton planet dhe programet mësimore dhe propozon përmirësimet dhe ndryshimet e nevojshme, shqyrton dhe jep mendim për tekstet mësimore që do të përdoren, ndjek realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies. Miraton e firmos tezat e provimeve dhe merr pjesë në komisionet e rekrutimit të stafit akademik për departamentin që drejton. Bën vlerësimin e pedagogëve të departamentit gjatë vitit akademik.

Përgjegjësi i Qendrës përcakton programin dhe tematikën e punës shkencore në qendër si dhe kontrollon realizimin e programit në lidhje me studimet dhe trajnimet sipas tematikës përkatëse. Bashkëpunon ngushtë me departamentin përkatës dhe strukturat e tjera të UET-it.

Kancelari menaxhon veprimtarinë ekonomike, financiare e administrative të UET-it. Është përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të UET-it, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. Kancelari nënshkruan dhe lidh kontratat me studentët, ndjek arkëtimin e kuotave të studentëve, shlyerjen e detyrimeve të UET-it ndaj organeve shtetërore, për pagimin e taksave, tatimeve, dhe të detyrimeve ndaj të tretëve.

Zëvendësrektori përfaqëson Rektorin në rast të mungesës së tij, dhe kryen detyrat specifike të ngarkuara prej tij.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për çështjet e organizimit dhe administrimit të procesit akademik të mësimdhënies. Ndjek përmbushjen e detyrimeve të pedagogëve. Mbikëqyr procesin e transferimit, mobilitetit, ndërprerjes dhe rifillimit të studimeve të studentëve, sipas parashikimeve të Rregullores së UET-it. Nënshkruan, së bashku me dekanin e fakultetit, listën emërore të studentëve që fitojnë të drejtën e dhënies së provimit.

Kompetencat dhe përgjegjësitë për Bordin i Besimit, Senatin Akademik, Rektoratin, Këshillat e Fakulteteve, Këshillin i Etikës, Rektorin, Dekanët, Drejtorët e Instituteve, Përgjegjësit e Departamenteve dhe të Qendrave, Zëvendësrektorët, Kancelarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm janë përcaktuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në aktet nënligjore, Statutin, rregulloret, Kodin e Etikës dhe Kodin e Integritetit akademik, në aktet mbështetëse si dhe në kontratat individuale të punës.

UET-i garanton njohjen e kompetencave dhe përgjegjësiave prej anëtarëve të organeve drejtuese, përfaqësuesve të autoriteteve drejtuese, si dhe gjithë stafit.

h) Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontrata e punës me stafin drejtues, mësimdhënës lidhet nga Administratori, në cilësinë e punëdhënësit dhe miratohet nga dekani i fakultetit përkatës, në funksion të vlerësimit akademik, ose nga Rektori në rastin e kontratës së dekanit dhe drejtorit të instituteve.

Kontrata e punës me personelin mbështetës dhe administrativ lidhet nga Administratori.

Kontrata e punës për gjithë personelin lidhet dhe zgjidhet sipas klauzolave të kontratës, anekseve të saj, si dhe legjislacionit të punës. Tipet e kontratave në UET janë; kontratë rektori, kontratë dekani, kontratë përgjegjësi departamenti, kontratë pedagogu të brendshëm, kontratë pedagogu senior, kontratë pedagogu të jashtëm, kontratë pedagogu me ngarkesë të veçantë, si dhe kontratat për stafin administrativ..

Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm përzgjidhen me konkurs në përputhje me kriteret specifike të kualifikimit dhe performancës të zbatueshme në UET.

Kandidati i përzgjedhur merret fillimisht me kontratë pune 1-vjeçare; kontrata nënshkruhet nga Administratori dhe i punësuari, pasi kryhet dhe firmoset një deklaratë vlerësimi akademik nga Dekani ose nga Rektori në rastin e kontratës së dekanëve. Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, punonjësit me grada shkencore mund të lidhin kontratë pune me afat ose pa afat.

Për personelin akademik me kohë të pjesshme kontrata e punës është me afat semestral, me të drejtë rinovimi.

Detyrat dhe të drejtat e stafit drejtues, mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ janë përcaktuar në Statutin, rregulloret e institucionit, Kodin e Etikës dhe Kodin e Integritetit akademik, në dokumentet mbështetëse si dhe në kontratat individuale të punës dhe anekseve të kontratave.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

i) Baza e të dhënave e UET, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Baza e të dhënave, si dhe arkivimi apo ruajtja e tyre funksionon bazuar në Ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", në Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave "Për punën me dokumentet administrative në organet shtetërore e joshtetërore", në aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Kompletimi dhe freskimi i vazhdueshëm i të dhënave dhe informacionit për studentët, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor apo personelin administrativ kryhen nga Zyra e Arkiv – Protokoll – Statistikës, nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kancelarit.

j) Dokumentacioni përkatës:

1. Dosja e dokumenteve themelore të UET-it;
2. Vendimet e Senatit për hapjen e fakulteteve, departamenteve, programeve të studimit, instituteve dhe qendrave;
3. Dosja e rekrutimeve;
4. Dosja e kontratave;
5. Regjistri i amzës;
6. Regjistri themeltar.

III. ANALIZA E KURSEVE TË STUDIMIT, DIPLOMAVE, KURSEVE E SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE

a) Struktura didaktike e UET në përgjithësi, diplomat e lëshuara

Universiteti Europian i Tiranës aktualisht përbëhet nga tre fakultete: i) Fakulteti i Shkencave Sociale, ii) Fakulteti Juridik dhe iii) Fakulteti Ekonomik. UET-i ofron programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë të studimit.

Diplomë e Nivelit të Parë (DNP): “Juridik i përgjithshëm, ose i shoqëruar me profile” “Komunikim – Marrëdhënie publike”; “Shkenca politike”; “Marrëdhënie Ndërkombëtare”; “Ekonomik”; “Financë Bankë”; “Menaxhim Biznesi.” Të gjitha këto programe studimi ofrohen me kohë të plotë; me kohëzgjatje normale 3 vite akademike; dhe realizohen me së paku 180 ECTS.

Diploma të Nivelit të Dytë në: E drejtë private dhe biznesi; E drejtë publike dhe ndërkombëtare; Komunikim – Marrëdhënie publike; Shkenca Politike; Marrëdhënie ndërkombëtare; Financë Bankë; Administrim biznesi. Këto programe studimi ofrohen me kohë të plotë; kanë kohëzgjatje normale 2 vite akademike; dhe realizohen me së paku 120 ECTS.

Diploma Master të Nivelit të Parë në: E drejtë administrative; E drejtë ndërkombëtare; E drejtë evropiane; Gazetari; Marrëdhënie publike; Shkenca politike; Marrëdhënie ndërkombëtare – Diplomaci; Studime Evropiane; Banka dhe sigurime; Marketing; Menaxhim dhe administrim. Këto programe studimi ofrohen me kohë të plotë; kanë kohëzgjatje normale 1 vit akademik; dhe realizohen me së paku 60 ECTS.

UET synon, në një të ardhme të afërt, hapjen e ciklit të tretë të studimeve (MND & Doktoraturë).

b) Statistikat e pranimit për çdo kurs studimi: numri i aplikantëve, numri i të pranuarve, niveli cilësor i të pranuarve

Në periudhën fund marsi – fillimit prilli të çdo viti akademik, UET-i fillon fushatën e informimit dhe ndërgjegjësimit për pranimet e reja. Aplikantëve të interesuar iu kërkohet të plotësojnë si fillim një formular aplikimi, të dhënat e të cilëve përpunohen për të marrë një pasqyrë më të qartë të fluksit të interesimeve dhe karakteristikave cilësore të të interesuarve.

Në të njëjtën kohë, Zyra e Informacionit informon në vijimësi prindërit dhe kandidatët për studentë rreth programeve të studimit, cilësisë së personelit akademik, kriterëve të pranimit dhe shërbimeve të tjera që ofrohen, dhe iu jep mundësi të interesuarve të informohen rreth UET-it nëpërmjet kërkimit në faqen e tij të internetit.

Nga të dhënat e përpunuara rezulton se rreth 70% e të interesuarve dhe aplikantëve regjistrohen për të ndjekur studimet në programin e zgjedhur të studimit.

Synohet që në vitet e ardhshme të zbatohet kriteret më specifike për të tërhequr kontingjente gjithnjë e më cilësore. Deri më sot, janë përdorur vetëm politika nxitëse drejtuar nxënësve me notë mesatare të lartë, duke ofruar ulje të tarifës së shkollimit deri në 30%; si dhe duke ofruar bursa ekselence për studentët me rezultate të shkëlqyera të studimeve në UET.




UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Tabela më poshtë tregon numrin e studentëve të regjistruar për çdo program studimi, sipas vitit akademik. Gjithashtu tabela tregon edhe numrin e bursave të ofruara nga universiteti të kategorive të ndryshme si: sociale, talenti, lidershipi, ekselence; numrin e të transferuarve në UET nga universitete e shkolla të tjera të larta, brenda dhe jashtë vendit; si dhe numrin e studentëve të çregjistruar apo që kanë ndërprerë përkohësisht studimet. Gjithashtu për studentët e secilit program studimi është llogaritur nota mesatare në hyrje, e cila ka pësuar një rritje të ulët nga viti në vit, nga 7.09 për totalin e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2006-2007 në 7.26 për totalin e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2008-2009.

Tabela : Studentët e regjistruar sipas programeve të studimit dhe vitit akademik

Viti akademik	Dega	Totali i te regjistruarve	Nota mes.	Bursa	Të transferuar	Të çregjistruar	Të Shkëputur përkohësisht	Vazhdojnë Studimet
2006-2007	F. JURIDIK	61	7.02	2	4	11	3	47
	M. P. Komunikim	41	7.17	5	3	5	4	32
	M. Ndërkombëtare	51	7.30	12	1	2	4	45
	SH. Politike	22	6.67	1	-	3	1	18
	F. SHK. SOCIALE	114	7.12	18	4	10	9	95
	TOTALI	175	7.09	20	8	21	12	142
2007 - 2008	F. JURIDIK	179	6.97	10	19	21	4	154
	M. P. Komunikim	64	7.03	9	8	3	1	60
	M. Ndërkombëtare	54	7.24	4	8	4	1	49
	SH. Politike	43	7.21	4	12	2	-	41
	F. SH. SOCIALE	161	7.15	17	28	9	2	150
	Financë Bankë	48	7.38	2	1	2	-	46
	Menaxhim Biznesi	23	7.63	-	4	1	1	21
	Ekonomiks	3	8.18	1	-	1	-	2
	F. EKONOMIK	74	7.50	3	5	4	1	69
TOTALI	414	7.14	30	52	34	7	373	
2008 - 2009	F. JURIDIK	177	7.13	25	8	5	-	172
	M. P. Komunikim	72	7.05	9	1	2	1	69
	M. Ndërkombëtare	73	7.39	6	5	2	-	71
	SH. Politike	36	7.19	8	4	-	-	36
	F. SH. SOCIALE	181	7.21	23	10	4	1	176
	Financë Bankë	226	7.63	9	6	2	-	224
	Menaxhim Biznesi	178	7.00	3	9	7	-	171
	Ekonomiks	3	6.53	-	-	-	-	3
	F. EKONOMIK	407	7.35	12	15	9	-	398
TOTALI	765	7.26	60	33	18	1	746	
TOTALI UET		1354		110	93	73	20	1261


UET - Raporti i Vetëvlerësimit



Numri i studentëve në Fakultetin Juridik në vitin akademik 2006-2007 zinte rreth 35% të numrit të studentëve të regjistruar në UET, ndërsa në vitin 2007-2008, pavarësisht trifishimit të numrit absolut të studentëve, në vlerë relative zinte vetëm 43% dhe kjo për arsyen e diversifikimit të mundësive për të studiuar në UET edhe në fakultete të tjera. Ky numër pëson një zbritje të lehtë në vitin 2008-2009 dhe sot zë vetëm 31%. Gjithsesi rritja e numrit të studentëve në fakultetin Juridik

mund të konsiderohet e qëndrueshme.

Në fakultetin e Shkencave Sociale rritja e numrit të studentëve ka qenë progresive. Sot numri i studentëve të këtij fakulteti zë 34% të numrit të përgjithshëm të studentëve në UET. Rritja ka qenë e qëndrueshme dhe në përgjigje të pasurimit të mundësive të ndjekjes së degëve të ndryshme brenda këtij fakulteti.



Në vitin akademik 2007-2008, UET-i hapi një mundësi të re studimi për studentët, Fakultetin Ekonomik me degë në përputhje me tregun dhe mundësitë e punësimit. Pas një fillimi modest, në vitin akademik 2008-2009 Fakulteti Ekonomik arrin të thithë një numër shumë të madh studentësh (407), duke përbërë kështu rreth 35% të numrit të përgjithshëm të studentëve që studiojnë në UET, pavarësisht faktit që ende nuk është hapur viti i tretë i studimeve.


c) Numri i stafit mësimdhënës për çdo kurs studimi: stafi i brendshëm dhe i jashtëm

Tabela e mëposhtme tregon numrin e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në secilin nga programet e studimit DNP. Vëmë re se në çdo program studimi angazhohen 51 deri në 57 pedagogë dhe raporti të brendshëm/të jashtëm varion nga 1:1.2 deri në 1:2.3. Ndonëse synohet që ngarkesa kryesore mësimore të mbulohet nga personeli akademik i brendshëm, shpesh është zgjedhur që disiplina të caktuara mësimore të mbulohen me personel të jashtëm akademik, në funksion të thithjes së një personeli sa më të kualifikuar nga pikëpamja akademike dhe ekspertizës profesionale në fusha të veçanta të studimit.

Statusi i personelit akademik	Fakulteti i Shkencave Sociale			Fakulteti Juridik				Fakulteti Ekonomik	
	Shkenca Politike	Marrëdhënie ndërkombëtare	Marrëdhënie publike-komunikim	Juridik i Përgjithshëm	E drejta Publike & Kushtetuese	E drejta Ndërkombëtare & Europiane	E drejtë Biznesi	Menaxhim-Biznesi	Finance-Banka
Brendshëm	23	22	20	20	20	21	20	18	17
Jashtëm	28	30	31	36	37	33	37	35	39
Totali	51	52	51	56	57	54	57	53	56
Raporti personel i brendshëm/i jashtëm	1:1.2	1:1.4	1:1.6	1:1.8	1:1.9	1:1.6	1:1.9	1:1.9	1:2.3


d) Shkalla e kalueshmërisë: numri i studentëve në hyrje dhe në dalje

Grafiku më poshtë tregon kalueshmërinë e studentëve në total për vitin akademik 2006-2007. Shkalla e kalueshmërisë për sezonin e provimeve në qershor llogaritet 52.5%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë në 87%.




UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Grafiku i mëposhtëm pasqyron shkallën e kalueshmërisë së studentëve të vitit të parë dhe të dytë për vitin akademik 2007-2008. Në total, në sezonin e provimeve në qershor-korrik 2008 rezultuan kalues 375 studentë, ose rreth 74% e studentëve; në sezonin e riprovimeve në vjeshtë kalueshmëria u rrit me 18%, në 92%. Gjithashtu mund të vihet re se shkalla e kalueshmërisë për studentët e vitit të dytë është me e lartë, rreth 86% për sezonin e provimeve në qershor, sesa shkalla e kalueshmërisë për vitin e parë, rreth 69% në sezonin e provimeve në qershor. Kjo shpjegohet me faktin se studentët e vitit të dytë janë më të mësuar me mënyrën e kontrollit të dijeve në UET, si dhe janë ata që një vit më parë arritën të plotësonin detyrimet e nevojshme për të kaluar në vitin pasardhës.




e) Cilësia e kalueshmërisë: nota mesatare

Ky grafik tregon cilësinë e kalueshmërisë së studentëve të llogaritur për sezonin e provimeve në qershor 2008 për totalin e studentëve të UET-it.



UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Krahasuar me cilësinë e kalueshmërisë në sezonin e qershorit, në sezonin e riprovimeve në vjeshtë vihet re një rritje e lehtë e cilësisë së kalueshmërisë, çka është e kuptueshme duke marrë parasysh se studentët kanë mundësi të përmirësojnë jo vetëm rezultatet jokaluese, por edhe ato kaluese. Ata kanë të drejtë të përmirësojnë notën kaluese për dy lëndë në këtë sezon provimesh.



Shpërndarja cilësore e studentëve ka ndikuar në shumë aspekte të zhvillimit të procesit mësimor. Shumë vendime si: renditja e literaturës së detyrueshme, plotësuese dhe të rekomanduar; parimi i kontrollit të vazhdueshëm të dijeve; struktura e propozuar për hartimin e pyetjeve të provimeve kanë pasur si qëllim t'i përgjigjen pikërisht këtij realiteti të cilësisë së studentëve. Kështu synohet që studentët me rezultate të larta të kenë mundësi të avancojnë në plotësimin e njohurive dhe aftësive të tyre duke shfletuar literaturë plotësuese dhe të rekomanduar për lëndët që ndjekin, të testohen në mënyrë analitike; nga ana tjetër studentët me rezultate më të ulëta orientohen për literaturën bazë që duhet të shfletojnë, e cila është e domosdoshme të përvetësohet për një rezultat përfundimtar pozitiv, duke i dhënë përgjigje të paktën pyetjeve të provimit për kontrollin e njohurive.

f) Koordinimi midis kurseve të studimit

Një nga parimet themelore që është mbajtur parasysh në hartimin e kurrikulave të programeve të studimit ka qenë *parimi i interdiciplinaritetit*. Për nga vetë natyra e tyre, programet e studimit DNP ofrojnë njohuri dhe aftësi më të përgjithshme, me fokus më të zgjeruar sesa programet e cikleve më të larta të studimit. Për këtë arsye programet e ofruara nga 3 Fakultetet e UET-it janë të ndërthurura dhe kanë mjaft disiplina mësimore të përbashkëta. Sigurisht vendi që këto disiplina zënë në programet e studimit është i ndryshëm, bazuar në rolin që ato luajnë në formimin e studentit. Kështu p.sh., disiplina formuese të kategorive A dhe B tek programet e Fakultetit të Shkencave Sociale ofrohen si disiplina të zgjedhura ose integruese tek programet e Fakultetit Ekonomik dhe atij Juridik, në mënyrë që edhe studentët e këtyre fakulteteve të marrin disa njohuri bazë në fushën e shkencave sociale; e njëjta gjë mund të thuhet edhe për disiplinat formuese të dy fakulteteve të tjera. Si rezultat, krahas punës përgatitore që çdo njësi bazë kryen për planifikimin dhe zhvillimin e programeve përkatëse të studimit, një rol mjaft të rëndësishëm në këtë proces luan Sekretari i Përgjithshëm, për koordinimin e punës midis programeve të studimit.

g) Dokumentacioni përkatës

1. Dosja e aplikimeve dhe e pranimeve dhe Udhëzimi mbi kriteret dhe procedurat e pranimit;
2. Statistikat për kalueshmërinë;
3. Dosja e proces verbaleve të provimeve;

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

4. Tabela e shpërndarjes së pedagogëve sipas lëndëve brenda programit të studimit;
5. Tabela e shpërndarjes së lëndëve sipas pedagogëve.

IV. PROGRAMET E STUDIMIT, ORGANIZIMI I KURRIKULAVE NË KUADËR TË PROCESIT TË BOLONJËS DHE KREDITET

a) Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Universiteti Europian i Tiranës ka hapur në vitin akademik 2006-2007, 4 (katër) programe studimi Diplomë e Nivelit të Parë (DNP), të ciklit të parë të studimeve.

I. Fakulteti Juridik ofron programin e studimit DNP:

1. *Juridik i përgjithshëm,*

Synon përgatitjen e juristëve në nivelin universitar të karakterit të përgjithshëm, të cilët do të kenë bazat për profesionin e juristit, pjesëtarit të zyrave juridike, konsulent juridik. Ata janë të aftë për vazhduar studimet në programet Master i Nivelit të Parë dhe Diplomë e Nivelit të Dytë.

i shoqëruar me profilet :

a. *E drejtë biznesi*

Synon t'u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën për biznesin, sistemin ekonomik, të drejtat e pronësive, format e reja ekonomike dhe kontraktuale etj.

b. *E drejtë publike dhe kushtetuese*

Synon t'u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, dhe marrëdhëniet e tyre me sistemin politik.

c. *E drejtë ndërkombëtare dhe europiane*

Synon t'u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën e Bashkimit Evropian, traktatet e BE-së, si dhe të drejtën ndërkombëtare, institucionet ndërkombëtare etj.

II. Fakulteti i Shkencave Sociale ofron programet e studimit DNP:

1. *Gazetari*

Synon përgatitjen e gazetarëve dhe reporterëve të përgjithshëm për median shqiptare, të cilët do të jenë të aftë të përmbushin detyrat në pozicionin e reporterit, gazetarit, korrespondentit, redaktorit.

Ky program nuk është hapur si pasojë e mungesës së kërkesave për regjistrim.

2. *Marrëdhënie publike-komunikim*

Synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në Shkencat e Komunikimit dhe Marrëdhëniet Publike, të aftë të kryejnë funksione të ndryshme në tregun e punës si specialistë të medias dhe komunikimit.

3. *Shkenca Politike*

Synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në shkencat politike, që të jenë të aftë të njohin shkencat politike në tërësi, për të punuar në sektorin e shoqërisë civile, në media, në organizmat politike, specialistë në administratën publike, në të gjithë sektorët e saj.

4. *Marrëdhënie ndërkombëtare*

Synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare

dhe diplomacisë, që të jenë të aftë të punojnë në sektorin e diplomacisë, të organizatave ndërkombëtare, në administratën publike.

Në vitin akademik 2007-2008 u licencuan 4 programe të tjera studimi DNP.

III. Fakulteti Ekonomik ofron programet DNP:

1. *Ekonomik*

Përmes këtij programi studimesh synohet përgatitja e ekonomistëve me njohuri të përgjithshme ekonomike duke filluar që nga aspektet financiare, kontabël të një ndërmarrjeje deri në menaxhimin dhe organizimin e punës si në ndërmarrjet shtetërore, ashtu edhe në ato private.

2. *Financë & Banka*

Përmes këtij kursi studimesh synohet përgatitja e ekonomistëve të specializuar në problemet financiare, kontabël, banka, shoqëri sigurimesh, etj., të cilët do të jenë të aftë të përmbushin detyrat dhe funksionet në pozicionet e financierit të firmave dhe bizneseve të ndryshme, të ekspertit kontabël të niveleve të ndryshme, të punonjësve të bankave dhe shoqërive të sigurimit, të eksperteve dhe analistëve të tregjeve financiare, të punonjësve të degëve të tatim-taksave, sistemit doganor, etj.

3. *Menaxhim biznesi*

Përmes këtij programi studimesh synohet përgatitja e ekonomistëve të specializuar në problemet drejtimit dhe menaxhimit të bizneseve të kategorive të ndryshme (biznes i vogël, biznes i madh), të bizneseve në sfera të ndryshme aktiviteti (prodhimi, shërbimesh, tregtar, mediatik, etj.), bizneseve private ose publike të llojeve të ndryshme, biznese kombëtare ose ndërkombëtare, etj.

4. *Administrim publik*

Përmes këtij programi studimesh synohet përgatitja e ekonomistëve dhe administratorëve të specializuar në problemet e menaxhimit publik të aftë që të punojnë në institucionet qendrore dhe administratën publike, në administratën dhe strukturat e pushtetit vendor si prefektura, bashki e komuna, ndërmarrje publike kombëtare, rajonale apo lokale, në administrimin e firmave apo korporatave të brendshme e të huaja, etj.

Programet e studimit Ekonomik dhe Administrim publik nuk janë hapur si pasojë e mungesës së kërkesave për regjistrim.

b) Programet për çdo kurs studimi, lëndët dhe ngarkesa mësimore për çdo lëndë
Programet e Studimit – (tabelat në Excel bashkëngjitur)


c) Programet e studimit me ngarkesat e lëndëve për pedagog

Numri i lëndëve me të cilat organizohen programet e studimit janë si më poshtë:

- *Juridik i përgjithshëm*: 42 disiplina, nga të cilat 12 të përbëra*; 15 të detyrueshme dhe 27 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 7.
- *Marrëdhënie publike komunikim*: 45 disiplina, nga të cilat 11 të përbëra; 15 të detyrueshme dhe 30 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 7.
- *Shkenca Politike*: 45 disiplina, nga të cilat 11 të përbëra; 15 të detyrueshme dhe 30 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 7.
- *Marrëdhënie ndërkombëtare*: 45 disiplina, nga të cilat 11 të përbëra; 15 të detyrueshme dhe 30 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 7.
- *Financë Banka*: 39 disiplina, nga të cilat 11 të përbëra; 16 të detyrueshme dhe 23 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 6.
- *Menaxhim biznesi*: 39 disiplina, nga të cilat 11 të përbëra; 16 të detyrueshme dhe 23 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 6.

Gjatë këtij viti akademik, 2008-2009, për zhvillimin e programit të studimit DNP “Juridik” janë angazhuar 57 pedagogë; në programin e studimit DNP “Marrëdhënie publike – Komunikim” 51 pedagogë; në programin e studimit DNP “Shkenca Politike” 51 pedagogë; në programin DNP “Marrëdhënie ndërkombëtare” 52 pedagogë; në programin e studimit DNP “Financë Banka” 56 pedagogë; në programin DNP “Menaxhim Biznesi” 53 pedagogë.

Grafiku i mëposhtëm tregon shpërndarjen e pedagogëve sipas numrit të lëndëve që ata mbulojnë në vitin akademik 2008-2009. Sikurse shihet 64% e pedagogëve janë angazhuar në zhvillimin e një disipline të vetme; ndërsa 19% e tyre janë angazhuar në 2 disiplina; 12% në 3 disiplina dhe vetëm 5% në 4 të tilla.



* Disiplinat/lëndët e përbëra janë përgjithësisht vjetore dhe zhvillohen në dy pjesë; mund të zhvillohen nga pedagogë të ndryshëm. Në përfundim të tyre studenti vlerësohet me një notë të vetme dhe i merr kreditet e lëndës pas shlyerjes së të dy pjesëve përbërëse.

d) Numri i semestrave dhe i lëndëve për çdo program studimi

Viti akademik në UET përbëhet nga dy semestra me shtrirje në 15 javë secili. Kjo ndarje vlen për të dy nivelet e studimit në UET. Semestri i parë përfshin periudhën tetor - shkurt dhe semestri i dytë periudhën mars - qershor.

Puna për rishikimin e ndarjes së lëndëve nëpër semestra fillon jo më vonë se dy muaj përpara fillimit të vitit akademik. Ky proces kryhet nga Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësit e Departamenteve, në koordinim me Sekretarin e Përgjithshëm të universitetit.

Kriteret që mbahen parasysh gjatë punës planifikuese, ndër të tjera, janë: sequenca logjike e zhvillimit të lëndëve; ndarja e balancuar e ngarkesës mësimore për studentët; vështirësia e lëndës dhe njohuritë që jepen në të, numri i krediteve dhe kushtëzimet paraprake (prerekuizitat); si dhe plotësimi i ngarkesës së personelit akademik të brendshëm, sipas parashikimeve të kontratës së lidhur me UET-in.

Këta elementë të rëndësishëm, janë mbajtur parasysh në të gjitha programet e ofruara në UET. Gjithashtu, është mbajtur parasysh fakti që lëndët e nivelit të përgjithshëm teorik të jenë pararendëse të lëndëve me natyrë praktike apo të kombinuara, si dhe lëndët bazë për formimin profesional të studentit.

Në UET, përveç semestrave kryesorë, zhvillohet edhe një semestër veror që i krijon mundësi studentëve të marrin jo më shumë se dy lëndë, të cilat zhvillohen në mënyrë intensive gjatë 5 javëve, duke respektuar ngarkesat mësimore sipas numrit të krediteve për lëndë.

I. Fakulteti Juridik

Në Fakultetin Juridik, numri i lëndëve në total sipas shpërndarjes në semestër, për nivelin e parë të studimit, për vitin akademik 2008-2009, është si më poshtë:

Viti i parë :

- a. 8 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 4 të detyrueshme dhe 4 me zgjedhje;
- b. 12 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 6 lëndë të detyrueshme dhe 6 lëndë me zgjedhje.

Viti i dytë:

- a. 12 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 4 lëndë të detyrueshme dhe 8 lëndë me zgjedhje, dhe
- b. 17 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 4 lëndë të detyrueshme dhe 13 lëndë me zgjedhje.

Viti i tretë:

- a. 6 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 të detyrueshme dhe 3 me zgjedhje; dhe
- b. 10 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 6 të detyrueshme dhe 4 lëndë me zgjedhje. Në 6 lëndët e detyrueshme të semestrit të dytë, të këtij viti, përfshihet edhe praktika dhe punimi i diplomës.

Shënim: 4 nga lëndët e detyrueshme të semestrit të dytë të vitit të tretë kanë qenë pjesë e programit të vitit të dytë, përpara se programi të rishikohej, dhe tashmë janë duke u zhvilluar me një numër shumë të kufizuar studentësh 4-8 studentë, të cilët nuk i kanë frekuentuar këto lëndë në vitin akademik 2007-2008.

II. Fakulteti i Shkencave Sociale

Në Fakultetin e Shkencave Sociale, numri i lëndëve në total sipas shpërndarjes në semestër, për programet e ciklit të parë të studimit, për vitin akademik 2008-2009, është si më poshtë:

Marrëdhënie publike-komunikim

Viti i parë :

- a. Semestri I: 12 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 6 të detyrueshme dhe 6 me zgjedhje (studenti zgjedh 1 prej tyre);
- b. Semestri II: 9 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 4 lëndë të detyrueshme dhe 5 lëndë me zgjedhje ;

Viti i dytë:

- a. Semestri I: 9 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 lëndë të detyrueshme dhe 6 lëndë me zgjedhje,dhe
- b. Semestri II: 15 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 4 lëndë të detyrueshme dhe 11 lëndë me zgjedhje.

Viti i tretë:

- a. Semestri I: 5 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 të detyrueshme dhe 2 me zgjedhje; dhe
- b. Semestri II: 7 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 5 të detyrueshme dhe 2 lëndë me zgjedhje. Në 5 lëndët e detyrueshme të semestrit të dytë, të këtij viti, përfshihet edhe praktika dhe punimi i diplomës.

Shkenca Politike

Viti i parë :

- a. Semestri I: 12 lëndë në semestrin e parë, nga te cilat 6 të detyrueshme dhe 6 me zgjedhje;
- b. Semestri II: 10 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 5 lëndë të detyrueshme dhe 5 lëndë me zgjedhje.

Viti i dytë:

- a. Semestri I: 8 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 lëndë të detyrueshme dhe 5 lëndë me zgjedhje;
- b. Semestri II: 17 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 6 lëndë të detyrueshme dhe 11 lëndë me zgjedhje.

Viti i tretë:

- a. Semestri I: 5 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 të detyrueshme dhe 2 me zgjedhje; dhe
- b. Semestri II: 8 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 7 të detyrueshme dhe 1 lëndë me zgjedhje. Në 7 lëndët e detyrueshme të semestrit të dytë, të këtij viti, përfshihet edhe praktika dhe punimi i diplomës.

Marrëdhënie ndërkombëtare

Viti i parë :

- a. Semestri I: 12 lëndë në semestrin e parë, nga te cilat 6 të detyrueshme dhe 6 me zgjedhje;
- b. Semestri II: 10 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 5 lëndë të detyrueshme dhe 5 lëndë me zgjedhje.

Viti i dytë:

- a. Semestri I: 11 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 4 lëndë të detyrueshme dhe 7 lëndë me zgjedhje;
- b. Semestri II: 16 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 6 lëndë të detyrueshme dhe 10 lëndë me zgjedhje.

Viti i tretë:

- a. Semestri I: 4 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 të detyrueshme dhe 1 me zgjedhje; dhe
- b. Semestri II: 9 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 5 të detyrueshme dhe 4 lëndë me zgjedhje. Në 5 lëndët e detyrueshme të semestrit të dytë, të këtij viti, përfshihet edhe praktika dhe punimi i diplomës.

Shënim: Numri i lëndëve që është llogaritur si ngarkesë për studentët e vitit të tretë të këtij viti akademik përfshin edhe lëndët e viteve paraardhëse akademike, të cilat në reformën që iu bë programeve të studimit të Fakultetit të Shkencave Sociale kaluan nga lëndë me zgjedhje në lëndë me detyrim, duke e bërë të detyrueshëm frekuentimin e tyre nga studentët e vitit të tretë që nuk i kishin zgjedhur më parë.

III. Fakulteti Ekonomik

Numri i lëndëve në total sipas shpërndarjes në semestër, për programet e ciklit të parë të studimit, për vitin akademik 2008-2009, është si më poshtë:

Viti i parë

- a. 6 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 6 të detyrueshme dhe asnjë me zgjedhje
- b. 10 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 6 të detyrueshme dhe 4 me zgjedhje (zgjedh 1 nga 4 mundësitë që ofrohen).

Viti i dytë – Programi Financë dhe Banka

- a. 11 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 5 të detyrueshme dhe 6 me zgjedhje;
- b. 9 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 4 të detyrueshme dhe 5 me zgjedhje.

Viti i dytë – Programi Menaxhim Biznesi

- a. 10 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 5 të detyrueshme dhe 5 me zgjedhje;
- b. 11 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 5 të detyrueshme dhe 6 me zgjedhje.

Viti i tretë

Do të ofrohen 5 lëndë me detyrim (përfshirë praktikën dhe diplomën) për secilin program studimi dhe 7 lëndë me zgjedhje për të bërë plotësimin e krediteve. Në ndarjen nëpër semestra do të synohet që semestri i dytë të jetë më pak i ngarkuar me qëllim që studentët të mund të fokusohen në ndjekjen e praktikës dhe punimin e diplomës.

e) Vendi i çdo lënde në programin e studimit; përputhja e lëndëve dhe e ngarkesës për çdo lëndë me programin e studimit në tërësi

Që në fillim të aktivitetit të tij, UET-i u strukturua dhe funksionoi në përputhje me kërkesat kryesore të procesit të Bolonjës. Në vitin 2008 kurrikula e programeve të studimit u përshtat në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9741, datë 21/05/2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 15, datë 04/04/2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”. Studentët që vazhdonin studimet në UET u asistuan në mënyrë të personalizuar në fillim të vitit akademik 2008 - 2009 për të përshtatur studimet e tyre në përputhje me strukturën e re kurrikulare.

Për të ilustruar strukturën e re të programeve të studimit më poshtë është marrë si shembull programi i studimit DNP “Juridik”. Të gjitha programet e tjera të studimit të ofruara në UET janë të ndërtuara sipas të njëjtës strukturë, por me specifikat e tyre për sa i përket numrit të lëndëve dhe përqindjes së krediteve për çdo kategori disiplinash.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Programet e studimit në Fakultetin Juridik janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të vlerësojnë peshën e secilës lëndë në formimin profesional të juristëve të ardhshëm në të gjitha profilet e parashikuara. Për këtë arsye, struktura e programit mësimor përbëhet nga lëndë të formimit profesional të përgjithshëm dhe të profilizuar.

Konkretisht, kjo strukturë mësimore përbëhet nga gjashtë kategori të rëndësishme lëndësh:

A - Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë). Kjo kategori përbëhet nga 4 lëndë ku studenti pajiset me njohuritë më të domosdoshme në formimin e një juristi, për të kuptuar dhe përvetësuar njohuritë teorike të lëndëve të shkencave Juridike. Në total lëndët e kësaj kategorie kanë 34 kredite, ose rreth 19% të programit.

B – Disiplina të formimit karakterizues të programit. Kjo kategori përbëhet nga 10 lëndë që krijojnë formimin e tyre sipas programeve të studimit dhe profileve brenda secilit program. Në këtë kategori 8 lëndë janë të detyrueshme për të gjithë studentët, dhe 2 lëndë janë lëndë opsionale specifike sipas profileve. Këto lëndë opsionale zgjidhen nga studentët ndër 5 lëndët e propozuara në vitin e II dhe të III të studimeve. Lëndët e kësaj disipline kanë në total 99 kredite, ose përbëjnë 55% të programit të studimit.

C - Disiplina formuese të ngjashme ose integruese. Kjo kategori i ofron studentëve të Fakultetit Juridik mundësinë për të krijuar ose zgjeruar njohuritë në lëndë të ngjashme të shkencave juridike me ato që zhvillojnë në programin e tyre të studimit, apo edhe të marrin njohuri nga shkenca të tjera, siç mund të jenë: shkencat sociale e politike apo ato ekonomike. Në këtë kategori studentët zgjedhin 2 lëndë në total, nga 10 lëndët e ofruara për këtë qëllim në këtë disiplinë, nga të cilat një duhet të jetë lëndë e përbërë. Në varësi të kombinimeve të mundshme studenti merr në këtë kategori nga 15-18 kredite, pra plotëson 8-10% të programit në këtë kategori.

D – Disiplina formuese të zgjedhura. Në këtë kategori përfshihen lëndë të formimit të përgjithshëm shoqëror. Studentët zgjedhin 2 lëndë nga 10 të ofruara, që ata mendojnë se i ndihmon në formimin e përgjithshëm. Për shkak të fleksibilitetit në zgjedhje, këto lëndë njihen edhe si kurse të lira. Këto lëndë mund të zgjidhen nga studenti në secilin prej viteve akademike të studimit, që ai vetë e çmon. Në programin mësimor, lëndët e kësaj kategorie kanë 10-12 kredite dhe ato zënë 6-7 % të ngarkesës së tij.

Në këtë disiplinë ofrohet edhe një kurs special, i cili varion sipas nevojave për dhënien e koncepteve apo njohurive, kryesisht praktike dhe njohëse, në një fushë të caktuar, që çmohet e rëndësishme në një moment të caktuar.

E – Veprimtari formuese. Në këtë kategori janë lëndët që kanë rol mbështetës në formimin e studentëve si: gjuhë të huaja, informatikë dhe praktika mësimore. Gjuhët e huaja (anglisht/frëngjisht) zhvillohen në vitin e parë të studimeve, ndërsa praktika në vitin e tretë të tij. Në total kjo kategori ka 17-20 kredite, ose zë 9-11% të programit të studimit.

F – Punimi i diplomës. Punimi i diplomës zhvillohet në vitin e tretë të programit të studimit dhe është mbyllja e këtij programi. Ky punim ka 7 kredite dhe zë rreth 4 % të programit.

Shënim: Lëndët në kategorinë A, B (me përjashtim të BII), E (me përjashtim të Informatikës) dhe F janë të detyrueshme, ndërsa ato në kategorinë C dhe D janë me zgjedhje. Lëndët me 10 dhe 12 kredite përbëhen nga dy module, ku zgjedhja e njëres kërkon domosdoshmërisht zgjedhjen e tjetrës. Studenti në të vlerësohet me një notë përfundimtare të vetme që përmbledh vlerësimin e marrë në të dy modulet.

f) Literatura për çdo lëndë dhe cilësia e saj

Mënyra e përzgjedhjes dhe përdorimit të literaturës është një aspekt shumë i rëndësishëm i aktivitetit akademik. Në fillim të semestrit në të gjitha Departamentet diskutohet përcaktimi i literaturës për çdo lëndë. Literatura ndahet në këto kategori: literaturë bazë, literaturë plotësuese dhe literaturë e rekomanduar. Literatura pasqyrohet në programin e lëndëve, e detajuar për çdo temë.

Për të siguruar transmetimin sa më të mirë të njohurive bashkëkohore tek studentët, përzgjedhja e literaturës në UET bëhet mbi bazën e përdorimit si tekste bazë të librave më të mirë të botuar nga universitetet perëndimorë ose shtëpitë botuese më prestigjioze perëndimore. Për këtë departamentet vlerësojnë shkallën e pajisjes së tregut të librave akademike me botime bashkëkohore sipas fushave të lëndëve që mbulojnë. Për literaturën bazë të pambuluar departamentet, në bazë të një plani, i propozojnë UET Press-it listën e librave më të domosdoshëm që duhet të përkthehen e botohen. Synimi është që në një kohë sa më të shkurtër të gjithë lëndët të mbulohen më libra nga më të përparuarit në fushat përkatëse.

Kur departamentet vlerësojnë si shumë të rëndësishme, për specifikat e lëndëve që trajtojnë, referimin e dukurive shoqërore tipike shqiptare, atëherë si literaturë plotësuese, ose e rekomanduar përdoren edhe tekste të përgatitura nga autorë shqiptarë.

Në UET është inkurajuar botimi i teksteve monografike nga pedagogët. Këto tekste janë përdorur si literaturë plotësuese apo literaturë e rekomanduar.

g) Transferimi i sistemit europian të krediteve (ECTS); ngarkesa në pikë krediti brenda dhe jashtë auditorit

Konceptimi dhe përcaktimi i krediteve në UET është ndërtuar në bazë të parimeve të procesit të Bolonjës, në përputhje me Ligjin "Për Arsimin e Lartë në RSH", me qëllim mundësimin e mobilitetit dhe të transferimit të tyre nga njëri institucion i arsimit të lartë tek tjetri, brenda dhe jashtë vendit.

Lëndë Teorike	Lëndë Praktike
6 ECTS = 150 orë punë	6 ECTS = 150 orë punë (lëndë praktike)
<p><i>Orë në auditor</i> 15 javë x (3 orë leksion + 1 orë seminar) = 60 orë</p> <p>Në total: 60 orë</p> <p><i>Orë pune individuale</i> 15 javë x 2 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 30 orë 10 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 10 orë 30 orë kërkime në bibliotekë = 30 orë 20 orë për përgatitjen e provimit final = 20 orë Në total: 90 orë</p>	<p><i>Orë në auditor</i> 15 javë x (2 orë leksion + 2 orë seminar) = 60 orë</p> <p>Në total: 60 orë</p> <p><i>Orë pune individuale</i> 15 javë x 2 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 30 orë 10 orë përgatitje x 2 detyra praktike = 20 orë 25 orë kërkime në bibliotekë = 25 orë 15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë Në total: 90 orë</p>

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Lëndë Teorike	Lëndë Praktike
5 ECTS = 125 orë punë (lëndë teorike)	5 ECTS = 125 orë punë (lëndë praktike)
<p><i>Orë në auditor</i> 15 javë x (2 orë leksion + 1 orë seminar) = 45 orë 5 orë projekt detyra Në total: 50 orë</p> <p><i>Orë pune individuale</i> 15 javë x 1.5 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 22.5 orë 7.5 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 7.5 orë 30 orë punë kërkimore në bibliotekë = 30 orë 15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë Në total: 75 orë</p>	<p><i>Orë në auditor</i> 15 javë x (1 orë leksion + 2 orë seminar) = 45 orë 5 orë projekt detyra Në total: 50 orë</p> <p><i>Orë pune individuale</i> 15 javë x 1 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 15 orë 10 orë përgatitje x 2 detyra praktike = 20 orë 25 orë kërkime në bibliotekë = 25 orë 15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë Në total: 75 orë</p>
3 ECTS = 75 orë punë	3 ECTS = 75 orë punë
<p><i>Orë në auditor</i> 15 javë x (1 orë leksion + 1 orë seminar) = 30 orë</p> <p><i>Orë pune individuale</i> 15 javë x 1 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 15 orë 5 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 5 orë 10 orë kërkime në bibliotekë = 10 orë 15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë Në total: 45</p>	<p><i>Orë në auditor</i> 15 javë x 2 orë leksion/seminar = 30 orë</p> <p><i>Orë pune individuale</i> 15 javë x 1 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 15 orë 5 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 5 orë 5 orë përgatitje x 2 detyra praktike = 10 orë 15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë Në total: 45</p>

h) Dokumentacioni përkatës

1. Tabela e shpërndarjes së lëndës sipas pedagogëve;
2. Udhëzim mbi Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore;
3. Formulari i përshtatjes së programit me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 15, Dt. 04/04/2008 "Për organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë";
4. Rregulloret e programeve të studimit;
5. Udhëzimi mbi rekomandimin e literaturës;
6. Dosja e formularëve për zgjedhjen e lëndëve;
7. Programet e kurseve të studimit;
8. Programet mësimore të lëndëve.

* Kuptimi i këtyre 5 orëve ka të bëjë me organizimin e një veprimtarie të zgjeruar me studentë, gjatë të cilës bëhet prezantimi dhe diskutimi i punimeve më të mira të eseve të studentëve, shoqëruar me seanca pyetje – përgjigje.

V. STAFI MËSIMDHËNËS


a) Struktura e stafit kryesor në kurrikulën e çdo kursi studimi

Tabela më poshtë tregon strukturën e personelit akademik për çdo program studimi. Siç shihet numri i anëtarëve të stafit akademik me të njëjtin titull/gradë është përgjithësisht i përafërt sipas programeve të studimit. UET-i nuk shfaq disbalanca në politikat e përzgjedhjes së stafit akademik për program studimi.

Statusi i personelit akademik	Fakulteti i Shkencave Sociale			Fakulteti Juridik				Fakulteti Ekonomik	
	Shkenca Politike	Marrëdhënie ndërkombëtare	Marrëdhënie publike-komunikim	Juridik i Përgjithshëm	E drejta Publike & Kushtetuese	E drejta Nderkombëtare & Europiane	E drejtë Biznesi	Menaxhim-Biznesi	Finance-Banka
Totali	51	52	51	56	57	54	57	53	56
Prof. Dr.	5	4	6	7	7	6	8	4	5
Prof. As. Dr.	4	4	3	4	4	4	3	2	2
Dr.	11	14	9	10	11	11	11	14	14
Lektorë	30	30	33	35	35	33	35	33	35

b) Numri i stafit me kohë të plotë i tre viteve të fundit

Grafiku i mëposhtëm tregon rritjen progresive të personelit akademik të brendshëm në UET gjatë këtyre 3 viteve të aktivitetit akademik. Kështu në vitin akademik 2006-2007 janë angazhuar 7 pedagogë me kohë të plotë; 19 pedagogë për vitin akademik 2007-2008 dhe 35 pedagogë për vitin akademik 2008-2009.



UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e personelit të brendshëm akademik sipas titullit/gradës dhe gjinisë.

Personeli i brendshëm akademik										
Viti akademik	Prof. Dr.		Prof. Asoc.		Dr.		Lektorë		Totali	Femra
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
2006-2007	1	0	2	0	1	0	3	1	7	1
2007-2008	3	0	1	0	5	1	10	5	19	6
2008-2009	1	0	3	2	10	4	21	12	35	18

c) Raporti midis stafit mësimdhënës dhe numrit të studentëve për çdo kurs studimi

Raporti i totalit të numrit të pedagogëve (të brendshëm dhe të jashtëm), me studentët, për kurs studimi, paraqitet si më poshtë:

Statusi i personelit akademik	Fakulteti i Shkencave Sociale			Fakulteti Juridik				Fakulteti Ekonomik	
	Shkenca Politike	Marrëdhënie ndërkombëtare	Marrëdhënie publike-komunikim	Juridik i Përgjithshëm	E drejta Publike & Kushtetuese	E drejta Ndërkombëtare & Europiane	E drejtë Biznesi	Menaxhim-Biznesi	Finance-Banka
Pedagogë për program studimi	51	52	51	56	57	54	57	53	56
Studentë	95	165	161	373				197	270
Raporti pedagogë / studentë	1:2	1:3	1:3	1:7				1:4	1:5
Pedagogë të brendshëm	23	22	20	20	20	21	20	18	17
Raporti pedagogë të brendshëm/ studentë	1:4	1:8	1:8	1:19				1:11	1:16

Raporti i vogël pedagogë/studentë, i konstatuar në të gjitha programet e studimit të UET-it tregon për ndërthurjen e lartë që kanë me njëri-tjetrin programet e studimit DNP, në funksion të parimit të interdisiplinaritetit që synon të pasurojë programet e studimit që ofrohen, për t'iu përgjigjur kërkesave dhe interesave të shumëllojshme të studentëve. Kështu një lëndë e formimit bazë që ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, shfaqet në kategorinë C ose D në dy fakultetet e tjera dhe anasjelltas.

Në rast se llogaritet në bazë njësie kryesore, ky raport paraqitet si në tabelën më poshtë:

VITI AKADEMIK 2008-2009	Fakulteti			Totali
	Juridik	Shkenca Sociale	Ekonomik	
Numri i studentëve	373	421	467	1261
Numri i pedagogëve	28	47	56	131
Raporti pedagogë /studentë	1:13	1:9	1:8	1:10
Të brendshëm	9	16	10	35
Raporti pedagogë të brendshëm /studentë	1:41	1:26	1:47	1:36

Ndonëse kur përlogaritet në bazë të njësive kryesore raporti pedagogë/studentë pëson një rritje, përsëri ai është në nivel të tillë që reflekton zhvillimin e mësimdhënies me grupe të vogla, për të rritur ndërveprimin pedagog-student, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies së dijes nga studentët. Raporti i çbalancuar mes pedagogëve të brendshëm dhe studentëve shpjegohet me faktin se UET-i është në vitin e tretë të aktivitetit akademik dhe nuk ka plotësuar ende strukturën e tij me hapjen e programeve Diplomë e Nivelit të Dytë, pjesë e ciklit të dytë të studimeve.


d) Mbulimi i lëndëve me pedagogë: numri i pedagogëve, numri i disiplinave, ngarkesa mësimore

Numri i disiplinave që ofrohen në programet e studimit DNP, sipas njësive kryesore janë:

- Fakulteti Juridik: 35 disiplina
- Fakulteti i Shkencave Sociale: 58 disiplina
- Fakulteti Ekonomik: 42 disiplina


Për një total prej 135 disiplinash mësimore, pa përfshirë praktikën profesionale dhe punimin e diplomës.

Për mbulimin e këtyre disiplinave mësimore gjatë vitit akademik 2008-2009 janë angazhuar 131 pedagogë. Në shpërndarjen e ngarkesës mësimore janë mbajtur parasysh këto kriteret kryesore: kualifikimi i personelit akademik; fusha e ekspertizës për secilin anëtar; norma që duhet plotësuar në bazë të kontratës së lidhur me universitetin; parimi që asnjë anëtar i personelit akademik të mos japë më shumë se 4 lëndë në një vit akademik.



Sikurse tregon edhe grafiku i mësipërm, pjesa më e madhe e personelit akademik (64%) është angazhuar për të dhënë mësim vetëm në një disipline mësimore; 19% e personelit akademik është angazhuar në 2 disiplina mësimore; 12% në 3 disiplina dhe 5% në numrin maksimal të lejuar të disiplinave, 4 të tilla.

Në këtë grafik tregohet shpërndarja e numrit të pedagogëve sipas ngarkesës në orë mësimore për vitin akademik 2008-2009. Shihet se 51% e pedagogëve kanë normë më të ulët se 100 orë mësimore në vit; përgjithësisht këta janë pedagogë të jashtëm. Gjithashtu përqindja e pedagogëve me normë nga 300-400 orë mësimore në vit dhe mbi 400 orë mësimore është mjaft e ulët, vetëm 5% secila.



e) Shpërndarja e ngarkesës mësimore në lëndët e një kursi studimi

Shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik realizohet duke iu përmbajtur disa parimeve themelore:

- çdo anëtar i personelit akademik nuk mund të zhvillojë më shumë se 4 lëndë në vit akademik;
- për përcaktimin konkret të këtyre lëndëve merret parasysh niveli i ekspertizës kërkimore dhe akademike të çdo anëtari të stafit, si dhe domosdoshmëria që lëndët të kenë afërsi, lidhje organike mes tyre ose zhvillimi i tyre të jetë vijim i njëra-tjetrës;
- mbahet parasysh që shpërndarja e lëndëve të një anëtari të personelit akademik të jetë e balancuar në të dy semestrat;
- në rast se anëtari i stafit akademik zhvillon mësim në të dy ciklet e studimit, mbahet parasysh edhe shpërndarja e balancuar e lëndëve sipas cikleve të studimit (DNP – MNP/DND).

Kriteret e mësipërm mbështeten edhe në disa standarde të tjerë, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në ngarkesën mësimore të personelit akademik. Kështu p.sh. një grup seminari si rregull nuk e kalon numrin prej 30 studentësh, ndërkohe që një grup leksioni nuk përbëhet nga më shumë se tre grupe mësimore seminari (që do të thotë jo më shumë se 90 studentë).

Në UET është bërë kujdes që, përgjithësisht, anëtari më i kualifikuar i personelit akademik në një grup të caktuar lëndësh të mbulojë lëndën/lëndët që janë më të lidhura me specifikat e kursit përkatës. Ky rregull është shoqëruar me nevojën që në përcaktimin përfundimtar të ngarkesës mësimore të stafit të merret parasysh edhe eksperiencia në fushën e mësimdhënies.

f) Angazhimi i stafit mësimdhënës në kurse studimi jashtë strukturës së punësimit

Objektivi dhe synimi themelor i UET-it është krijimi i një stafi të konsoliduar e sa më cilësor në shërbim të mësimdhënies e kërkimit shkencor. Përveç angazhimit me kohë të plotë apo me kohë të pjesëshme në UET, personeli akademik angazhohet edhe në kurse të tjera studimi jashtë strukturës së punësimit, të tilla si programe Masteri, programe të ciklit të parë ose të dytë, kurse speciale, etj., në universitete brenda dhe jashtë vendit, institucione kërkimore-shkencore, organizata ndërkombëtare, OJF, struktura publike, etj.

Ne çdo rast, ky angazhim mësimdhënës miratohet nga strukturat drejtuese të UET-it dhe përgjithësisht korrespondon me angazhimet dhe bashkëpunimet institucionale të tij në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të miratuara.

Pedagogë të ndryshëm të UET-it, janë ftuar të japin mësim në kurse të caktuara studimi në disa universitete të huaja në Francë, Angli, Itali, Spanjë, SHBA, Greqi, Maqedoni, Kosovë, Turqi, etj., janë gjithashtu të angazhuar në mësim-dhënie në disa universitete shqiptare si Universiteti “Fan Noli” i Korçës, Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Polis, Universiteti “Luarasi”, Universiteti Politeknik i Tiranës (Masteri IFG), etj.

g) Politikat e rekrutimit të stafit në zbatim të rregullave në fuqi

Rekrutimi i stafit mbështetet tërësisht në disa kriteret e elemente thelbësore të tilla si: (1) nevojat për staf të ri që përcaktohen në bazë të ngarkesës mësimore (sipas elementëve të saj të përcaktuara qartë për çdo kategori pedagogësh) aktuale dhe parashikimeve të shtrirjes dhe zgjerimit të UET/fakulteteve përkatëse në një periudhë afat-shkurtër e afat-mesme; (2) kërkesave për cilësinë dhe nivelin e kualifikimit të stafit, të përcaktuara në “Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore specifike, rregulloret dhe udhëzimet e veçanta të MASH-it, si dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të vetë UET-it.

Pas konsultimeve dhe miratimit paraprak të nevojave për staf të ri nga ana e organeve drejtuese, bëhet njoftimi i hapur publik në media, faqen e internetit të UET-it dhe në forma të tjera njoftimesh duke ekspozuar pozicionin e kërkuar, cilësitë dhe aftësitë e domosdoshme, llojin dhe afatin e dokumenteve që duhen dorëzuar, etj.

Dosjet e paraqitura nga çdo kandidat i nënshtrohen një seleksionimi paraprak nga komisionet e ngritura për këtë qëllim, duke propozuar kandidatët më cilësorë. Kandidatët e seleksionuar i nënshtrohen një procesi konkurrimi dhe intervistimi nga një komision përzgjedhës.

Kandidatëve të vlerësuar si të përshtatshëm dhe të përzgjedhur iu lihet në dispozicion një periudhë kohe për përgatitjen e programeve të lëndëve, ciklit të leksioneve e seminareve, shqyrtimit e përzgjedhjes së literaturës bazë e ndihmëse, njohjen me rregulloret dhe statutin e UET-it.

UET-i ka krijuar edhe dy kategori të veçanta të personelit akademik:

- Pedagogë “senior”
- Pedagogë “me ngarkesë të veçantë”

Për sa i përket kategorisë “senior”, përzgjidhen autoritetet më në zë në fushën akademike, sociale apo institucionale, si p.sh. anëtarë të Akademisë së Shkencave të RSH-së, apo autoritete të tjera drejtues të

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

institucioneve kryesore publike, ose private të vendit si ish-Gubernatori i Bankës së Shqipërisë, ish-Prokurori i Përgjithshëm, ish-Kryetari i Gjykatës së Lartë, ish-anëtarë të Gjykatës Kushtetuese etj. Këta persona ofrohen të japin konsulencën dhe ekspertizën e tyre në formën e cikleve të veçanta të leksioneve, si udhëheqës të lektorëve, si orientues në hartimin e kurrikulave, si oponentë të programeve të lëndëve të veçanta etj, për shkak të përvojës së tyre të shquar në fushat përkatëse. Për këto autoritete janë hartuar kontrata të veçanta shërbimi, të cilat parashikojnë pagesën në formën e honorarëve fikse vjetore për një periudhë të caktuar kohore gjatë një viti akademik.

Pedagogët “me ngarkesë të veçantë”, janë pedagogë, të cilët nga pikëpamja e marrëdhënies së punës nuk janë pedagogë me kohë të plotë, por që kanë një ngarkesë të caktuar për të plotësuar, duke pasur një bashkëpunim më të qëndrueshëm me UET-in.

h) Dokumentacioni i rekrutimit, dosjet e stafit

Dokumentacioni i depozituar për çdo anëtar të personelit akademik përmban:

- Kopje të diplomës së shkollës së lartë, shoqëruar me listë notash;
- Kopje të kualifikimeve të tjera të kryera;
- CV në format europian;
- Kopje të pasaportës ose një dokument tjetër identifikimi;
- Librezë shëndetësore

Ndërsa për personelin e brendshëm akademik, krahas dokumentacionit të sipërpërmendur, dosja duhet të përmbajë edhe:

- Librezën e punës;
- Librezën e kontributeve shoqërore.

i) Shkalla e kualifikimit të stafit kryesor dhe përputhja e saj me detyrat që kryejnë

Stafi mësimdhënës i brendshëm dhe i jashtëm është i kualifikuar në raport me pozicionin akademik ose administrativ dhe detyrën specifike që kryen, duke pasur parasysh që secili prej tyre angazhohet në procesin mësimor në disiplinat ku janë specializuar, ka eksperiencë në mësimdhënie ose eksperiencë që lidhet me funksione të tjera që kryen jashtë fakultetit.


Rekrutimi i stafit mësimor bëhet në përputhje me nevojat për pedagogë bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/departamenti si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Synimi kryesor është zhvillimi i ngarkesës mësimore kryesisht me staf të brendshëm.

j) Raporti staf i brendshëm / staf i jashtëm

Në grafikun më poshtë tregohet numri në total i personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm sipas 3 viteve akademike të aktivitetit të UET-it. Në vitin akademik 2006-2007, raporti pedagogë të brendshëm/pedagogë të jashtëm ishte 1:3; në vitin akademik 2007-2008 ky raport u ul në 1:2.8, ndërsa këtë vit akademik ky raport është 1:2.7. Vihet re se si stafi i brendshëm, ashtu edhe ai i jashtëm, ka pësuar rritje konstante si rezultat i rritjes së numrit të studentëve të regjistruar dhe hapjes së viteve dhe programeve të reja të studimit, çka ka rritur ngarkesën mësimore për çdo program studimi. Gjithsesi kjo

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

rritje ka qenë pothuaj e njëjlojtë për të dyja kategoritë “të brendshëm/të jashtëm”, në favor të lehtë të kategorisë “të brendshëm,” gjë që ka çuar në uljen e raportit personel i brendshëm/personel i jashtëm.




k) Shkalla e kualifikimit të stafit të jashtëm dhe kriteret e rekrutimit të tij

Rekrutimi i stafit akademik bëhet në përputhje me nevojat për pedagogë bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/departamenti si dhe ngarkesat mësimore të miratuara në UET. Për të përzgjedhur një staf akademik të jashtëm sa më të kualifikuar dhe profesional, janë vendosur dhe zbatuar kriteret, ku si ndër me kryesoret janë: eksperiencia në mësimdhënie në nivel akademik; niveli i kualifikimit dhe diplomimit duke i dhënë përparësi kandidatëve me tituj dhe grada; cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar aplikanti, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore; rezultatet personale profesionale të tij; aktiviteti kërkimor shkencor e botues; aftësitë komunikuese e etika; objektivat afat-mesme e afat-gjata të tij në karrierën akademike e shkencore; eksperiencia e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm; zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre; etj. Përzgjedhja e kandidatave të stafit të jashtëm akademik bëhet me të njëjtat kriteret dhe procedura si edhe për përzgjedhjen e stafit të brendshëm.

Për nevoja të veçanta dhe periudha të caktuara, në UET janë rekrutuar edhe pedagogë që nuk kanë grada e tituj akademikë, por që kanë një eksperiencë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre, janë specialistë të mirënjohur në fushën përkatëse, etj. Gjithashtu, në procesin akademik janë angazhuar edhe pedagogë të vendit apo të huaj nga universitetet partnere me UET-in apo universitete të tjera analoge. Pedagogët e huaj angazhohen në një semestër të plotë normal gjatë vitit mësimor, në semestrin e verës, ose në cikle të veçanta leksionesh e seminaresh brenda programit mësimor të një lënde.


Mbi bazën e këtyre kriterëve dhe aplikimit të tyre, është arritur që UET-i të ketë staf akademik të jashtëm tepër të kualifikuar.



Grafiku më sipër tregon numrin e pedagogëve të jashtëm të aktivizuar këto 3 vite akademike, sipas gradës dhe titujve. Të dhënat tregojnë se shkalla e kualifikimit të stafit akademik të jashtëm ka ardhur duke u rritur nga viti në vit.

l) Mosha mesatare e stafit mësimdhënës dhe raporti F/M

Në këtë grafik tregohet shpërndarja e personelit akademik aktual sipas grup-moshës. Vëmë re se rreth 46% e pedagogëve i përkasin grup-moshës nga 25-34 vjeç; 24% i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç; 19% grup-moshës 45-54 vjeç; 8% grup-moshës 55-64 vjeç. Mosha mesatare e personelit akademik të këtij viti llogaritet rreth 39 vjeç.



Për sa i takon raportit femra-meshkuj, për këtë vit akademik ky raport është 18:17 për personelin akademik të brendshëm dhe 47:49 për personelin e jashtëm, për një total prej 65:66.

m) Staf i ndihmës: rekrutimi, ngarkesa, cilësia dhe kontrolli i tij

Rekrutimi i stafit ndihmës bëhet në përputhje me nevojat dhe bazuar në planet e zhvillimit në kuadrin e çdo njësie kryesore, bazë dhe ndihmëse. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatëve, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si: eksperiencia e punës në nivel

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

universitar; niveli i kualifikimit dhe diplomimit, rezultatet personale profesionale, aftësitë komunikuese e etika, eksperiencia e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm; zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre; etj.

Komisioni i vlerësimit të kandidaturave dhe vlerësimit të stafit të ri ndihmës përbëhet nga Rektori, Kancelari, ose persona të deleguar prej tyre, si dhe eprori direkt nën varësinë e të cilit do të punojë kandidati i përzgjedhur. Procesi kalon në një fazë të përzgjedhjes paraprake. Kandidatet e përzgjedhur i nënshtrohen konkursit. Kandidatët fitues i nënshtrohen gjithashtu edhe një testimi për shkallën e njohjes së dokumenteve themelore të funksionimit të UET-it. Pas kësaj bëhet nënshkrimi i kontratës së punës ose shërbimit.

Ngarkesa e stafit ndihmës është e përshtatshme për të mbajtur një cilësi të lartë të punës së kryer, duke ruajtur një raport sa më optimal të numrit të stafit ndihmës me numrin e studentëve dhe të stafit akademik.

Cilësia e stafit ndihmës në institucionin tonë sigurohet dhe monitorohet me mekanizma të brendshëm të institucionit. Ky mekanizëm përfaqësohet nga kontrolli hierarkik dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilët përcaktojnë dhe monitorojnë politikën e cilësisë së punës të kryer nga stafi.

n) Dokumentacioni përkatës

1. Udhëzimi mbi shpërndarjen e ngarkesës;
2. Dosja e orareve të mësimit sipas semestrave dhe viteve akademike;
3. Tabela e burimeve njerëzore;
4. Bazë të dhënash mbi veprimtarinë kërkimore – shkencore të stafit;
5. Dosja e rekrutimit;
6. Dosja e marrëveshjeve të bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit;
7. Dokumentacioni i personelit akademik;
8. Dosja e kontratave i) akademike ii) joakademike.

VI. MËSIMDHËNIA

a) Organizimi dhe format e mësimdhënies: raporti midis tyre

Procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, detyra praktike, ese/detyra kursi, provime të ndërmjetëm, provime përfundimtare dhe punim diplome. Mësimdhënia sigurohet nëpërmjet leksioneve dhe seminareve.

Leksioni: Qëllimi kryesor i leksionit është shpjegimi i materialit mësimor nga ana e pedagogut. Përgjithësisht një grup leksioni përfshin disa (rreth tre) grupe seminari; nxitet zhvillimi i leksioneve interaktive.

Seminari: Nëse leksioni shërben kryesisht për parashtrimin dhe shpjegimin e materialit mësimor nga pedagogu, seminari shërben për vlerësimin e procesit të nxënies nga ana e studentit. Gjatë seminarit pedagogët pyesin, nxisin, aktivizojnë dhe ndërveprojnë me studentët. Ata mund t'i organizojnë studentët në grupe, mund t'u caktojnë atyre prezantime individuale apo në grup, mund të zgjidhin ushtrime me studentët gjatë orës së seminarit etj. Në thelb seminari shërben për të nxitur dhe aktivizuar studentët në mënyrë që ata mos të pozicionohen thjesht në rolin pasiv të nxënies, por të mësojnë në mënyrë aktive, duke përdorur të menduarin kritik.

Praktika profesionale: Qëllimi i praktikës është i dyfishtë. Në nivelin akademik ajo synon që studenti të arrijë që njohuritë teorike t'i shohë të zbatuara në praktikë. Për këtë qëllim UET-i garanton që institucioni apo pozicioni ku studentët do të kryejnë praktikën të jetë sa më i lidhur me fushën e studimit. Në nivelin me konkret praktika profesionale synon të shkathtësojë studentin në ambientin e punës dhe t'i ofrojë atij një mundësi për të krijuar njohje, kontakte dhe njohuri në lidhje me tregun e punës, gjë e cila do të lehtësojë përpjekjet e tij për punësim pas diplomimit. Praktikrat profesionale do të kryhen për herë të parë në fund të këtij viti akademik. Negocimi me institucione të caktuara publike dhe private ka nisur në përputhje me natyrën e çdo programi studimi.

Eseja: përbën një tjetër komponent kyç të procesit të mësimdhënies. Synimi kryesor është zhvillimi i aftësive analitike të studentit, duke e nxitur atë jo vetëm të përfitojë njohuri në një fushë të caktuar, por edhe të jetë i/e aftë t'i zbatojë këto njohuri konkretisht për të argumentuar pro apo kundër një teze konkrete. Esetë e kërkuara në programet e studimit të ciklit të parë ndahen në tre kategori:

1. *Esetë Argumentuese*, zakonisht kërkohen në vitin e parë dhe veçanërisht në semestrin e parë të vitit të parë. Në këtë fazë studentëve iu kërkohet hartimi i eseve që mund të shkruhen thjesht duke u bazuar tek materialet (leksionet dhe leximet) e kursit, apo duke iu referuar disa të dhënave dhe statistikave bazë që mund të gjenden lehtë. Studenti parashtron dhe argumenton pro apo kundra një teze të caktuar, e cila jepet nga pedagogët ose në ndonjë rast mund të identifikohet nga vetë studenti.
2. *Esetë Akadematike*, janë një version më i zhvilluar i eseve argumentuese; argumentimi bëhet jo vetëm më i zgjeruar, por edhe duke iu referuar literaturës përkatëse që mund të dalë edhe jashtë leksioneve të lëndës.
3. *Esetë Kërkimore*, nuk është asgjë më shumë sesa një ese akademike e zgjeruar që përveç literaturës përkatëse i referohet edhe të dhënave empirike. Kërkohet të shkruhen në vit të dytë dhe më intensivisht në vitin e tretë të studimeve.

b) Ngarkesa mësimore

Ngarkesa mësimore e personelit akademik merr disa forma:

- Orë mësimore në auditor;
- Këshillim akademik (për pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm)
- Tutoriat (vetëm për pedagogët e brendshëm)
- Botim artikujsh shkencorë në revistat e botuara nga fakultetet e UET-it;
- Drejtim temash diplome DNP dhe/ose DND, për këto të fundit pedagogu duhet të ketë minimalisht gradën Dr.

Format dhe sasia e ngarkesës për çdo anëtar të personelit akademik përcaktohet në kontratën e lidhur mes tij dhe UET-it. Përgjithësisht vihet re se pjesa më e madhe e pedagogëve të brendshëm, senior dhe me ngarkesë të veçantë nuk arrijnë të plotësojnë ngarkesën e orëve mësimore në auditor sipas përcaktimeve të kontratës, për shkak të kapaciteteve ende të paplotësuara të UET-it. Për shembull semestrin e parë të këtij viti akademik vetëm 8 nga 46 pedagogët që i përkasin këtyre kategorive në total, e plotësonin normën e përcaktuar. Semestrin e dytë, si pasojë edhe e hapjes së programeve Master të Nivelit të Parë ky numër u rrit në 20. Si përfundim, rritja e raportit të pedagogëve të brendshëm ndaj atyre të jashtëm mbetet e kushtëzuar nga hapja e programeve DND, zgjerimi i programeve MNP dhe hapja e vitit të tretë të studimeve për programet e studimit DNP që ofron Fakulteti Ekonomik vitin e ardhshëm akademik.

c) Cilësia e mësimdhënies

1. Niveli i kualifikimit të stafit akademik: Nga viti në vit, stafi akademik i UET-it është rritur ndjeshëm jo vetëm në numër, por edhe në cilësi; ai gëzon eksperiencë në mësimdhënie, pjesëmarrje në veprimtari kërkimore shkencore dhe veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit. Kështu nga viti 2007-2008 në vitin 2008-2009 vëmë re se numri i pedagogëve me gradën doktor është rritur nga 11 në 27, ose nga 15% në 21% e stafit akademik, ndërsa numri i pedagogëve me titull profesor i asociuar dhe profesor është rritur nga 9 në 20, ose nga 12.5% në 15.3% e stafit. Numri i stafit akademik (i jashtëm dhe i brendshëm) nga viti i parë akademik 2006-2007 në vitin e tretë 2008-2009 është rritur nga 29 në 131 ose 4.5 herë. Vlen të theksohet se është rritur raporti i stafit të brendshëm ndaj atij të jashtëm. Stafi i brendshëm sot përbën 27% të stafit të përgjithshëm, krahasuar me 24% në vitin akademik 2006-2007.

Nga 131 anëtarët që numëron personeli akademik i këtij viti, 11 mbajnë titullin “Profesor”, 9 mbajnë titullin “Profesor i asociuar” dhe 27 kanë gradën “Doktor.” Këtyre anëtarëve u ngarkohet përgjegjësia kryesore e organizimit dhe zhvillimit të disiplinave mësimore, për të cilat ata janë titullarë. Përgjithësisht, sidomos për disiplinat mësimore me ngarkesë të lartë, ata asistohen edhe nga lektorë të brendshëm ose të jashtëm për zhvillimin e orëve të seminarit. Pothuaj të gjithë lektorët e angazhuar në UET janë me Master të Nivelit të Dytë; përjashtim bëjnë vetëm lektorët e veprimtarive formuese si gjuhët e huaja.

Në rritjen e cilësisë dhe bashkëkohësisë së mësimdhënies rëndësi i kushtohet dhe lidhjes së dijeve të transmetuara me praktikën dhe eksperiencën ndërkombëtare. Kjo qasje e tillë realizohet nëpërmjet ftesës në auditor të lektorëve me eksperiencë të spikatur vendas dhe të huaj, si dhe të praktikienëve të njohur kombëtarisht e ndërkombëtarisht për të përçuar dijet dhe eksperiencën e tyre në auditor. P.sh., për Fakultetin e Shkencave Sociale është praktikë e njohur ftesa që i behet çdo vit akademik profesorëve të universiteteve franceze për të dhënë module të veçanta në kuadrin e një lënde të caktuar, apo ftesa e ekspertëve të BE-së, organizatave të tjera ndërkombëtare dhe joqeveritare, si dhe ekspertëve të medias, për të ndarë ekspertizën dhe praktikën e tyre me studentët. Kjo eksperiencë është përshëndetur dhe inkurajuar edhe nga vetë studentët, krahas angazhimit që tregon stafi akademik në këtë drejtim.

Në të njëjtën kohë në pesë vitet e fundit ky staf ka botuar 15 tekste për studentë, 37 libra të botuar brenda vendit, 6 libra të botuar jashtë vendit; dhe 66 artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit dhe 69 jashtë vendit. Anëtarët e stafit janë pjesëmarrës të rregullt në konferenca e workshope kombëtare e ndërkombëtare, gjë që reflekton një punë të vazhdueshme të tij në drejtim të një përditësim të vazhdueshëm të dijeve që jepen në auditor dhe veprimtaritë e tjera akademike dhe shkencore të organizuara në UET.

2. Shpërndarja e ngarkesës/lëndëve për pedagog: Vëmendje i kushtohet edhe shpërndarjes së lëndëve për çdo pedagog për semestër, ku respektohet ekspertiza profesionale e çdo pedagogu, si dhe sigurohet që në çdo semestër ai/ajo të mos japë më shumë se dy lëndë të ndryshme.

3. Përzgjedhja e literaturës dhe sigurimi i saj për çdo lëndë të programit të studimit është një tjetër faktor i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies. Politika e ndjekur në UET kërkon që programi i lëndës të mbështetet në një ose dy tekste bazë, të përzgjedhur nga literatura më e mirë botërore, e cila i vihet në dispozicion studentit e përkthyer, redaktuar dhe shtypur nga UET press. Literatura e rekomanduar përfshin literaturën e autorëve më të mirë shqiptarë dhe të huaj që vihet në dispozicion nga biblioteka e UET-it ose nëpërmjet shërbimeve *online* ku UET-i është abonuar.

4. Ulja e numrit të studentëve në klasë: Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies është ulur numri i studentëve në klasë, nga 120 studentë në 90 studentë për orët e leksionit dhe 25 studentë për grup seminari, nga 30-35 studentë që ishte një vit më parë, duke rritur shkallën e ndërveprimit mes pedagogut dhe studentëve.

5. Përdorimi i mjeteve didaktike: është një tjetër element ndihmës për përçimin e dijes tek studentit. Kështu klasat e leksionit janë të pajisura me kompjuter dhe projektues, të cilët lejojnë përdorimin gjerësisht të prezantimit me PowerPoint, apo shfaqjen e filmave për qëllime didaktike që rezultojnë në kombinimin e paraqitjes vizuale me atë verbale, me qëllim përforcimin e informacionit të ofruar dhe nxitjen e debatit.

6. Reflektimi për metodat e mësimdhënies: merr rëndësi të veçantë merr në garantimin e standardeve bashkëkohore të mësimdhënies. Për këtë qëllim në mënyrë të vazhdueshme pedagogët trajnohen, informohen dhe inkurajohen të shkëmbejnë eksperiencat e tyre pozitive për metodat e reja të mësimdhënies në leksione e seminare. Inkurajohen metodat interaktive dhe të të menduarit kritik, krahas asaj të lidhjes së teorisë me praktikën.

7. Tutoriati dhe këshillimi akademik: Në këto veprimtari është përmirësuar shërbimi ndaj studentit ku çdo pedagog i brendshëm ka 30 studentë nën kujdestarinë e tij. Pedagogët e brendshëm qëndrojnë 2-3 orë në javë në dispozicion të studentëve që kanë nën kujdestari, për t'i këshilluar dhe ndihmuar në mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Gjithashtu çdo pedagog i jashtëm qëndron një orë në javë në dispozicion të studentëve, për të sqaruar çdo paqartësi që ata mund të kenë lidhur me lëndën, apo detyrimet ndaj saj.

8. Vlerësimi i performancës: Garantimit të cilësisë së mësimdhënies i shërbejnë gjithashtu edhe vlerësimi në disa nivele i procesit të mësimdhënies së një pedagogu, i cili është subjekt i vlerësimit nga studentët, kolegët dhe titullarët e fakultetit, dekanit apo përgjegjësit të departamentit. Rezultatet e vlerësimit i bëhen prezent pedagogut, i cili reflekton për atë çka duhet bërë në përmirësim të procesit të mësimdhënies, qoftë në leksione apo seminare.

d) Kontrolli i njohurive, format e kontrollit, objektiviteti në vlerësimin e studentëve

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

Për lëndët teorike

- Provimit përfundimtar (40%)
- Provimit të ndërmjetëm (30%)
- Esesë (20%)
- Nivelit të diskutimit në seminare (10%)
- Frekuentimit të leksioneve (10 pikë bonus)

Për lëndët praktike

- Provimit përfundimtar (40%)
- Provimit të ndërmjetëm (30%)
- 2 detyrave praktike (2 x 10% = 20%)
- Nivelit të diskutimit në seminare (10%)
- Frekuentimit të leksioneve (10 pikë bonus)

Një nga synimet e vlerësimit të vazhdueshëm është që ta vendosë studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Ky vlerësim i tregon pedagogut nëse studentet janë duke i arritur objektivat e vendosura. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit. Vlerësimi në UET ka natyrë stimuluese; ai synon të tregojë se çfarë studenti di dhe çfarë duhet të mësojë më shumë.

K Kontrolli i njohurive ka pasur dhe vazhdon të ketë një qëllim të dyfishtë: (i) vlerësimin e studenteve dhe (ii) nxitjen e aftësive argumentuese dhe njohurive të studentëve. Të dy qëllimet janë zbatuar në mënyrë të ndërlidhur me njëra - tjetrën. Ne i përmbahemi bindjes se një student që ka aftësi argumentuese duhet që patjetër të ketë edhe njohuri ose informacion. Në mënyrë të tillë ne kemi arritur të testojmë edhe informacionin që studenti ka, por edhe aftësinë e tij/saj për të argumentuar/analizuar.

Pyetjet me zhvillim janë konceptuar në formën e një eseje argumentuese. Pedagogu i ofron studentit një tezë që ai ose ajo e mbron ose e kundërshton. Në këtë mënyrë vlerësohet njëkohësisht edhe niveli i informacionit të studentit, por edhe aftësia e tij për ta aplikuar atë konkretisht.

Krahas pyetjeve që testojnë aftësitë analitike, jepen edhe pyetje që testojnë informacionin që studenti ka marrë gjatë lëndës, pasi një testim vetëm i aftësive analitike rrezikon të penalizojë ata studentë që mësojnë në mënyrë mekanike dhe riprodhuese. Në formatin e tezës së provimit rekomandohet që:

1. 20- 30% e vlerësimit përbëhet me pyetje që kontrollojnë njohuritë;
2. 40 - 50% me pyetje që testojnë aftësinë analitike; dhe
3. 20 – 30% me pyetje me zhvillim në formën e esesë argumentuese.

Sa më shumë studenti avancoon në vite akademike, aq më shumë provimi duhet të reduktojë komponentin e kontrollit dhe të zgjerojë komponentin analitik.

Tezat e provimit janë të sekretuara me barkode, në mënyrë që të ruhet anonimati i studentit deri në korrigjimin e provimit nga pedagogu, për të shmangur ndikimin e vlerësimit të pedagogut nga faktorë që nuk kanë lidhje me cilësinë e zhvillimit të tezës. Çsekretimi kryhet nga sekretaria mësimore pas dorëzimit të tezave të korrigjuara.

Provimi përfundimtar ka qëllimisht vlerën 40% të notës përfundimtare, në mënyrë që një student, i cili nuk ka punuar gjatë semestrit, ta ketë të pamundur të marrë notë kaluese bazuar vetëm në këtë komponent të vlerësimit. Pra, synohet që studenti të nxitet të punojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme,

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

gjë shërben për të vënë në funksionim kujtesën afatgjatë të tij dhe për të shmangur përgatitjen vetëm gjatë sezonit të provimeve.

Në sezonin e riprovimeve në vjeshtë, për lëndët teorike provimi ka 80% të vlerësimit dhe 20% përcaktohet nga vlerësimi i marrë për esenë e dorëzuar gjatë semestrit. Për lëndët praktike provimi ka 100% të vlerësimit. Teza e riprovimit synohet të jetë e një vështirësie më të lartë, për të dekurajuar lënien e provimeve për këtë sezon provimesh, por gjithashtu i jep mundësi studentëve që për ndonjë arsye kanë humbur pikë gjatë semestrit të mund të rifitojnë pikët e humbura nëse si përfundim kanë realizuar një përvetësim të mirë të lëndës.

Pas marrjes së rezultatit për komponentë të veçantë të vlerësimit, ose/dhe notën përfundimtare, studentit i krijohet mundësia për të sqaruar çdo paqartësi apo pretendim lidhur me vlerësimin, fillimisht me pedagogun e lëndës dhe, në rast se, edhe pas takimit sqarues me pedagogun, studenti ka ankesa për vlerësimin e marrë, mund të kërkojë ngritjen e një komisioni shqyrtues nga Departamenti. Vendimi i komisionit është përfundimtar.

Studenti ka të drejtën e përmirësimit të notës; kjo mund të kryhet vetëm në sezonin e vjeshtës. Studenti merret në provim vetëm një herë për përmirësimin e një note. Pas kësaj mbetet në fuqi nota me të cilën ai vlerësohet në fund.

Për akordimin e 10% të vlerësimit për nivelin e aktivizimit në seminare, pedagogëve iu kërkohet të marrin parasysh jo vetëm numrin e mungesave të çdo studenti gjatë seminareve, por edhe shkallën e aktivizimit të çdo studenti në orët e seminarit.

Për të siguruar vlerësimin me objektivitet të eseve të punuara nga studentët, pedagogëve iu kërkohet të plotësojnë kutizën e vlerësimit të pedagogut që ndodhet në fund të formatit të vënë në dispozicion të studentëve për dorëzimin e eseve, ku ai të paraqesë vlerësimin e tij lidhur me komponentët e mëposhtëm të esesë:

- ❖ Parashtrimi i tezës
- ❖ Argumentimi
- ❖ Përfundimi

Për të nxitur frekuentimin e orëve të leksionit nga studentët, këtë vit akademik 2008-2009 u vendos që për frekuentuesit e rregullt të leksioneve, të pranishëm në jo më pak se në 80% të tyre, pedagogu të ketë të drejtë të akordojë 10 pikë bonus. Këto pikë janë bonus për të mos penalizuar studentët që nuk kanë mundësi të frekuentojnë rregullisht leksionet, meqë leksionet janë fakultative. Evidenca e pranisë së studentëve në auditor merret përmes firmosjes së listprezencës nga ana e tyre.


e) Numri i studentëve në hyrje në tre vitet e fundit

Sikurse vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, ndonëse Fakulteti Ekonomik u hap një vit më vonë se dy fakultetet e para, ai është rritur me ritme shumë të shpejta, gjë që konfirmon vlerësimin e saktë të drejtuesve të UET-it për hapjen e programeve të reja të studimit që ky fakultet ofron, në përgjigje të kërkesave dhe nevojave të tregut.

Fakulteti	Viti akademik			Totali
	2006 - 2007	2007 - 2008	2008 - 2009	
Fakulteti Juridik	61	179	177	417
Fakulteti i Shkencave Sociale	114	161	181	456
Fakulteti Ekonomik	-	74	407	481
TOTALI	175	414	765	1354


f) Shkalla e kalueshmërisë për sezon provimi dhe për kurs studimi

Grafiku më poshtë tregon kalueshmërinë sipas programeve të studimit për vitin akademik 2006-2007. Shihet se në sezonin e provimeve në qershor shkalla e kalueshmërisë për programin e studimit DNP “Shkenca Politike” ishte 68%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë u rrit në 89%; për programin e studimit DNP “Marrëdhënie publike – Komunikim” në sezonin e provimeve në qershor shkalla e kalueshmërisë ishte 40.5%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë 84%; për programin e studimit DNP “Marrëdhënie ndërkombëtare” në qershor ishte 68%, ndërsa në sezonin e riprovimeve ishte 89%; për programin e studimit DNP “Juridik” në sezonin e provimeve në qershor ishte 42%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë 85%.




UET - Raporti i Vetëvlerësimit


Nga të dhënat rezultojnë se shkalla e kalueshmërisë në sezonin e qershorit 2008 për programin e studimit DNP Juridik ishte 69%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë 2008 arriti në rreth 90%.




Shkalla e kalueshmërisë për programin e studimit DNP "Shkenca Politike" në sezonin e provimeve në qershor ishte 82%, kurse në sezonin e riprovimeve në vjeshtë kalueshmëria u rrit në rreth 93%.




Shkalla e kalueshmërisë për programin e studimit DNP në Marrëdhënie ndërkombëtare në sezonin e provimeve qershor 2008 ishte rreth 73%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë ajo u rrit në 93%.



Shkalla e kalueshmërisë për programin e studimit DNP në Marrëdhënie publike – komunikim në sezonin e provimeve në qershor ishte 71%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë arriti në 91%.



Shkalla e kalueshmërisë për programin e studimit DNP “Financë Banka” ishte 91% në sezonin e provimeve në qershor dhe 100% në sezonin e riprovimeve në vjeshtë. Për programin e studimit DNP “Menaxhim biznesi” kjo shkallë ishte rreth 83% në sezonin e provimeve në qershor dhe 87% në sezonin e riprovimeve në vjeshtë.



g) Kriteret e pranimit në ciklin e dytë të studimeve dhe si zbatohen ato

Kriteret e pranimit të studentëve në studimet pasuniversitarë (MNP dhe DND) janë të përcaktuara në rregulloren e UET-it. Në përcaktimin e kriteve të pranimit të studenteve synohet krijimi i një komuniteti të diversifikuar studentësh si nga niveli akademik edhe nga interesat e tyre studimore.

Nëpërmjet diplomave që ofrohen, mundësohet edhe pjesëmarrja e studentëve/kandidatëve që nuk janë diplomuar në nivelin e mëparshëm në fushën përkatëse, por që mund të jenë të interesuar për të riorientuar

studimet. Qëllimi ynë është që t'i orientojmë studentët për perspektivën e tyre në të ardhmen, si dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Me anë të kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e UET-it vlerësohet niveli akademik i kandidatit i fituar në studimet universitare të mëparshme, eksperiencën e tij profesionale, kompetencën për të kryer studime më të thelluara akademike në fushë, si dhe fokusi i interesit të tij shkencor gjatë kohës së studimeve.

Kjo politikë është publikuar edhe nëpërmjet faqes së internetit të universitetit, nëpërmjet njoftimeve në media, si dhe nëpërmjet dhënies së informacionit në vende të dukshme për t'u konsultuar nga të gjithë të interesuarit. Gjithashtu, për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit, është caktuar një koordinator i cili është në dispozicion të interesuarve që duan të marrin më shumë informacion për studimet Master të ciklit të dytë. Zyra e programeve të nivelit të dytë është përgjegjëse për mbledhjen në kohë të aplikimeve të studentëve kandidatë.

Në tërësi, kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve (Programet MNP, dhe DND) janë të njëjta. Ndryshim përbën fakti që për t'u pranuar në një program studimi DND, programi DNP nga i cili vjen studenti aplikues duhet të jetë i ngjashëm në të paktën me 2/3 e programit DNP që i paraprin programit DND të kërkuar. Gjithashtu në aplikimet për programet DND, *Letra e Interesit* që duhet të paraqesë kandidati, ku parashtrihen objektivat personale, interesat kërkimore dhe nxitja për të kryer studimet në këto programe, merr më shumë rëndësi.

h) Metodatat dhe teknikat e teknologjitë e mësimdhënies

Leksionet

Përballja e parë me studentët ka rëndësi për mbarëvajtjen me sukses të të gjithë kursit. Këtu i kushtohet rëndësi qëllimeve të ditës së parë, gjatë së cilës synohet arritja e këtyre qëllimeve:

1. Prezantimi i mësimdhënësit të studentët, dhe mundësisht i studentëve me njëri-tjetrin.
2. Përgjigje e pyetjeve të studentëve, si edhe qetësimi i tyre nëse janë të shqetësuar në lidhje me kursin.
3. Bëhet një prezantim i përmbledhur i përmbajtjes së kursit.

Inkurajohet rishqyrtimi i programit së bashku, hap pas hapi, duke u treguar studentëve sesi mund të përvetësojnë materialin e kursit. Shpjegimi i qartë i mënyrës se si do të vlerësohen, tregon objektivitetin në vlerësimin e çdo kursi. Po ashtu theksohet fakti se çdo anëtar i stafit akademik është i gatshëm t'i ndihmojë ata edhe jashtë orës së mësimin.

Një rëndësi e veçantë i jepet pedagogëve të rinj. Ata janë më pranë moshës së studentëve sesa shumica e anëtarëve të fakultetit dhe kjo situatë mund të kthehet në favor ose kundër kësaj pjese të stafit në procesin e mësimdhënies. Synohet që këta pedagogë të përpiqen të krijojnë një distancë të tillë me studentët që të jetë aq e afërt sa për të qenë të dobishëm dhe miqësor, por aq e largët sa të mos ndiejnë detyrime të papërshtatshme.

Është bërë e qartë se nëse këta pedagogë qëllon të mos dinë përgjigjen e një pyetjeje, ata duhet ta pranojnë këtë dhe të premtojnë të sjellin përgjigjen orën tjetër.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Përzgjedhja e metodave dhe strategjive të mësimdhënies bazohet, deri në njëfarë mase, në preferencat dhe mënyrën e veçantë të mësimdhënies së çdo pedagogu. Në UET inkurajohet përdorimi i variacionit/kombinimit të metodave në orën e mësimit.

Leksioni tradicional i universitetit prej gjashtëdhjetë minutash, gjatë të cilit pedagogu flet tërë kohën, është një mënyrë mësimdhënieje tradicionale, por mbijetesa e kësaj metode në shekullin e XXI-të provon lehtësinë e përdorimit të saj dhe shpenzimin e paktë më shumë se sa efikasitetin e saj si mjet mësimdhënieje. Duke qenë se ka të ngjarë që leksioni të mbetet metoda mbizotëruese në arsimin e lartë në vitet e ardhshme të parashikueshme, pedagogët e UET-it nxiten të jenë në dijeni të përparësive dhe kufizimeve të kësaj metode.

Shumë pedagogë kanë zbuluar se teknika bashkëvepruese pyetje-përgjigje kapërcen problemet e leksionit tradicional dhe e bën këtë të fundit eksperiencë efikase të nxëni. Në këtë rast në vend që të jepet i tërë informacioni nga pedagogu, në auditor krijohen situata, të cilat nxisin studentët të nxjerrin njohuritë që kanë në shërbim të temës së planifikuar.

Përgatitja e një leksioni efikas kërkon ta shohësh atë nga këndvështrimi i dëgjuesit. Pedagogët janë udhëzuar të bëjnë të qartë strukturën e leksionit, duke bërë lidhjen e temës së leksionit me materiale të mëparshme apo materiale që do të pasojnë. Mbas hyrjes së leksionit bëhet kujdes që studentët të dinë si do të organizohet leksioni, konceptet kryesore që ai përmban dhe vendin e këtij leksioni në gjithë njohurinë që ata po studiojnë. Mbështetur në eksperiencën më të mirë perëndimore, pedagogët inkurajohen të përdorin diagrame, vizatime, tabela, dhe ndihma të tjera grafike. Tregohet kujdes që shembujt që përdoren të jenë të përshtatshëm e në funksion të ideve dhe koncepteve të leksionit.

Çdo leksion i mirë mbyllet duke bërë përmbledhjen dhe konkluzionin e çështjeve të diskutuara.

Seminaret

Nëse qëllimi kryesor i leksioneve është të përçojë dije dhe njohuri tek studentët, qëllimi kryesor i seminareve është që të ndihmojë studentët ta përvetësojnë këtë dije dhe njohuri. Seminari gjithashtu ndihmon pedagogun për të kuptuar ecurinë e studentëve dhe të klasës në përgjithësi në lëndën e tij/saj.

Për të arritur këto dy qëllime në UET i është dhënë rëndësi e veçantë faktit që seminarët të jenë sa më interaktivë, me sa më shumë diskutim, debat dhe pjesëmarrje nga ana e studentëve. Janë përgatitur udhëzime të veçanta për metoda dhe teknika të caktuara dhe sa më të përshtatshme që synojnë të ndihmojnë pedagogët për të organizuar një orë seminari sa më produktive. Disa prej orientimeve, metodave dhe teknikave të rekomanduara janë:

Roli i pedagogut gjatë drejtimit të diskutimeve në seminar është të drejtojë dhe lehtësojë dialogun. Diskutimi i mirë bazohet në qëllime të formuluara mirë dhe përgatitja e pedagogut fillon me një analizë të këtyre qëllimeve.

Metoda Sokratike bazohet në parimin se përmes dialogut me pedagogun studentët mund të drejtohen në gjetjen vetë të zgjidhjeve për problemet. Nëse pedagogët duan t'i drejtojnë studentët në majë të shkallës së analizës, pyetjet e diskutimit duhen organizuar në hierarki logjike.

- Në nivelin më të ulët, pyetjet “njohuri” që kërkojnë rikujtim të fakteve dhe informacionit;

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

- Në nivelin e ndërmjetëm, pyetjet “zbatim” kërkojnë që studentët të arrijnë një konkluzion bazuar në prova nga materiali që kanë pasur për të;
- Në nivelin e lartë, pyetjet “vlerësim” kërkojnë gjykim bazuar në njohjen faktike të materialit, zbatim konceptesh dhe vlerësim prove.

Paraprakisht duhet të sigurohet që studentët janë njohur me temën e diskutimit kohë përpara orës kur do të bëhet ky diskutim. Në këtë rast bëhet kujdes të zgjidhen materiale leximi që nxjerrin çështje të rëndësishme dhe të vështira. Mund të përdoren filma, udhëtime në terren, eksperimente, demonstrime, si dhe detyra të tjera si burim material për diskutim, por gjithmonë shoqëruar me pyetje që ndihmojnë studentët të përgatiten për diskutimin.

Gjatë diskutimit pedagogët bëjnë përpjekje për të përfshirë të gjithë studentët. Në këtë rast këshillohet që pedagogët të mos i përgjigjen vetë pyetjes që ngrenë, ose menjëherë. Pedagogoet i japin rëndësi të veçantë formulimit të pyetjeve, në mënyrë që ato të jenë të qarta për studentët.

Shumë pedagogë i ndajnë klasat e tyre në grupe të vogla diskutimi, dhe përdorin disa teknika si mjete të rëndësishme mësimdhënieje. Klasa mund të ndahet në skuadra të cilave iu jepen periodikisht detyra për t'u bërë brenda ose jashtë klasës. Në këtë rast detyrat që i caktohen grupeve të punës janë sfiduese në mënyrë që studentët të analizojnë dukuri, zgjidhin probleme, zbatojnë teori, ushtrojnë gjykim, ose kryejnë një kombinim të këtyre aktiviteteve. Gjatë ushtrimit, pedagogu lëviz nga grupi në grup, i përgjigjet pyetjeve, qartëson udhëzimet, jep këshilla, dhe vëzhgon procesin. Grupet e vogla mund të përdorin teknika të tjera si të mësuarit me shokun, studime rastesh, simulime etj.

Pedagogu është i inkurajuar të tolerojë shfaqjen e pikëpamjeve të ndryshme, madje edhe kontradiktore, duke krijuar atmosferë debati konstruktiv. Rëndësi merr ndarja e roleve brenda grupit të vogël dhe procesi i komunikimit brenda grupit.

Studenti mund të përfshihet aktivisht në rikujtimin (evokimin) e njohurive që di rreth temës/çështjes përkatëse. Roli i pedagogut është të drejtojë, të kuptojë mendimin dhe të dëgjojë me kujdes.

Studimet e rasteve (case study) janë një tjetër teknikë e organizimit të seminareve. Ato janë të rëndësishme për të mësuar analizën e informacionit, vendim-marrjen ose zgjidhjen e problemit. Metoda, e cila u bë e njohur nga Shkolla e Biznesit, Harvard, kërkon zhvillimin e një numri rastesh që reflektojnë problemet ose çështjet e materialit të kursit. Në këtë rast klasat mund të ndahen në grupe të vogla për të punuar.

Ashtu si edhe studimet e rasteve, simulimet iu japin studentëve praktikë vendimmarrjeje, por në një mënyrë tjetër, më tërheqëse. Meqenëse simulimet bazohen në situata reale, ato iu prezantojnë studentëve mundësi dhe detyrime që reflektojnë problemet e botës reale. Objektivat janë tre: praktikimi i aftësive negociuese, zgjidhja e problemit, dhe teknikat për të arritur kompromisin.

Brainstorming (stuhia e mendjes/trurit) është një tjetër teknikë që përdoret në seminarët e organizuara në UET. Zakonisht kjo metodë përdoret si një metodë nismëtare, ajo mund të pasohet nga metoda të tjera, p.sh. mund të ndiqet nga një seancë kategorizimi për ato ide të prezantuara gjatë *Brainstorming*-ut.

Lojërat dhe simulimet janë mjaft të lidhura me njëra-tjetrën, dhe ka kombinime lojërash të ndryshme: lojëra me simulime, lojëra pa simulim si edhe simulime pa lojëra. Për qëllimet tona, lojërat përkufizohen si

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

aktivitete në të cilat ka fitues dhe humbës. Në këtë rast hartohet skenari dhe informohen dhe udhëzohen studentët sipas rolit që u caktohet.

Koha në klasë mund të përdoret për aktivitete, të cilat praktikojnë aftësi kryesore të studentëve. Kjo njihet si teknika e ushtrimeve në klasë. Kjo teknikë i detyron studentet të zbatojnë konceptet që sapo mësuat, dhe zakonisht sjell pyetje të cilat studentët nuk i kishin menduar gjatë leksionit. Këto ushtrime mund të kenë forma të ndryshme; një paragraf që mbron apo kundërshton një pikëpamje të caktuar, një faqe analizë e një pjese leximi, ose një ese e shkurtër që përmbledh një diskutim.

Konkursi synon të nxjerrë dijet më të mira të nxëna dhe të përvetësuara nga studentët dhe të identifikojë shtresën elitare mes studenteve brenda auditorit. Vetë studentët kanë nevojë të krahasojnë njohuritë dhe dijet e marra me njëri – tjetrin. Sigurisht që nuk tepronet në përdorimin e kësaj teknike; në rast të kundërt kjo përbën risk për diskriminimin e një kategorie studentësh dhe për krijimin e perceptimit se "të gjithë jemi të humbur".

Prezantimi është një teknikë tjetër që përdoret gjerësisht në seancat e seminareve në UET. Kjo teknikë përbën një formë përmblyëse të një pune të caktuar, e cila rekomandohet të marrë trajtën e mbrojtjes së punimit, më shumë se një prezantim i thjeshtë, duke u shoqëruar me seancë pyetje – përgjigje – debat mes studentëve.

Rekomandohen forma vizuale të prezantimit (PowerPoint, grafike, skema, foto, montazhe, albume etj). Në këto raste pedagogu këshillon studentin paraprakisht dhe së bashku me të ndërton "skenarin" e seancave. Për studentët që prezantojnë këto seanca zakonisht përjetojnë si ngjarje afirmuese.

Një formë e re e prezantimit të punimeve individuale të studentëve është "Panairi i ideve". Në këto raste studentët përgatisin punime vizive (skema, fotomontazhe, grafikë, të dhëna statistikore, prezantime në PowerPoint, postera, fletë–palosje), të cilat ekspozohen në mjediset e auditorit dhe grupe studentësh "vizitojnë" punimet e shokëve të tyre, të cilët qëndrojnë secili para punimit të vet dhe u përgjigjen pyetjeve të "vizitorëve". Vlerësohen jo vetëm studentët që prezantojnë punimet e tyre, por edhe "vizitorët" për shkallën e interesit dhe të ekspertizës së treguar.

i) Përdorimi i teknologjive të reja të mësimdhënies: kompjutera, mjete audiovizive etj.

Gjendja e auditorëve dhe zyrave në shërbim të stafit akademik, ndihmës dhe studentëve paraqitet si më poshtë:

1. 6 salla leksionesh të pajisura me 1 PC, 1 projektor si dhe sistem audio.
2. 1 sallë interneti e pajisur aktualisht 74 PC dhe një printer rrjeti. Aty qëndron vazhdimisht një person i cili ndihmon studentët për printimet, si dhe i asiston për probleme të ndryshme gjatë punës së tyre; gjithashtu kujdeset për ruajtjen e pajisjeve.
3. 1 sallë informatike me 17 PC ku zhvillohet mësimi i lëndës Informatikë, si dhe ndonjë lëndë tjetër sipas rastit.
4. 4 salla pedagogësh me rreth 27 PC, 4 printera rrjeti dhe 2 printera të zakonshëm.
5. Çdo pedagog i brendshëm ka një PC që e përdor vetëm ai. Për pedagogët e jashtëm ka një PC në çdo sallë pedagogësh që mund të përdoret prej tyre.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

6. Zyrat e Administratorit, Rektorit, Dekanëve, janë të pajisura me PC dhe printer. Koordinatorët pranë fakulteteve janë të pajisura me PC, ndërsa për printime përdorin printerat e rrjetit të pedagogëve.
7. Sekretaria qendrore është e pajisur me PC për çdo sekretare, si dhe tre printera.
8. Zyra për zhvillimin e tutoriatit është e pajisur me 2 PC dhe një printer.
9. Biblioteka është e pajisur me 2 PC për stafin, si dhe 5 PC të tjerë në shërbim të studentëve.
10. Në katin e parë ndodhet zyra e fotokopjes, e pajisur me dy fotokopje, njëra prej të cilave e blerë vitin e kaluar, shumë e përshtatshme për printime dhe fotokopjime masive.
11. Lidhja e internetit ofrohet në çdo PC me përjashtim të sallave të leksioneve ku nuk është parë e arsyeshme të ofrohet.
12. Çdo pedagog ka një email të ofruar nga UET-i. Emaili ka këtë standard: emer.mbiemer@uet.edu.al. Fjalëkalimi u është nisur individualisht secilit prej tyre.
13. Sistemi kompjuterik mbrohet nga ndërhyrjet e jashtme me anë të një sistemi mbrojtës të fjalës së fundit të teknologjisë. Gjithashtu në çdo PC është instaluar McAfee Antivirus, i cili menaxhohet në mënyrë qendrore nga zyra e IT-së.
14. Tre servera, prodhim i fund-vitit 2008 mbulojnë shërbimin Email, Fileserver dhe Domain Controller.
15. Dosja My Documents ruhet në Server për arsye sigurie.
16. Një central telefonik me 26 numra ofron shërbimin e komunikimit të brendshëm për stafin. Aktualisht nuk kemi lidhje me rrjetin e Albtelekomit, por besojmë se do zgjidhet së shpejti.
17. Ambientet e UET-it mbulohen nga sistemi i sigurisë me kamera.
18. UET-i ka një faqe interneti: www.uet.edu.al dhe një email zyrtar info@uet.edu.al
19. UET-i ofron shërbimin Internet wireless falas për të gjithë studentët, si dhe për klientët që frekuentojnë lokalin BAR UET.
20. Është në fazën finale printimi i kartave për çdo student si dhe për stafin.

Në total në ambientet e UET-it janë rreth 163 kompjutera aktivë, 21 printera, 2 fotokopje, 3 laptopë, 6 projektorë, 6 sisteme fonie, 3 TV, 2 Wireless Acces Points, etj.

Të gjitha këto përbëjnë një infrastrukturë didaktike – mësimore të konsoliduar, e cila ndikon që studentit t'i sigurohet shërbimi i nevojshëm për realizimin e objektivave të tij akademike e kërkimore.

j) Kontrolli i brendshëm i mësimdhënies

Kontrolli i brendshëm i cilësisë së mësimdhënies është një tjetër aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë akademike. UET-i synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive, si dhe të metodologjisë sa më bashkëkohore, të cilat ndikojnë në formimin e studentëve.

Për këtë arsye, për të siguruar realizimin në vazhdimësi të këtij objekti, departamentet dhe dekanati kanë nxitur diskutimin paraprak sipas programeve të lëndëve dhe literaturës së përdorur në të gjitha lëndët e ofruara. Kjo është bërë me qëllim që të ketë koherencë dhe vazhdimësi në programet e lëndëve, në zbatimin e tyre praktik, si dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të tyre, duke rritur kështu cilësinë e mësimdhënies.

Kontrolli i brendshëm i mësimdhënies është pjesë e rëndësishme e vlerësimit të performancës së stafit akademik. Kontrolli dhe vlerësimi realizohet nëpërmjet katër rrugëve:

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

- *Vetëvlerësimi* është konsideruar si pikënisje e procesit të vlerësimit të performancës akademike të stafit mësimdhënës. UET-i inkurajon vetëvlerësimin për çdo anëtar të stafit akademik dhe lehtëson procesin nëpërmjet përdorimit të formave të ndryshme të vetëvlerësimit dhe vlerësimit në nivel paralel, si vizita reciproke në orë leksioni apo seminari, ballafaqime, diskutime dhe debate për çështje të caktuara. Në një të ardhme të afërt ky proces është planifikuar të realizohet nëpërmjet një formulari të veçantë, i cili do të plotësohet individualisht nga çdo anëtar i stafit akademik, dhe do të jetë pjesë integrale e të gjithë sistemit të vlerësimit të performancës së stafit akademik të këtij institucioni.
- *Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani*, të cilët kanë përgjegjësinë dhe të drejtën e vlerësimit të performancës së çdo anëtari të stafit përkatës, e cila realizohet gjithashtu në përputhje me formularin përkatës të monitorimit të një ore mësimi gjatë semestrit. Kontrollat në orët e leksionit apo të seminarit, si rregull, kryhen me paralajmërim të pedagogut përkatës, të paktën dy javë përpara vizitës në auditor. Rezultatet e këtyre kontrolleve iu janë bërë me dije pedagogëve përkatës, pas mbarimit të orës mësimore.
- Me rëndësi është konsideruar edhe *vlerësimi i studentëve*. Pyetësorët e organizuar për këtë qëllim, kanë qenë një nga mënyrat e përdorura për të marrë mendimin dhe vlerësimin e tyre për cilësinë mësimdhënies. Rezultatet e vlerësimeve të studentëve i janë bërë të ditura dekanatit si dhe pedagogëve.
- *Vlerësimi nga sekretaria mësimore*, e cila monitoron teknikisht zbatimin me korrektësi të orarit të mësimit, prezencën e pedagogut në orën e mësimit, si dhe respektimin e kohëzgjatjes së orës mësimore. Për këtë qëllim ka një regjistër të veçantë që pasqyron prezencën e pedagogut në orën e mësimit.

k) Dokumentacioni përkatës

1. Tabela përmbledhëse e cilësisë së stafit;
2. Dosja e shtypit;
3. Dosja e proces – verbaleve të mbledhjeve;
4. Libri i pedagogut;
5. Regjistri Themeltar;
6. Kontratat e studentëve;
7. Udhëzimi mbi Tutoriatin dhe Këshillimin Akademik.

VII. Kërkimi shkencor

a) Politika e kërkimit shkencor në të gjitha nivelet e UET-it

Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve të rëndësishme është edhe kërkimi shkencor në përputhje me filozofinë dhe misionin e UET-it, në përputhje me interesat e universitetit, të stafit akademik dhe studentor, si dhe në përputhje me kapacitetet njerëzore dhe financiare.

UET-i është konceptuar si një qendër kërkimore shkencore, në partneritet me të tretë, me institucionet, organizmat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare, me të cilët universiteti është në bashkëpunim. Në përmbushje të dimensionit të kërkimit shkencor, veprimtaria kërkimore shkencore shtrihet në drejtimet e mëposhtme:

- **Revistat shkencore**

Qëllimi i revistave shkencore është nxitja e debatit shkencor në mes të komunitetit akademik të UET-it dhe atij shqiptar e të huaj, si dhe publikimi i punës shkencore të stafit akademik.

Çdo fakultet ka revistën e tij shkencore, e cila, si rregull, botohet dy herë në vit në formatin B5, mes 120 – 150 faqe, nën drejtimin e kryeredaktorit përkatës. Pedagogët e brendshëm kanë përparësi në botimet e tyre, duke ruajtur kritere të rrepta shkencore dhe standarde akademike. Përgjithësisht janë inkurajuar numrat tematikë, të cilat kanë trajtuar në mënyrë të veçantë një fenomen, çështje e dukuri me interes për fushat e studimeve në UET. Numrat tematike apo “Dosja e numrit” është rakorduar me konferencat shkencore të fakultetit. Ato në themel përmbajnë punimet e konferencës.

- **Konferencat shkencore**

Çdo fakultet ka detyrimin të organizojë së paku dy konferenca shkencore në vit. Është rekomanduar që konferencat të kenë tematikë të njëjtë me revistat shkencore të fakultetit përkatës. Konferencat shkencore përgjithësisht i përgjigjen fushave të studimit të fakulteteve përkatës. UET-i ka financuar me një buxhet të posaçëm këto konferenca.

- **Botimet shkencore**

Pedagogët e brendshëm inkurajohen të botojnë libra shkencorë në kuadrin e Shtëpisë botuese UET-Press. Këto punime shkencore duhet të jenë autentike, me kritere akademike të rrepta, duke iu nënshtuar të gjitha kritereve perëndimore për botime të këtij lloji. Ato duhet të jenë me interes dhe vlerë për fushat e kërkimit të UET-it. Botimet shkencore mund të jenë të reja ose përshtatje e punimeve të mëparshme (Tema, Ese, mastera, doktatura etj). Fakulteti, Departamenti përkatës dhe UET - Press përcaktojnë sipas kërkesës së pedagogut vlerën shkencore, titujt dhe kalendarin.

Personeli akademik me grada e tituj, ka të drejtë që çdo 4 vjet punë të pandërprerë, për periudha kohe deri në 6 (gjashtë) muaj, të punojë për përparimin e tij akademik për të kryer një studim/monografi autentike, e cila botohet nga UET – Press. Kjo periudhë kohe do të jetë e paguar. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënies. Në një rast të tillë, projekti i tij i kërkimit kërkohet të miratohet nga Këshilli shkencor i fakultetit dhe nga UET - Press.

- **Grupet e kërkimit**

UET-i inkurajon krijimin dhe veprimtarinë e grupeve të kërkimit, të strukturuar përreth pedagogëve me tituj dhe grada brenda departamentit, ose bashkëpunime midis departamenteve. Këto veprimtari duhet të kenë një tematikë të caktuar, me interes për fushat e studimit, projektet e kërkimit dhe zhvillimit të UET-it. Kjo bëhet në rakordim me punimet e diplomave të studentëve, projektet me të tretë etj. Grupet e kërkimit koordinohen dhe me tematikat e revistave dhe konferencave. Kryetarëve të këtyre grupeve u zbriten 2 orë në javë nga ngarkesa e tyre përkatëse. Anëtarëve të këtyre grupeve u hiqet një orë në javë mësimdhënie nga ngarkesa përkatëse. Drejtuesit administrativë nuk përfitojnë nga ky reduktim i ngarkesës mësimore.

- **Institutet dhe Qendrat e kërkimit**

Për organizimin, bashkëveprimin dhe drejtimin cilësor dhe efektiv të kërkimit shkencor dhe në funksion të përmbushjes së filozofisë dhe misionit të UET-it krijohen njësi kryesore (Institute) dhe njësi bazë (Qendra të kërkimit shkencor). Institutet dhe Qendrat organizohen në grupe kërkimore shkencore me karakter të përhershëm ose të përkohshëm dhe janë në funksion të njërive kryesore dhe bazë duke nxitur, bashkërenduar dhe administruar veprimtarinë kërkimore-shkencore. Institutet dhe Qendrat krijohen me vendim të Senatit (për Institutet) ose të Këshillit të Fakultetit (për Qendrat). Veprimtaria kërkimore-shkencore e tyre realizohet mbi bazën e një plani vjetor dhe një plani afatgjatë, të konsultuar me njësinë kryesore, si dhe organet drejtuese të UET-it. Buxheti i veprimtarive të planifikuara miratohet nga Administratori mbi propozimin e Institutit/Qendrës.

- **Punimet e diplomës së studentëve**

Punimet e diplomës së studentëve, si të ciklit të parë, ashtu edhe të ciklit të dytë të studimeve, mund të inkuadrohen tek politikat shkencore të UET-it, në kuadrin e Instituteve, qendrave dhe grupeve të kërkimit. Dhjetë punimet më të mira të diplomës të çdo viti akademik, të vlerësuara nga një komision akademik i ngritur nga rektori, botohen në një libër të veçantë.

Plani i integruar i kërkimit shkencor të fakulteteve, instituteve dhe qendrave të kërkimit, i paraqitet për miratim Senatit Akademik.

b) Numri i botimeve në pesë vitet e fundit nga stafi i qëndrueshëm i UET

Gjithsej anëtarët e stafit akademik (të brendshëm, senior dhe me ngarkesë të veçantë) kane botuar mbi 193 botime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, brenda 5 viteve të fundit. Në këtë kategori hyjnë tekste në dobi të studentëve, libra dhe artikuj, brenda dhe jashtë vendit. Kjo dëshmon se stafi akademik i qëndrueshëm është mjaft cilësor, me aktivitet të dalluar botues brenda dhe jashtë vendit.

Ky është tregues për politikat dhe kriteret e përzgjedhjes cilësore të stafit akademik. I gjithë ky potencial vihet në dispozicion të studentëve që ndjekin studimet në këtë institucion mësimor dhe akademik.

Tabelë e botimeve të stafit akademik

Tekste	Libra		Artikuj	
	Brenda	Jashtë	Brenda	Jashtë
15	37	6	66	69

c) Numri i projekteve të zbatuara në pesë vitet e fundit

Pjesë e strukturës së UET-it është edhe Zyra e Aktiviteteve, e cila merret vetëm me kontaktimin, organizimin, zhvillimin, mbikëqyrjen, monitorimin, dokumentimin, si edhe arkivimin e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara. Llojet e aktiviteteve, të cilat janë njaft të larmishme, mund të klasifikohen si më poshtë:

- 1) Aktivitete shkencore (20-të të tilla);
- 2) Projekte kombëtare apo ndërkombëtare, ku UET-i ka marrë pjesë si parter (4 të tilla);
- 3) Seminare me lektorë të ftuar, vendas ose të huaj (46 të tilla).
- 4) Aktivitete studentore (49 të tilla).

Një paraqitje e detajuar e aktiviteteve që janë organizuar në UET gjatë periudhës 2006-2009 gjendet në pasqyrën bashkëngjitur këtij raporti.

d) Pjesëmarrja e stafit në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe prezantime

Referime në konferenca		Pjesëmarrje në konferenca pa referime	Raporte kërkimore - studimore
Brenda vendit	Jashtë vendit		
83	74	9	21

Baza e të dhënave rreth veprimtarisë shkencore dhe botuese të stafit akademik (të brendshëm, senior dhe me ngarkesë të veçantë) bën një pasqyrim të detajuar të pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete të tilla.

e) Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara që nga viti 2006

Për periudhën 2006-2009 nga UET-i janë organizuar 20-të aktivitete shkencore (Konferenca), ku ndër më kryesoret përmendim:

1. Konferenca shkencore "BE-ja dhe Presidenca Franceze (UET, Ambasada Franceze, Komisioni European në Tiranë dhe Ambasada e Çekisë), në kuadër të së cilës, në çdo ditë të javës u diskutuan tema të ndryshme si:

"Përplasja e qytetërimeve apo përplasja nga injoranca", me moderator: Z. Fatos Beja (Ministër i Arsimit dhe Shkencës), Shkëlqesia e saj Znj. Maryse Daviet, (Ambasadore e Republikës Franceze në Shqipëri), Shkëlqesia e saj Znj. Marketa Fialkova (Ambasadore e Republikës së Çekisë në Shqipëri), Znj. Majlinda Bregu (Ministre e Integritimit); *"Media dhe komunikimi politik"*, me moderator: Z. Slimane Zeghidour (redaktor, përgjegjës i TV5); *"Kinemaja dhe televizioni në Europë"*, me moderator: Z. Dominique Wolton (Drejtor i kërkimeve në CNRS); *"Rritja dhe zhvillimi: Sfidat e Shqipërisë në një kontekst rajonal"*, me moderator: Z. Jerome Detombes (këshilltar financiar rajonal), Letërsia franceze e përkthyer në shqip-Ekspozitë botimesh nga shtëpitë e botimit (diskutim me përkthyes dhe autorë). Në bashkëpunim me Akademinë e filmit "Marubi" u transmetua filmi *"Jam urreyer aq shumë"* i Z. Franck Apprederis (regjisor i filmit).

2. Konferenca shkencore *“KUSHTETUTA E SHQIPËRISË, 1998-2008: 10 VJET MË PAS”*, një bashkëpunim ky i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Universitetit European të Tiranës dhe Komitetit të Helsinkit. Konferenca, e cila u zhvillua në dy seanca të plota, mbledhi rreth saj emrat më të njohur të fushës së ligjit në vend, të cilët referuan tema të mprehta dhe aktuale të shoqërisë shqiptare dhe ligjit në përgjithësi. Moderator të këtij evenimenti shkencor ishin: Z. Sabri Godo, Z. Arben Imami, të cilët kanë qenë bashkëkryetarët e komisionit për hartimin e kushtetutës në vitin 1998; Znj. Shpresa Becaj, kryetare e Gjykatës së Lartë, e cila foli për Gjykatën e Lartë, pozita kushtetuese dhe roli i saj në sistemin e ri; Z. Ilir Rusmajli, deputet, Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore në Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë; Znj. Vasilika Hysi, kryetare e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, e cila bëri një panoramë të lirive dhe të drejtave të njeriut; Z. Spartak Ngjela, deputet, ish-anëtar i komisionit për hartimin e kushtetutës, i cili solli një panoramë të konflikteve të brendshme të shoqërisë shqiptare dhe kushtetutës. Një nga temat që ngjalli një debat interesant të ftuarit ishte *Raportet shtet-fe: risitë dhe problematika nisur nga Kushtetuta*, temë kjo e sjellë nga Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, dekan i Fakultetit Juridik, UET dhe Prof. Dr. Gaetano Dammacco, Universiteti i Barit, Itali. Një tjetër referim ishte *Legjitimiteti politik i procesit kushtetues në Shqipëri: tiparet dhe pasojat e këtij procesi*, i mbajtur nga Z. Henri Çili, pedagog i UET-it. Larmia e temave të sjella nga lektorët bëri që pjesëmarrësit e organizatave, shoqërisë civile dhe studentët të diskutonin gjatë në lidhje me këto tema të nxehta të Kushtetutës së Shqipërisë.

3. Konferenca shkencore *“GJYQËSORI ‘90+ ‘17 SFIDAT E REFORMIMIT”*. Kjo konferencë pati një pjesëmarrje të gjerë akademikësh e studiuesish nga fusha të ndryshme të së drejtës, drejtues e funksionarë të organeve dhe institucioneve të larta të drejtësisë, të pushtetit e të administratës së lartë shtetërore, studentë nga universitete të ndryshme të vendit, si dhe të ftuar të tjerë. Konferenca trajtoi me nivel të lartë shkencor dhe kompetencë profesionale një varg aspektesh të reformës së gjyqësorit në Shqipëri. Ndër kumtesat kryesore përmendim: *Pavarësia e gjyqësorit, kusht dhe rezultat i reformës; Këshilli i Lartë i Drejtësisë, organ i vetëqeverisjes së gjyqësorit; Gjykata Kushtetuese dhe reforma e gjyqësorit; Mendime për reformën në drejtësi: arsimimi, parakusht për një gjyqësor bashkëkohor; Gjykata e Lartë në funksionin unifikues; Gjendja aktuale e profesioneve të lira nxit apo frenon reformën në gjyqësor; Reforma dhe përafrimi i legjislacionit me të drejtën komunitare*. Këto kumtesa përbëjnë pjesën thelbësore të dosierit të numrit të parë të Revistës “Jus & Justicia”, të cilat u botuan të pandryshuara.

f) Pjesëmarrja si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare

Ndër projektet më të rëndësishme të zbatuara gjatë periudhës 2006 – 2009 mund të përmenden:

- Projekti mbarëkombëtar me temë: *“Një mundësi më tepër”*, edicioni i 2008-ës, me përmbledhje të punimeve më të mira nga konkursi me ESE për nxënësit e shkollave të mesme shtetërore dhe private në të gjithë vendin. Ky konkurs ishte një bashkëpunim i Raiffeisen BANK, Moving Culture dhe UET-it. Partneriteti në këtë projekt u realizua për të dytën herë. Për 14 esetë më të mira u ndanë çmime, duke përfshirë 3 bursa trevjeçare studimi, 5 bursa njëvjeçare dhe 6 kompjutera portativë. Ndër 193 esetë të vlerësuara, 31 janë përzgjedhur për t'u botuar në një libër me titull: *“EDICIONI I 2008-ës, NJË MUNDËSI MË TEPËR PËRMBLEDHJE E PUNIMEVE MË TË MIRA NGA KONKURSI ME ESE PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME”*.
- Botimi në shqip i revistës së njohur amerikane "Foreign Policy", bashkëpunim i Institutit Shqiptar të Medias, Klubit të Politikës së Jashtme dhe Forumit 2015 në Prishtinë dhe Universitetit European të Tiranës. Revista do të shpërndahet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni etj.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

- Botimi i revistës akademike ndërkombëtare "Sociological Analysis," kryeredaktor i së cilës është Dr. Fatos Tarifa, pedagog në UET. Kjo revistë dizajnohet në Toronto të Kanadasë, printohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe publikohet nga "Globic Press" Chapel Hill, NC, USA, me faqe interneti: www.globic.org. Përveçse në Shqipëri, ka një tirazh shitjesh edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

g) Organizimi i seminareve me lektorë të jashtëm, vendas ose të huaj

Gjate periudhës 2006 – 2009 janë zhvilluar mbi 46 seminare me lektorë të jashtëm, vendas ose të huaj (AUDITORIUME, Leksion i hapur).

Ndër më të rëndësishmet mund të përmenden:

- *"Transformimi i Diplomacisë Franceze"*, me moderatore ambasadorën e Republikës Franceze në Tiranë.
- *"Integrimi i Shqipërisë në BE,"* me moderatore Znj. Majlinda Bregu (Ministre e Integritimit). *"Integrimi i Ballkanit Perëndimor në strukturat Euro-atlantike"*, me moderator Z. Constantinos Kokossis (Ambasadori i Republikës së Greqisë).
- *"Sistemi zgjedhor në Shqipëri"*, me moderator Z. Çlirim Gjata (ish-kryetar i KQZ-së).
- *"Europa dhe Globalizimi"*, me moderator Z. Michel Rocard (ish-kryeministër i Francës/eurodeputet).
- *"Izraeli sot, çështjet ekonomike, politike, raportet dhe konfliktet, marrëdhëniet dypalëshe si dhe zgjidhja për Lindjen e Mesme"*, moderatore Znj. Amira Arnon (Ambasadore e jashtëzakonshme dhe fuqiptotë e Izraelit në Shqipëri).
- *"Të shkruash për median"*, moderatore e këtij cikli leksionesh me studentë edhe jashtë UET-it, Znj. Alessia Grieco Vessicchio (regjisore e emisionit "E Diell" në Top Channel).
- *"Politika e Jashtme e SHBA-së"* me moderator: Dr. Janusz Bugajski, (Drejtor i Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare me seli në Uashington) si edhe Prof. Dr. Bernd Fischer (Profesor në SHBA, i vlerësuar si historiani më i mirë i huaj për Shqipërinë).
- *"Romët në Evropë"*, me moderator Z. Jean Pierre Ligeosi (Profesor në Universitetin e Parisit-V Sorbonë), me pjesëmarrjen e disa shoqatave Rome si edhe përfaqësues nga Ministria e Punës e Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta.
- *"Bankat qendrore dhe roli i tyre në situatat e krizave financiare"*, me moderator: Z. Fatos Ibrahim (zv/guvernator i parë i Bankës së Shqipërisë).
- *"17 Janari, Ditë lutjeje dhe Reflektimi Kombëtar, si dhe situata në Maqedoni"*, me moderator: Z. Ali Ahmeti (Kryetar i BDI-së në Maqedoni).

h) Infrastruktura shkencore

Edhe pse në vitin e tretë të ekzistencës së tij, UET-i ka krijuar një infrastrukturë të zhvilluar jo vetëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor në të gjitha programet e tij, por edhe për veprimtarinë shkencore që kryhet në këtë institucion të arsimit të lartë.

Tashmë janë ngritur dhe funksionojnë dy institute kërkimore—Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave (ISSP) dhe Instituti i Studimeve Bashkëkohore të Historisë (ISBH)—të cilët organizojnë dhe koordinojnë aktivitetin kërkimor-shkencor në të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë të universitetit. Institutet janë të organizuar në sektorë studimorë, të cilët kryejnë veprimtarinë e tyre në një apo disa fusha të përafërta studimesh. Veprimtaria kërkimore e Instituteve orientohet nga interesa të mirëfillta akademike që kanë të

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

bëjnë me probleme sociale, politike, ekonomike e kulturore të vendit, të rajonit apo më gjerë, dhe që paraqesin dobi teorike dhe praktike për jetën akademike të vendit dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi.

Institetet mbajnë lidhje pune e bashkëpunimi akademik me universitete dhe qendra kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si Universitetin e Tiranës, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universitetin e Korçës "Fan S. Noli", Akademinë "Marubi", Universitetin "Polis", Universitetin e Karolinës së Veriut, Universitetin e Nju Jorkut, Universitetin e Miçiganit Lindor në SHBA, Universitetin Ekseter (Angli), etj.

Puna kërkimore shkencore realizohet në të gjitha njësitë bazë të tij përmes grupeve kërkimore që funksionojnë pranë çdo departamenti. Këto grupe përfshijnë në bazë jo permanente anëtarë të stafit akademik, që së bashku punojnë për një studim të caktuar brenda së njëjtës disipline, apo në disa disiplina të përafërta. Institetet koordinojnë punën e tyre në mënyrë që veprimtaria studimore të jetë jo vetëm ndërdisiplinore por edhe ndër-departamentale.

Secili nga Institetet organizon dy konferenca (kombëtare ose ndërkombëtare) në vit, në të cilat kumtohen rezultatet e veprimtarisë së tyre studimore. Në to, si rregull ftohen të marrin pjesë edhe studiues të huaj, të cilët janë bashkëpunëtorë të jashtëm të instituteve.

ISSP boton dy herë në vit, në gjuhën angleze, revistën akademike ndërkombëtare *Sociological Analysis*.

Çdo fakultet boton revistën e tij shkencore, e cila del dy herë në vit. Këto revista janë: *Polis* (Fakulteti i Shkencave Sociale), *Economicus* (Fakulteti Ekonomik) dhe *Jus & Justicia* (Fakulteti Juridik).

Secili nga fakultetet organizon dy konferenca shkencore në vit, në të cilat prezantohen punimet e pedagogëve të tyre, të realizuar në kuadër të grupeve të kërkimit shkencor apo në bashkëpunim me Institetet e UET-it. Punimet e prezantuara në këto konferenca botohen edhe në një numër të veçantë të revistës përkatëse të fakultetit. Ndërkohë, në këto revista krijohet hapësirë edhe për publikimin e punimeve të tjera shkencore nga fusha përkatëse.

Veprimtaria studimore e stafit akademik sheh dritën e botimit në publikimet e shtëpisë botuese UET Press.

Puna kërkimore shkencore e pedagogëve dhe e punonjësve shkencorë të UET-it lehtësohet nga biblioteka, e cila, si pjesë e infrastrukturës shkencore të UET-it i mundëson stafit akademik shfrytëzimin e një literature shumë të pasur bashkëkohore (libra dhe revista akademike) të arkivuar në sistemet e bibliotekave elektronike *Questia* dhe *Jstor*.

i) Lidhja e kërkimit shkencor me procesin mësimor

Synimi kryesor i veprimtarisë kërkimore shkencore është t'i vijë në ndihmë pasurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së procesit mësimor, si edhe ngritjes së vazhdueshme të standardeve akademike në UET. I gjithë stafi akademik është i angazhuar në procesin e integritit të rezultateve të punës së tyre kërkimore - shkencore veçanërisht në procesin e mësimdhënies, duke përfshirë jo vetëm në leksione, por edhe seminare, publikimet e tyre në monografi shkencore dhe në revistat që boton UET-i. Shpesh për këtë qëllim organizohen edhe seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e gjerë të stafit akademik dhe studentëve. Në të gjitha këto veprimtari anëtarët e stafit akademik përditësojnë njohuritë e studentëve me të rejat e rezultuara nga puna e tyre hulumtuese, në përputhje me fushat e ekspertizës.

Një mënyrë shumë efektive përmes së cilës realizohet lidhja e kërkimit shkencor me procesin mësimor është organizimi periodik (çdo javë) i tryezave të debatit në fusha të tilla si filozofia, sociologjia, shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto tryeza drejtohen nga pedagogët dhe tërheqin një masë të madhe studentësh dhe anëtarësh të stafit akademik. Prezantimet dhe debatet që zhvillohen në to janë një mënyrë e sigurt dhe mjaft efektive për të informuar studentët dhe kolegët mbi çështje teorike dhe rezultate të kërkimeve shkencore në fushat e sipërpërmendura, për të nxitur mendimin e tyre racional krijues, si edhe për të rritur angazhimin e vetë studentëve në veprimtarinë kërkimore të instituteve dhe të departamenteve.

j) Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor

UET-i ka në thelb të filozofisë së tij kërkimin shkencor dhe në këtë kuadër përfshirjen e studentëve në këtë veprimtari të rëndësishme. Ndër aktivitetet shkencore ku janë përfshirë edhe studentët përmenden:

A. Sondazhet e organizuara nga Qendra e Studimeve Politike pranë UET-it.

Studentët u angazhuan në një studim mbi aftësitë e kuptimit të gjuhës së politikanëve. Studimi mbështetej në një sondazh të realizuar me 760 votues të Tiranës dhe synonte të kuptonte dhe maste aftësinë e tyre për të kuptuar fjalorin dhe metaforat kryesore të përdorura nga politikanët tanë, kryesisht nga liderët. Në sondazh u angazhuan 25 studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale. Studimi u realizua në maj 2007.

B. Universiteti Veror European: "Përdorimet e normës: politika, shoqëria dhe pushteti" Sarandë 1-11 shtator 2008, Organizuar nga Universiteti European i Tiranës, në kuadër të rrjetit ndërkombëtar të studuesve OFFRES.

Universiteti Veror European i Sarandës u zhvillua në shtator 2008 në kuadrin e Universiteteve Europiane Verore të Organizatës Frankofone për Formim dhe Kërkim Shkencor European në Shkencat Humane (OFFRES), të cilat synojnë zhvillimin afatgjatë të një rrjeti « Europë Qëndrore dhe Lindore » që konsiston në kërkim shkencor, specifikisht në atë frankofon në fushën e shkencave humane dhe sociale. Shqipëria kishte për herë të parë ekskluzivitetin organizativ të këtij aktiviteti ndërkombëtar.

Që prej vitit 1993 është formuar një rrjet i përbërë prej një forme të dyfishtë bashkëpunimi : të kontakteve të shumëfishta shkencore mes vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore, në partneritet me shoqatat të cilat kanë fituar një eksperiencë të konsiderueshme në lëmin e bashkëpunimeve intelektuale - Shoqata Rumune e Frankonisë (ARCHES), Shoqata Çeke dhe Sllovake (JAN HUS), si dhe në bashkëpunim të ngushtë mes Universitetit të NICE-SOPHIA Antipolis dhe Universitetit CHARLES DE GAULLE-LILLE III. Rrjeti frankofon i kërkimit shkencor përfshin rreth 15 vende të Europës Qëndrore dhe Lindore : Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Greqinë, Hungarinë, Maqedoninë, Moldavinë, Poloninë, Republikën Çeke, Rumaninë, Sllovakinë, Slloveninë, Kosovën, Malin e Zi dhe Sebinë.

Përveç qëllimit shkencor Universiteti Veror European i Sarandës kishte si prioritet thelbësor edhe promovimin e pasurive kulturore shqiptare në jug të vendit, si Kakome, Finiq, Butrint, Ksamil, Sarandë (Kala e Lëkurësit etj), Syri i Kaltër, Gjirokastër. Ky aktivitet pati referues dhe audiencë të përzgjedhur, midis tyre profesorë, doktorantë, persona me tituj të lartë shkencorë, me akses në universitetet më të mira të Europës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore, botues të një sërë studimesh dhe refleksionesh shkencore, si dhe opinionbërës të njohur në mediat europiane.

Partnerë të UET-it në organizimin e këtij aktiviteti ishin:

- Agjencia Universitare e Frankofonisë (Zyra e Europës Qendrore dhe Lindore, Zyra e Europës Perëndimore dhe e Magrebit)
- Ambasada Franceze në Tiranë
- Ministria Franceze e Punëve të Jashtme (DRIC)
- Ministria Franceze e Arsimit Kombëtar
- Ambasada Franceze në vendet respektive
- Ambasada Greke në Shqipëri
- Bashkia e Sarandës
- Fondacioni Soros, Tiranë
- Universiteti i Tiranës

C. Studimi i Institutit të Studimeve Sociale dhe Politikave: “Realiteti politik, kulturor dhe ekonomik – social i Shqipërisë, 20 vjet mbas fillimit të procesit të tranzicionit demokratik”.

Klubi studentor i çështjeve sociale aktualisht përbëhet nga mbi 30 studentë, të cilët vullnetarisht kanë zgjedhur të përfshihen në aktivitete kërkimore – shkencore, në kuadër të Institutit të Studimeve Sociale dhe Politikave, pranë UET. Ky klub është pjesëmarrës në studimin me temë: *Realiteti politik, kulturor dhe social – ekonomik i Shqipërisë, 20 vjet mbas fillimit të procesit të tranzicionit demokratik*”.

Roli i studentëve në këtë studim është ndërmarrja e kërkimeve empirike, veçanërisht si intervistues dhe anketues.

D. Botimi i një përmbledhje aktesh e dokumentesh të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe, për periudhën e viteve 1922 – 1938.

Instituti i Historisë Bashkëkohore pranë UET-it, ka filluar punën për përgatitjen e një Përmbledhjeje dokumentesh të Foreign Office për Shqipërinë në periudhën e viteve 1922-1938. Përgatitja e këtij botimi do të mbështetet në Raportet Vjetore (Annual Reports) të Foreign Office për Shqipërinë.

k) Çmime kombëtare ose ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor

UET-i nxit studentët e tij të marrin pjesë e të konkurrojnë në kompeticione të gjera brenda dhe jashtë vendit. Studentët e UET-it kanë arritur të vlerësohen me çmime të ndryshme kombëtare ose ndërkombëtare, si më poshtë:

1. Studentja Dikensa Topi fitoi çmimin e parë për esenë më të mirë në konkursin e organizuar nga Ambasada e SHBA-së në vitin 2008.
2. Studentet Jonilda Hoxha dhe Elona Shehu fituan vendin e parë në konkursin kombëtar që u zhvillua në Sarandë me pjesëmarrjen e studentëve të fakulteteve ekonomike të disa prej universiteteve më të rëndësishme të vendit.
3. Një formë tjetër inkurajimi dhe motivimi për studentët e UET-it është organizimi mbi bazë vjetore e “Çmimit të Rektorit” për esenë më të mirë.

I) Dokumentacioni përkatës

1. Bazë të dhënash mbi veprimtarinë kërkimore – shkencore të stafit;
2. Udhëzimi mbi politikat e kërkimit shkencor në UET dhe Plani i punës shkencore 2008 – 2009 dhe 2009 – 2010;
3. Udhëzimi mbi Institutet dhe Qendrat e Kërkimit Shkencor dhe Planet e Instituteve;
4. Dosja e veprimtarisë së qendrave;
5. Revistat shkencore dhe botimet e monografive, botimet në proces;
6. Dosja e aktiviteteve shkencore, akademike, social-kulturore të zhvilluara.

VIII. Studentët

a) Politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve dhe pasuniversitarëve: rregullat, kontrolli i dijeve, kriteret e përzgjedhjes, transparenca, statistikat dhe dokumentacioni përkatës.

Në lidhje me politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve në të dy ciklet e studimit janë hartuar udhëzime të veçanta. Ata përfshijnë:

- Informimin dhe ndërgjegjësimin;
- Parimet;
- Kriteret e pranimit; dhe
- Procedurat e pranimit.

Me qëllim ndërgjegjësimin e qytetareve për të ndjekur studimet në UET, realizohet informimi i tyre nëpërmjet formave të mëposhtme:

- a. Organizim i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuese me nxënës të gjimnazeve të Tiranës dhe qyteteve të tjera të vendit në mjediset e tyre, si dhe takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë.
- b. Organizimi i seminareve, tryezave të rrumbullakëta, leksioneve hyrëse dhe veprimtarive të tjera me karakter mësimor-informues-argëtues me nxënës të gjimnazeve të Tiranës dhe qyteteve të tjera të vendit në mjediset e UET-it, si dhe me grupe studentësh të ciklit të parë të studimeve, të cilët shfaqin prirje për vijimin e studimeve në cikle më të larta.
- c. Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuese, si fletë-palosje, postera, broshura etj, si dhe atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promocionale, etj.
- d. Organizim logjistik, orientues, me mbështetje të burimeve njerëzore të UET-it, në “Javët e Regjistrimit,” gjatë të cilave, të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve në UET, procedurat e aplikimit dhe pranimit, si dhe pajisen me dokumentacionin përkatës për të dy ciklet.

Parimet e pranimit të studentëve

Nëpërmjet politikave, kriterëve dhe procedurave, synohet të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatët me rezultatet më të larta.

Programet e ciklit të II^ë të studimeve në UET synojnë që të angazhojnë studentët në sfidën e përbashkët të thellimit të dijeve. Për këtë ne kërkojmë studentë me aftësi akademike që dëshirojnë të angazhohen seriozisht në projekte studimi individuale apo grupi, për të arritur së bashku krijimin e një mjedisi intelektual, ku mësohet, debatohet dhe lindin ide të reja zhvillimi.

Në vlerësimin e aplikimeve për këto programe synojmë që të krijojmë një komunitet me interesa dhe *background* të ndryshëm, sepse besojmë se diversiteti e bën procesin e mësimin më të pasur dhe i ndihmon studentët që t'i formulojnë idetë e tyre më mirë në perspektivë. Kështu që ne inkurajojmë për të aplikuar edhe studentë që kanë kryer studime universitare të nivelit të parë edhe në fusha të tjera nga ato të propozuara për programet Master të Nivelit të Parë.

Kriteret e pranimit

I. Në programet e studimit të ciklit të parë, pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këta kriteret:

- a) vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Shqipërisë, MASH);
- b) kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose totale sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes UET-it dhe Studentit;
- c) dorëzojnë dokumentet e nevojshëm për lidhjen e kontratës.

II. Në mënyrë që të pranohen në një program studimi të ciklit të dytë, kandidatët duhet të plotësojnë këto dokumente:

- a. Formularin e pranimit (ky dokument mund të jetë edhe online);
- b. Kopjen e noterizuar të diplomave të nivelit të parë që studenti ka fituar;
- c. CV, ku të paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale;
- d. Një Letër Interesi (afërsisht 500 fjalë për programet DND dhe 300 fjalë për programet MNP), ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e ciklit të dytë;
- e. Një projekt-ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore gjatë studimeve të ciklit të dytë;
- f. Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studime në ciklin e dytë;
- g. Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën një avantazh.

Procedura e pranimit

Përzgjedhja e kandidatëve për programet e ciklit të parë të studimeve bëhet nga një komision përkatës i caktuar nga Dekanati, duke u bazuar në një formular pranimi dhe mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe mesatares së shkollës së mesme, ose të një diplome tjetër të Nivelit të Parë.

Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të çdo fakulteti, për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, aktet nënligjore përkatëse dhe Statutin e UET-it.

Për programet e ciklit të dytë të studimeve dokumentet e përmendura më sipër duhet të paraqiten brenda afatit të caktuar në zyrën përkatëse të programeve të ciklit të dytë.

Pas një vlerësimi formal të listës së dokumenteve të nevojshme, ato i kalohen Departamentit përkatës, i cili kryen një vlerësim profesional të kushteve të çdo kandidati me kriteret akademike e shkencore të programit. Departamenti shpall listën e kandidatëve fitues për programet e ciklit të dytë dy javë përpara fillimit të procesit mësimor.

b) Ngarkesa mësimore e studentëve në auditor dhe jashtë tij; sistemi i krediteve sipas viteve të studimit për çdo kurs studimi

Ngarkesa mësimore e studentëve parashikohet në përputhje me rregulloren e çdo programi studimi. Në këto rregullore pasqyrohet periudha kohore e organizimit të secilës nga disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit, ngarkesa e tyre në ECTS, në orë në auditor dhe orë pune individuale.

Ngarkesa konkrete mësimore për studentët kushtëzohet nga natyra e lëndëve (teorike ose praktike), nga kreditet që ka secila lëndë, si dhe nga mënyra se si përftohen këto kredite.

Lendet teorike:

Me 6 kredite janë të barabarta me 150 orë pune të ndara si vijon:

Orë në auditor: 15 javë x (3 orë leksion + 1 orë seminar) = 60 orë

Orë pune individuale: 90 orë.

Me 5 kredite janë të barabarta me 125 orë pune, të ndara si vijon:

Orë në auditor: 15 javë x (2 orë leksion+1 orë seminar) = 45 orë; 5 orë detyra praktike; në total 50 orë.

Orë pune individuale: 75 orë

Me 3 kredite janë të barabarta me 75 orë pune, të ndara si më poshtë:

Orë në auditor: 15 javë x (1 orë leksion+ 1 orë seminar) = 30 orë

Orë pune individuale: 45 orë.

Lëndët praktike:

Me 6 kredite janë të barabarta me 150 orë punë, të cilat ndahen si vijon:

Orë në auditor: 15 javë x (2 orë leksion + 2 orë seminar) = 60 orë

Orë pune individuale: 90 orë

Me 5 kredite janë të barabarta me 125 orë punë, të cilat ndahen si vijon:

Orë në auditor: 15 javë x (1 orë leksion + 2 orë seminar) = 45 orë; 5 orë projekt detyra; në total 50 orë.

Orë pune individuale: 75 orë

Me 3 kredite janë të barabarta me 75 orë punë, të cilat ndahen si vijon:

Orë në auditor: 15 javë x 2 orë leksion/seminar = 30 orë

Orë pune individuale: 45 orë.

Në programin e studimit DNP “Juridik” një student merr:

- Në vitin e parë të studimeve 58-64 ECTS, nga të cilat 58 me lëndë të detyrueshme;
- Në vitin e dytë të studimeve 59-65 ECTS, nga të cilat 47 janë me lëndë të detyrueshme;
- Në vitin e tretë të studimeve: 58-63 ECTS, nga të cilat 40 janë me lëndë të detyrueshme.

Për programet e studimit DNP të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Sociale: “Marrëdhënie publike – komunikim”, “Shkenca politike”, “Marrëdhënie ndërkombëtare” një student merr:

- Në vitin e parë të studimeve 58-64 ECTS, nga të cilat 58 me lëndë të detyrueshme;
- Në vitin e dytë të studimeve 59-65 ECTS, nga të cilat 47 me lëndë të detyrueshme;
- Në vitin e tretë të studimeve 54-60 ECTS, nga të cilat 36 me lëndë të detyrueshme.

Në programet e studimit DNP të ofruara nga Fakulteti Ekonomik: “Financë & Banka” dhe “Menaxhim Biznesi” një student merr:

- Në vitin e parë të studimeve 61-62 ECTS, nga të cilat 56 me lëndë të detyrueshme;
- Në vitin e dytë të studimeve 60-66 ECTS, nga të cilat 54 me lëndë të detyrueshme;
- Në vitin e tretë të studimeve 54-60 ECTS, nga të cilat 36 me lëndë të detyrueshme.

c) Temat e diplomave: kriteret, kryerja e tyre, kapaciteti i UET-it

Për të fituar “Diplomën e Nivelit të Parë” studentët, përveç arritjes së rezultateve pozitive në programin e studimit, duhet të mbrojnë edhe një punim individual. Departamentet, në kuadrin e Fakulteteve përkatëse, kanë përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen e procedurave të përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit dhe të mbrojtjes së tezës së diplomës.

Në kuadrin e mbarëvajtjes së punimit të diplomës, departamentet propozojnë çdo vit akademik një listë me emrat e udhëheqësve potencialë që janë pjesë e stafit akademik të UET-it. Në përpilimin e listës mbahet parasysh që udhëheqësit e propozuar të jenë ekspertë të fushës së kërkimit në programin e studimit që propozohet, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij. Për të garantuar cilësinë e udhëheqjes fakultet përkatëse bëjnë kujdes që udhëheqësit e temave të mos jenë të mbingarkuar me udhëheqje diplomash. Kështu maksimumi kontraktual për udhëheqje temash diplome DNP për pedagogët e brendshëm është 8 studentë.

Me qëllim mbarëvajtjen e procesit të kryerjes së diplomës komisioni i ngritur pranë fakulteteve përkatëse miraton temat e diplomave dhe udhëheqësit e tyre, duke garantuar që studentët të kenë mundësinë dhe lehtësirat e duhura për të realizuar kërkimin e tyre, që t'u sigurohet konsulenca e nevojshme dhe të respektohen politikat e udhëheqjes së kërkimit në përputhje me standardet e kërkimeve shkencore në UET.

Për mbarëvajtjen e punimit të diplomës është hartuar edhe një udhëzues i veçantë mbi procedurat e përgatitjes, mbikëqyrjes dhe e shqyrtimit të ecurisë së kërkimit dhe të mbrojtjes së tezës. Bazuar në këtë udhëzim, asistenca e ofruar nga pedagogu udhëheqës përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi mban takime të rregullta me studentin (të paktën 2-3 orë në javë) për të dhënë këshilla dhe për të qenë në dijeni të ecurisë së kërkimit. Udhëheqësi, gjithashtu ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës, në përputhje me politikat e integritetit akademik.

Me miratimin e temës dhe të udhëheqësit të saj, studentit i jepet edhe një grafik orientues për organizimin e punës për realizimin e diplomës. Nga studenti kërkohet të zbatohet standardet shkencore dhe etike të parashikuara për tezën, si dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për të përfunduar punimin në kohën e duhur.

Për të lehtësuar punën e studentit, atij i vihet në dispozicion një model i strukturës së tezës, metodologjisë si dhe kërkesave teknike të paraqitjes së punimit.

Punimi i diplomës mbrohet përpara një komisioni. Procedura e mbrojtjes së tezës përfshin:

- a. Paraqitjen e përmbledhur të punimit nga kandidati për 10-15 minuta;
- b. Paraqitjen e vlerësimit nga udhëheqësi shkencor;
- c. Seancën pyetje dhe përgjigje rreth punimit;
- d. Vlerësimin e komisionit.

Komisioni i vlerësimit përbëhet nga tre pedagogë të Fakultetit ose UET-it, ose specialistë të fushës që punojnë në institucione shkencore. Një nga pedagogët është drejtuesi i diplomës ndërsa dy të tjerët luajnë rolin e oponentëve. Anëtarët e komisionit dhe recentët duhet të kenë të paktën gradën Master i Nivelit të Dytë.

Vlerësimi i tezës behet sipas sistemit të vlerësimit në UET. Në rastet kur punimi nuk i plotëson standardet shkencore dhe etike, studentit mund t'i kërkohej një mbrojtje e dytë. Komisioni i vlerësimit mund të rekomandojë plotësime dhe përmirësime të punimit. Në raste të tilla studentit i caktohet një kohë shtesë për të plotësuar vërejtjet. Punimi i përmirësuar riparaqitet në sesionin e radhës të mbrojtjes së diplomave. Studenti që vlerësohet me notën katër në mbrojtjen e punimit të tezës ka të drejtë të riparaqitet në mbrojtjen e saj në vitin pasardhës. Kur ka mosmarrëveshje midis anëtarëve të komisionit për përmbushjen e standardeve të punimit, atëherë i kërkohej Dekanatit përkatës të miratojë pjesëmarrjen e një anëtari tjetër në komisionin e vlerësimit.

d) Llojet e aktiviteteve të studentëve

Ndër aktivitetet e zhvilluara me studentët nga viti 2006-2009 janë:

- *"Bursat e ekselencës dhe Çmimi i Rektorit"*. Është i treti vit që në UET akordohen bursa për studentët me mesatare të lartë, si dhe për ESE-në më të mirë. Kjo është një formë e stimulimit e motivimit për studentët me rezultate të larta. Por, gjithashtu, bursa janë dhënë edhe për kategori më specifike, si bursa për fëmijët e policëve të vrarë, fëmijët e komunitetit Rom, bursa për talentet e reja, bursa për të rinjtë e forumeve politike, etj.
- *"Let's Play Golf"* Golf & Tennis Klub Tirana, Kompleksi i parë dhe i vetëm në Shqipëri që ofron mundësinë e lojës së golfit. Akademia e Golfit përgatit një brez të ri lojtarësh golfi në Shqipëri. Ndër temat që u trajtuan në këtë aktivitet nga Znj. Albana Veleshnja (Kryetare e Golf & Tennis Klub Tirana) ishin: familjarizimi me rregulloren e lojës së golfit, përdorimi i shkopinjve të golfit, mësimi i qëndrimit, gjuajta e topit, shënimi në distancë të shkurtër etj.
- *Mundësi studimi në Queen Mary, University of London* "The Success of Your Future Studies is Our Mission", një prezantim për studentët e vitit të fundit për mënyrën se si mund të aplikojnë për të studiuar në programet master pranë Queen Mary, University of London.
- Shfaqja e filmit *"Persepolis"* me temë *"Revolucioni Islamik i vitit 1997 në Iran"*. Fitues i dy çmimeve në festivalin e filmit Kanë dhe kandidat për dy çmime OSCAR (2007).
- *"Takim me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale"*, në lidhje me shqetësimet, problemet, sugjerimet etj, gjatë semestrit të parë akademik. Ky takim u zhvillua me iniciativë të Znj. Enika Abazi (Dekane e Fakultetit të Shkencave Sociale UET), për të qenë sa më pranë studentëve.
- Që nga viti 2008 e në vazhdim aktivitete të tjera me studentët janë edhe *Tryezat e Rrumbullakëta* ose *"LECTIO"-t*. Këto takime kanë natyrë thelbësisht teorike. Ka një ndarje paraprake sipas fakulteteve apo çështjeve tematike, por pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve nuk kushtëzohet nga kjo ndarje. Si të tilla, në këto tryeza pritet të zhvillohen analiza teorike të koncepteve themelore bazuar në autorët dhe veprat më të rëndësishme të mendimit njerëzor. Universiteti si vendi ku përpunohet fraza dhe ligjëratat, e bashkë me to dhe aftësia për leximin e teksteve me kompleksitet të lartë teorik, vendoset përballë studentëve në këtë hapësirë konceptuale "tryezë e rrumbullakët".

Formati dhe aplikimi praktik i tryezave të rrumbullakëta:

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

1. *"Lectio Philosophia"*, në të cilën përgjithësisht trajtohen momente teorike të lidhura sidomos me filozofinë, por jo vetëm. Në këtë tryezë pjesëmarrës janë studentë nga të gjitha degët e studimit. Grupi i përhershëm përbëhet nga 25 studentë dhe 2 pedagogë. Në përputhje me temat dhe autorët ftohen edhe pedagogë referues dhe bashkëbisedues.
2. *"Lectio Politicus"*, në të cilën trajtohen teori dhe shkolla mendimi përgjithësisht të modernitetit dhe bashkëkohësisë, duke u integruar me aplikimet e tyre specifike në kontekste konkrete (vende, shtete, qeveri). Në këtë tryezë pjesëmarrës janë studentë nga degë të shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave të komunikimit. Grupi përbëhet nga 15-25 studentë dhe 2 pedagogë. Në përputhje me temat dhe autorët ftohen edhe pedagogë referues dhe bashkëbisedues, përgjithësisht nga Fakulteti i Shkencave Sociale.

e) Punësimi i të diplomuarve: aksesimi në tregun e punës dhe përputhja e tyre me këtë treg

Nëpërmjet mbajtjes vazhdimisht në vëmendje të zhvillimeve të tregut të punës, synohet të orientohet përmbajtja e kurrikulave që ofrohen, duke synuar përputhjen e tyre me dinamikën e tregut të punës.

Filozofia e UET-it në këtë drejtim ka qëllimin të lidhë sektorë të caktuar të tregut të punës me spektrin e studentëve që diplomohen, duke bërë të mundur njohjen dhe harmonizimin e kërkesës me ofertën.

Nëpërmjet planifikimit dhe organizimit të praktikave si pjesë e kurrikulave të programeve të studimit, synohet që studentëve t'iu mundësohet një njohje e drejtpërdrejtë dhe konkrete e tregut të punës, vendosja e kontakteve me institucione publike dhe private, si dhe me individët drejtues të tyre, duke u kujdesur që zhvillimi i këtyre praktikave të kryhet në institucionet që i përgjigjen më mirë fushës së studimit të studentit.

Pjesëmarrja në panairët e punës, krijimi i kontakteve nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet publike, si dhe me operatorët e sektorit privat, janë disa nga mënyrat që po përdoren për të informuar studentët dhe mundësuar aksesin e tyre në tregun e punës, në përputhje me kërkesat e tij.

Studentët e diplomuar do të nxiten, të pasurojnë më tej njohuritë akademike dhe aftësimin profesional, duke u dhënë mundësi të vijojnë studimet e ciklit të dytë dhe me vonë të tretë, duke u bërë kështu më kompetitivë në tregun e punës.

f) Informimi i studentëve me të drejtat dhe detyrat, programet mësimore, udhëzues të kurseve të studimit etj.

Informimi i studentëve në lidhje me programet e studimit dhe kurrikulat realizohet që në momentin e parë të kontaktit të tyre me stafin akademik dhe administrativ të UET-it, kur ata interesohen rreth mundësive për ndjekjen e studimeve në këtë institucion të arsimit të lartë; gjatë *javës së orientimit* në fillim të çdo viti akademik, si dhe përmes njoftimeve të vazhdueshme që shpallen nga Sekretaria ose Dekanatet dhe përmes faqes së internetit të UET-it.

Ndërkohë studentët janë të përfaqësuar në organet drejtuese të UET-it në tre nivele të ndryshme:

- 1- Në Senatin Akademik, ku ata përfaqësohen nga Presidenti i Këshillit Studentor.
- 2- Pranë dekanateve, ku çdo kryetar i këshillit studentor të fakulteteve përfaqëson studentët dhe merr pjesë në çdo mbledhje ku diskutohet dhe merren vendime në lidhje me procesin dhe programet mësimore.

3- Senatorët e Këshillit Studentor përfaqësojnë studentët pranë departamenteve përkatëse.

Duke marrë pjesë në çdo strukturë vendimmarrëse të universitetit studentët njihen me programin dhe me kurrikulat mësimore dhe gjithashtu bëhen pjesë e proceseve vendimmarrëse ose këshilluese sipas rastit.

Mbledhjet periodike të Këshillit Studentor që zhvillohen çdo muaj me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të njëjësive kryesore dhe/ose bazë, në lidhje me ecurinë e procesit akademik dhe me problematikën e hasur nga studentët, janë një mënyrë tjetër për të qenë sa më pranë interesave dhe kërkesave të studentëve.

Në çdo fillim semestri, studentët informohen për mënyrën se si është konceptuar dhe organizuar lënda pedagogu përkatës, i cili u vë në dispozicion një kopje të programit të lëndës. Ky program përmban informacion të detajuar për temat që do të zhvillohen gjatë 15 javëve të semestrit, format e kontrollit dhe vlerësimit, si dhe literaturën e detyrueshme, plotësuese dhe të rekomanduar.

Gjithashtu studentët informohen gjatë orëve të Tutoriatit dhe Këshillimit Akademik, ku ata mund të sqarohen për çdo paqartësi që kanë në lidhje me sistemin e studimeve dhe programin mësimor dhe mund të marrin asistencën e nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve të tyre.

g) Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programeve, të procesit të mësimdhënies dhe përfaqësimi i tyre në strukturat qeverisëse të UET-it

Gjatë periudhës 2006-2009, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore ka qenë një përpjekje konstante dhe e vazhdueshme. Studentët më aktivë dhe më të mirë në mbarim të vitit të parë dhe të dytë, përfaqësues të Këshillit Studentor, të rrjetit të bursistëve të UET-it, studentë të ardhur nga universitete evropiane e amerikane, apo dhe studentë në marrëdhënie pune që njohin nga afër tregun e punës, etj., janë përfshirë në gjithë etapat dhe fazat e diskutimit dhe miratimit të programeve.

Më konkretisht, përfshirja e tyre ka ndodhur në periudhën maj-qershor 2007 kur strukturat akademike si dekanatet, rektorati dhe senati analizuan programet specifike të Fakultetit Juridik dhe atij të Shkencave Sociale dhe propozuan ndryshimet dhe përmirësimet përkatëse për programet e studimit. Studentët janë angazhuar në diskutimet për përmirësime të mundshme në kurrikulat e vitit të tretë akademik 2008-2009. Po kështu në grupin special të punës të ngritur nga Rektorati për hartimin e programeve të reja Master të nivelit të parë (MNP) dhe Diploma të Nivelit të Dytë (DND) u përfshinë në mënyrë konstante edhe katër studentë përfaqësues nga tre fakultetet, si dhe një përfaqësues i Këshillit Studentor. Në mënyrë më të gjerë se kaq, janë organizuar dhe tre tavolina të rumbullakëta me përfaqësues të studentëve për të vjelë mendimin e tyre për nivelin e programeve mësimore bazë, për tekstet mësimore, librat bazë për lëndët kryesore formuese, si dhe përmbajtjen e silabuseve të pjesës dërrmuese të lëndëve.

Angazhimi i studentëve për të vlerësuar nivelin, përmbajtjen dhe cilësinë e mësimdhënies është zhvilluar në një masë shumë të gjerë. Gjatë pesë semestrave të zhvilluar deri tani, janë organizuar katër anketime masive me shumicën dërrmuese të studentëve për të marrë vlerësimet e tyre për përmbajtjen e programit dhe lëndëve të veçanta, metodat dhe metodologjinë e zhvillimit të mësimin, nivelin e komunikimit të pedagogëve, efektivitetin e literaturës së përdorur, cilësinë e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, eficientësinë e aktiviteteve plotësuese, etj.

Të gjitha të dhënat, të mbledhura duke ruajtur konfidencialitetin e studentëve, janë përpunuar dhe rezultatet e tyre janë bërë objekt i veçantë dhe i zgjeruar diskutimi në dekanate, Rektorat dhe Senat. Mbi bazën e rezultateve të këtij anketimi/vlerësimi masiv të studentëve janë marrë të gjitha masat e duhura si për të thelluar akoma më tej rezultatet e mira, ashtu dhe për të eliminuar të metat e vëna në dukje nga studentët. Në funksion të kryerjes sa më të mirë të këtij procesi ne vazhdojmë të përmirësojmë këtë lloj vlerësimi duke kërkuar vazhdimisht format dhe mënyrat më të mira për të evidentuar vlerësimin e studentëve dhe përfshirjen sa më reale të tyre në këtë proces.

Përfaqësimi i studentëve në strukturat qeverisëse është realizuar nëpërmjet përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në këto struktura. Konkretisht, Presidenti i Këshillit Studentor është anëtar i Senatit Akademik të UET, një përfaqësues tjetër i Këshillit Studentor është anëtar i Rektoratit, tre përfaqësues nga këshillat studentore të fakulteteve janë anëtarë të dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, një student është anëtar në Këshillin e Etikës, një anëtar i Këshillit Studentor është pjesëtar i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Rritja e partneritetit dhe konsultimi me studentët shprehet dhe në takimet e rregullta të Rektoratit dhe dekanateve me rrjetin e studentëve bursistë, me tavolinat e rrumbullakëta tematike që zhvillohen me grupe të zgjedhuara studentësh, takime periodike të rektorit dhe dekanëve me grupe studentësh, etj.

h) Dokumentacioni përkatës

1. Udhëzimi i pranimeve në UET dhe dosja e aplikimeve;
2. Dosja e kontratave të studentëve;
3. Udhëzimi dhe dosja e internshipit;
4. Udhëzimi mbi diplomat dhe dosja përkatëse;
5. Dosja e aktiviteteve shkencore, akademike, social-kulturore të zhvilluara;
6. Dosja/paketa e Javës së Orientimit;
7. Dokumente të përfshirjes së studentëve në veprimtarinë e UET-it.

IX. FASILITETET, BURIMET MATERIALE, LOGJISTIKA DHE SHËRBIME TË TJERA NDAJ KOMUNITETIT

a) Mjediset dhe asetet e duhura për kryerjen e procesit mësimor: sallat e leksioneve, laboratorët, mjetet e pajisjet për përgatitjen teorike dhe praktike

Sipërfaqja totale e godinës në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij UET-i është 5600 metra katror.

Në total, në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor janë 23 salla leksionesh dhe seminaresh. Konkretisht, ka 5 salla leksionesh me kapacitet prej 100 vendesh secila, 1 sallë leksionesh me kapacitet 200 vende, 1 laborator informatike me kapacitet 30 vende, 1 sallë seminaresh me kapacitet 20 vende, si dhe 15 salla seminaresh me nga 30 vende secila. Çdo sallë leksioni është e pajisur me tabela porcelani, flip charter, lidhje internet me dhe pa kabëll, kompjuter, video projektor, si dhe me sistem modern fonie fiks dhe të lëvizshëm. Numri maksimal i studentëve që mund të jenë në mësim në të njëjtën kohë është 1200.

Studentët janë pajisur me karta dixhitale studenti, të cilat përmbajnë të dhëna lidhur me identitetin, fakultetin, degën, ID e studentit, si dhe bar kodin, i cili mundëson përfitimin e shërbimeve që ofrohen në UET.

b) Lidhjet me internet, pajisje kompjuterike për stafin e studentët

Lidhja me internetin ofrohet në çdo PC në UET, me përjashtim të atyre në sallat të leksionit, ku nuk është parë e arsyeshme të ofrohet. Në shërbim të studentëve është një sallë kompjuterash, ku aktualisht ndodhen 74 të tillë, të lidhur gjithashtu edhe me një printer rrjeti. Aty qëndron vazhdimisht një person, i cili ndihmon studentët për printimet, si dhe i asiston për probleme të ndryshme që mund të hasen gjatë punës së tyre. Edhe në bibliotekë, krahas 2 kompjuterave për punonjësit, ndodhen edhe 5 kompjutera të tjerë në shërbim të studentëve, edhe këta të lidhur me internet. Gjithashtu në ambientet e UET-it ofrohet edhe Internet wireless falas për të gjithë studentët, si dhe për klientët që frekuentojnë lokalin BAR UET.

Zyrat e Administratorit, Rektorit, Dekanëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kancelarit, si dhe çdo zyrë tjetër e stafit drejtues dhe administrativ, janë të pajisura me PC dhe printer. Çdo pedagog i brendshëm ka një PC që e përdor vetëm ai. Për pedagogët e jashtëm ka një PC në çdo sallë pedagogësh, në tre të tilla që janë aktualisht, nga një për pedagogët e secilit fakultet. Zyrat e koordinatorëve pranë fakulteteve janë të pajisura me PC, ndërsa për printime përdorin printerat e rrjetit të pedagogëve. Sekretaria qendrore është e pajisur me një PC për çdo sekretare, si dhe tre printerat. Edhe zyra ku zhvillohet tutoriati dhe këshillimi akademik është e pajisur me 2 PC dhe një printer.

Sistemi kompjuterik mbrohet nga ndërhyrjet e jashtme me anë të një sistemi mbrojtës të fjalës së fundit të teknologjisë. Gjithashtu në çdo PC është instaluar *McAfee Antivirus*, i cili menaxhohet në mënyrë qendrore nga zyra e IT-së. Shërbimi *Email*, *Fileserver* dhe *Domain Controller* mbulohet me 3 servera, prodhim i fundvitit 2008. Dosja *My Documents* e çdo kompjuteri ruhet ne Server për arsye sigurie

Në total, në ambientet e UET-it janë rreth 163 kompjutera aktivë, 21 printerat, 2 fotokopje, 3 laptopë, 6 projektorë, 6 sisteme fonie, 3 TV, 2 Wireless Acces Points, etj.

c) Libraria, biblioteka dhe kapaciteti i tyre në raport me stafin dhe studentët

Libraria universitare dhe biblioteka janë pjesë e rëndësishme e infrastrukturës mësimore e shkencore të UET-it.

Libraria plotëson përgjithësisht nevojat bazë për tekstet e domosdoshëm mësimorë të përkthyer në shqip dhe leksionet e shumëfishuar që jepen në auditor nga pedagogët, si edhe nevojat për literaturë suplementare pothuajse për të gjitha lëndët që përfshihen në programet mësimore.

Biblioteka përmban një fond që pasurohet vazhdimisht me tekste mësimore, libra dhe periodikë shkencorë në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht dhe italisht), të cilët janë të domosdoshëm për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në programet e Diplomës së Nivelit të Parë dhe të Dytë si edhe në programet Master në të gjitha fakultetet e UET-it. Pjesa më e madhe e teksteve dhe monografive që përdoren si materiale bazë, apo rekomandohen në programet mësimore disponohen në disa kopje. Kur biblioteka e disponon një tekst bazë në një kopje të vetme, ai shumëfishohet përmes fotokopjimit dhe vihet në dispozicion të studentëve në sasi të mjaftueshme.

Biblioteka ka në fondin e saj mbi 1690 tituj librash (tekste, monografi, manuale, fjalorë, enciklopedi), një pjesë e madhe e të cilave disponohen në më shumë se 3 kopje, ndonjëherë edhe 5 ose 10 kopje. Këta tituj përfaqësojnë të gjitha disiplinat që përbëjnë programin akademik të UET-it në të tre fakultetet e tij. Numri i titujve të librave që disponohen dhe vihen në shërbim të stafit akademik dhe studentëve ka ardhur duke u rritur nga muaji në muaj. Për të përmbushur nevojat e stafit akademik dhe kërkimor-shkencor, biblioteka porositi vazhdimisht tituj të ndryshëm përmes shërbimeve në Internet si amazon.com dhe nga botues të ndryshëm në vende të ndryshëm të Europës dhe në Shtetet e Bashkuara.

Biblioteka e UET-it disponon gjithashtu një koleksion periodikësh shkencorë në fusha të ndryshme, në shqip dhe në gjuhë të huaj, një pjesë e të cilëve janë siguruar përmes abonimit vjetor e në vazhdimësi.

Për t'u ardhur në ndihmë sa më mirë studentëve dhe pedagogëve me literaturë (libra dhe revista akademike) të arkivuar në sistemet e bibliotekave elektronike *Questia* dhe *Jstor*, biblioteka mundëson shfrytëzimin falas të fondeve të këtyre sistemeve.

Për të vënë në dijeni stafin dhe studentët për titujt e rinj që i shtohen fondit të saj, biblioteka organizon periodikisht vitrinën e librit të ri.

Biblioteka qëndron e hapur 12 orë në ditë, me përjashtim të të dielave. Po aty studentët mund të printojnë apo të fotokopjojnë materialet përkatëse.

Në kuadër të Consorciut Universitar Shqiptar, në të cilin bëjnë pjesë: Universiteti European i Tiranës, Universiteti "Polis", Akademia e Filmit "Marubi" dhe Fakulteti i Drejtësisë "Luarasi", bibliotekat e tyre konsiderohen si asete për përdorim reciprok nga studentët që frekuentojnë këto institucione të arsimit të lartë.

d) Mbulimi i lëndëve e kurseve të studimit me literaturë shtesë nga fondi i bibliotekave qendrore apo të njësive (departamenteve)

Për të siguruar mbulimin e të gjitha disiplinave që zhvillohen në UET, biblioteka e këtij universiteti mban lidhje bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare, me bibliotekat e disa fakulteteve të Universitetit të Tiranës dhe të disa universiteteve jopublike. Kjo bibliotekë disponon listën e plotë të të gjitha botimeve (libra, tekste dhe monografi) që ndodhen në fondin e Bibliotekës Kombëtare, në bibliotekën e fakulteteve të drejtësisë dhe ekonomisë, në bibliotekën e Shkollës së Magjistraturës dhe në Librarianë Universitare, për fushat e ekonomisë dhe të drejtësisë, të cilat përbëjnë drejtimit e studimeve akademike në dy prej tre fakultete të UET-it. Për të përbushur nevojat e stafit pedagogjik dhe të studentëve Biblioteka e UET-it huazon libra dhe tekste nga bibliotekat e sipërpërmendura dhe e pasuron fondin e saj me botimet e domosdoshme për këtë qëllim.

e) Shërbime të tjera për studentët: salla studimi, fotokopje, printim, kërkim literature, shërbim informacioni, stafi i shërbimit etj.

Në ambientet e bibliotekës studentët kanë mundësi të studiojnë në qetësi dhe të rrethuar nga shumë tituj librash. Biblioteka ka një sipërfaqe prej rreth 300 metra katror, 6 poste pune me kompjutera për stafin dhe studentët, mundësi lidhje me internet jo-kabllor, si dhe 120 vende studimi. Në ndihmë të studentëve punon një staf i kualifikuar dhe me përvojë.

Për studentët ofrohet shërbimi i fotokopjes, i cili mundësohet nga dy pajisje të avancuara të markës Konica Minolta me një shpejtësi prej 120 faqesh në minutë, si dhe nga dy fotokopje Samsung me kapacitet më të vogël. Studentët asistohen nga një staf i specializuar për këtë proces.

Salla e kompjuterave është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga ora 9:00 e mëngjesit deri në 20:00 të mbrëmjes. Studentët kanë në dispozicion 80 poste pune me kompjutera të markës HP, model i 2008, internet pa limit të një cilësie shumë të mirë, si dhe printerat për të printuar materialet mësimore. Këtu ata asistohen nga një staf i specializuar.

Mjedis tjetër ku studentët mund të kërkojnë literaturën e nevojshme është edhe libraria e UET-it, e vendosur në katin e parë. Aty gjenden pjesa më e madhe e teksteve bazë, si dhe tituj të tjerë ndihmës.

Studentëve u ofrohet informacioni i nevojshëm nëpërmjet:

- Stafit, i cili përbëhet nga 3 sekretare, 5 koordinatorë, tre punonjës të bibliotekës, tre specialistë të IT-së, koordinatorja e zyrës së aktiviteteve, nga punonjësit e zyrës së financës, si dhe nga çdo anëtar i stafit drejtues dhe akademik.
- Rregullores, e cila i vihet në dispozicion studentit, si pjesë integrale e kontratës që lidh me UET-in. Nëpërmjet saj studentët njihen me mënyrën se si UET-i vepron, të drejtat dhe detyrimet përkatëse, si dhe me mënyrat se si funksionojnë marrëdhëniet mes palëve.
- Faqes zyrtare në internet, ku afishohen të gjitha njoftimet përkatëse, si dhe komunikimi nëpërmjet postës elektronike.
- Tabelave afishuese, ku shpallen njoftime të ndryshme; ka rreth njëzetë tabela të tilla.

Personeli administrativ dhe ai ndihmës mësimor përbëhet nga 39 vetë. Konkretisht, kancelari, sekretarja e përgjithshme, 3 sekretare, 5 koordinatorë, financierja, arkëtarja, specialistja e kurrikulave, specialistët e IT-së, punonjësit e bibliotekës, koordinatorja e zyrës së aktiviteteve, stafi i shtëpisë botuese UET Press,

punonjësit e sigurisë, përgjegjësi i godinës, specialisti i fotokopjes, punonjësja e librarisë, katër punonjëse sanitare dhe lulishtari.

f) Shërbime të tjera për stafin dhe studentët: mjedise sportive, çlodhëse, argëtuese etj.

Për krijimin e një ambienti sa më komod dhe funksional, në ambientet e UET-it ndodhet një bar, i cili ofron shërbimet bazë për plotësimin e nevojave të stafit dhe studentëve. Këto ambiente janë të hapura dhe pa pagesë për studentet dhe stafin në rastin kur ata zhvillojnë evenimente argëtuese.

Në shërbim të studentëve dhe stafit është edhe restoranti i shkollës, i cili ofron ushqim cilësor dhe me kosto relativisht të ulët. Në total këto ambiente kanë një sipërfaqe prej 500 metra katrorë dhe një kapacitet prej 160 vendesh.

Në mjediset përreth shkollës ofrohet parkim me një kapacitet prej 130 vende parkimi.

Në oborr, me një sipërfaqe prej 850 metra katror, gjenden mjedise të këndshme me gjelbërim të përhershëm, si dhe janë vendosur edhe shumë stola në funksion të stafit dhe studentëve.

Në katin e parë të godinës ndodhet holli, i përshtatshëm për qëndrim dhe çlodhje, ku nuk mungojnë pikturat apo fotografitë e ndryshme, shoqëruar me një dekor shumë funksional, të përshtatshëm për organizimin edhe të aktiviteteve dhe ceremonive të ndryshme.

g) Shërbime të tjera për komunitetin: informacion, marrëdhënie me publikun, shërbime për të tretë etj.

Universiteti Europian i Tiranës është angazhuar që në fillimet e tij për të luajtur një rol të rëndësishëm në shërbimet ndaj komunitetit. Këto shërbime ndahen në disa kategori kryesore:

1. Mbështetjen e studentëve nga shtresat më të pafavorizuara dhe të diskriminuara të shoqërisë. UET-i ka ofruar bursa të plota për studentë romë dhe ballkano-egjiptianë.
2. Mbështetjen e studentëve që kanë vuajtur pasojat e tragjedive familjare ose kolektive. UET-i ka ofruar bursa të plota për fëmijë të policëve të rënë në krye të detyrës, fëmijë jetimë ose fëmijë të familjeve në gjendje të vështirë ekonomike. Dy bursa të plota studimi janë ofruar edhe për fëmijë të familjeve të dëmtuara nga tragjedia e Gërdecit.
3. Mbështetjen ndaj shkollave të mesme në rritjen e kapaciteteve të tyre mësimdhënëse. UET-i ofron trajnime për mësuesit e shkollave të mesme në lidhje me përmbajtjen e lëndëve specifike, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe trajnime të përgjegjësve të shkollave të mesme për zhvillimin e karrierës. Ky shërbim ofrohet dhe realizohet falas për të gjithë shkollat e mesme të Tiranës.
4. Orientimin e maturantëve për të kuptuar sistemin e arsimit të lartë, Procesin e Bolonjës si dhe përputhjen e studimeve të larta me tregun e punës. UET-i ofron sesione orientimi me maturantët për qëllimet e mësipërme. Ky shërbim ofrohet dhe realizohet falas për të gjithë shkollat e mesme të Tiranës.
5. Sponsorizim i veprimtarive kulturore: ekspozita pikturë, fotografie dhe instalacioni në mjediset e tij, qoftë për studentë të tij, qoftë për krijues jashtë universitetit. Gjithashtu UET-i ka sponsorizuar veprimtari kulturore specifike.
6. Dhurim vullnetar i gjakut për fëmijët talasemikë. Ky dhurim realizohet një herë në vit, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.

h) Dokumentacioni përkatës

1. Inventari i UET-it;
2. Udhëzimi mbi Bibliotekën dhe inventari.

X. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

a) Burimet e financimit dhe statistikat e 5 viteve të fundit.

Veprimtaria e Shkollës së Lartë Universitare Private “Universiteti European i Tiranës” (UET) financohet nga shoqëria “U.E.T” shpk, e cila si burim financiar ka të ardhurat nga veprimtaria arsimore që ndahen në tre kategori:

- në të ardhura të vitit korent
- të ardhura të marra në avancë, si dhe
- financimi me anë të kredisë nga banka dhe interesat bankare.

Në tabelën më poshtë janë pasqyruar burimet financiare të UET-it, për secilin nga vitet akademike.

Tabela e burimeve financiare të UET-it

Ref.	Të ardhura	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Totali
1	Te ardhura nga studentet	8.917.454	56.790.772	189.764.886	255.473.112
2	Te ardhura nga interesat	17.448			17.448
3	Te ardhura ne avance	43.578.557	356.467.842	223.053.338	223.053.338
4	Financim nga kredi bankare		50.000.000	15.000.000	55.000.000
Totali		47.513.459	413.308.614	427.818.224	533.543.898

b) Përdorimi i burimeve financiare dhe skema e përdorimit të financave për pesë vitet e fundit

Burimet financiare të "U. E. T." sh. p. k. përdoren në funksion të plotësimit të misionit të UET-it, nëpërmjet zgjedhjes së një stafi akademik të aftë, krijimit të një infrastrukture moderne të mësimdhënies, si dhe pajisjen e universitetit me literaturën e nevojshme për mbarrëvajtjen e procesit akademik e kërkimor-shkencor. Këto zëra zënë peshën më të madhe të përdorimit të burimeve financiare, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela e realizimit të shpenzimeve

Ref.	Shpenzimet sipas zërave në Lekë	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Totali
1	Pagat e personelit	200.000	12.648.157	45.540.505	58.388.662
2	Personeli i Jashtëm	1.146.976	5.660.943	21.535.043	28.342.962
3	Sigurimet shoqërore	43.400	932.710	4.347.692	5.323.802
4	Qera objekti	1.254.600	6.302.115	10.584.900	18.141.615
5	Tatime dhe taksa të tjera	1.362.699	21.800	3.442.195	4.826.694
6	Shpenzime në pritje përcjellje	287.500	470.075	3.535.200	4.292.775
7	Nëntrajtime të përgjithshme (kancelari)	198.620	804.818	2.332.352	3.335.790
8	Postë / telefon (AMC)	499.193	5.003.304	7.123.795	12.626.292
9	Udhëtim dhe dieta	0	0	233.147	233.147
10	Shpenzime administrative	59.456	7.439.805	6.136.032	13.635.293
11	Energji, avull, ujë	0	0	3.654.804	3.654.804
12	Shpenzime të tjera (lëndë djegëse)	0	39.000	125.393	164.393
13	Instalim dhe mirëmbajtje interneti	156.400	383.616	761.276	1.299.492
14	Reklama dhe publicitet	2.423.410	8.097.055	11.301.542	21.822.007
15	Hartim spoti reklame	119.040	251.800	566.400	937.240
16	Transport	3.593	0		3.593
17	Shpenzime interesi	29.515	1.073.918	8.044.996	9.148.429
18	Amortizim	86.025	2.914.643	13.015.487	16.016.155
19	Gjoha, penalitete	40.000	0	457.884	497.884
TOTALI I		7.910.427	52.043.759	142.738.643	202.692.829
Lista e asetëve					
1	Libra (asete)	538.599	1.318.600	5.264.136	7.121.335
2	Pajisje të ndryshme (asete)	1.228.633	1.405.537	187.550	2.821.720
3	Instalime të ndryshme (asete)		8.320.649	14.034.292	22.354.941
4	Rikonstruksioni i ndërtesës		70.702.815	80.360.114	151.062.929
5	Pajisje zyre / informatike (asete)	3.495.055	28.611.762	44.412.458	76.519.275
TOTALI II		5.262.287	110.359.363	144.258.550	259.880.200
1	Tatim Fitimi	100.000	231.516	991.512	1.323.028

c) Shpenzimet për studentët dhe kostot e studimit për student për vit akademik

Në përputhje me misionin e “U. E. T.” sh. p. k., pjesa më e madhe e shpenzimeve janë realizuar për mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe krijimin e një komoditeti për studentët, sipas kërkesave bashkëkohore. Më poshtë janë dhënë të detajuara shpenzimet bazë në funksion të arritjes së misionit të UET-it. Gjithashtu është përcaktuar kostoja për një student, e cila është rritur në vitin pasardhës për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të studentëve. Këto janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Zërat	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Totali
1	Pagat e personelit	200.000	12.648.157	45.540.505	58.388.662
2	Personeli i Jashtëm	1.146.976	5.660.943	21.535.043	28.342.962
3	Sigurimet shoqërore	43.400	932.710	4.347.692	5.323.802
4	Qera objekti	1.254.600	6.302.115	10.584.900	18.141.615
5	Shpenzime në pritje përcjellje	287.500	470.075	3.535.200	4.292.775
6	Nëntrajtime të përgjithshme (kancelari)	198.620	804.818	2.332.352	3.335.790
7	Poste / telefon (AMC)	499.193	5.003.304	7.123.795	12.626.292
8	Udhëtim dhe dieta	0	0	233.147	233.147
9	Shpenzime administrative	0	7.439.805	6.136.032	13.575.837
10	Energji avull ujë	0	0	3.654.804	3.654.804
11	Shpenzime et tjera (lëndë djegëse)	0	39.000	125.393	164.393
12	Instalim dhe mirëmbajtje interneti	156.400	383.616	761.276	1.301.292
13	Reklama dhe publicitet	2.423.410	8.097.055	11.867.942	21.822.007
14	Hartim spoti reklame	119.040	251.800	566.400	937.240
	Totali i Shpenzimeve	6.329.139	48.033.398	117.778.081	172.140.618
	Nr. i studentëve për vit	175	589	1.354	1.354
	Kosto për studentë	36.166	81.550	86.985	

d) Shpenzimet për mësimdhënie, kërkim shkencor, administrim, pajisje etj.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve kryhet për të mbështetur mësimdhënien, kërkimin shkencor, krijimin e kushteve dhe ambienteve sa më komode për studentet, përkthimin e literaturës bashkëkohore dhe materialeve të rëndësishme për zhvillimin e procesit mësimor.

Nr	Zërat	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Totali
1	Pagat	1.390.376	19.241.810	71.423.240	92.055.426
2	Pajisje Zyre informatike	3.495.055	28.611.762	44.412.458	76.519.275
3	Blerje libra	538.599	1.318.600	5.264.136	7.121.335
4	Shpenzime administrative	2.367.978	16.923.545	35.852.704	55.085.205
5	Instalim dhe mirëmbajtje rrjeti interneti	156.400	383.616	761.276	1.306.292
6	Reklamë dhe publicitet	2.542.450	8.348.855	11.867.942	22.759.247
7	Kancelari	198.620	804.818	2.332.352	3.335.790
8	Qera	1.254.600	6.302.115	10.584.900	18.141.615
9	Shpenzime lëndë djegëse		39.000	125.393	164.393
10	Energji elektrike + ujë			3.654.804	3.654.804
11	Rikonstruksion ndërtesa		70.702.815	80.360.114	151.062.929
Totali		11.858.056	152.681.936	230.786.615	431.179.311

e) Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, auditimi dhe rezultatet.

Sipas ligjit, çdo vit kalendarik, bëhet mbyllja e bilancit, i cili paraqitet pranë zyrave përkatëse. Duke pasur parasysh që "U.E.T" shpk përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për vitet financiar 2007 dhe 2008 Raporti i Ekspertizës është kryer nga Z. Kostaq Pasha, Ekspert Kontabël i Autorizuar. Raportet Financiare gjenden pranë Zyrës së Financës dhe organeve përkatëse shtetërore.

f) Kapacitet menaxhuese financiare

Projekti financiar hartohet në muajin nëntor të çdo viti dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Për zbatimin e këtij projekti, Asambleja ka ngarkuar Kancelarin e UET-it. Për të gjitha blerjet dhe shitjet ka urdhra për sektorin e financës. Konsumimi i keshit bëhet vetëm me fatura të rregullta tatimore, lëvizjet bëhen me bankë për pjesën më të madhe të veprimeve. Asambleja e Ortakëve ka vendosur për veprimet financiare të çdo muaji, të bëhet auditimi i treguesve kryesorë financiarë. Në fund të vitit bëhet auditimi përmbledhës vjetor. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë që gjithmonë të ketë rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës, në mënyrë të tillë që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.

g) Dokumentacioni përkatës

1. Bilanci vjetor
2. Auditimi

XI. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

a) Kontrolli i brendshëm i cilësisë

UET-i ka plotësuar të gjitha strukturat drejtuese, si për sa i përket autoriteteve drejtuese, ashtu edhe organeve drejtuese, konform kërkesave të Ligjit Nr. 9741, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të datës 21.05.2007, i ndryshuar.

Dosja e pedagogut, e cila është plotësuar dhe ristrukturuar në paketën e re të emërtuar *Libri i pedagogut*, është një tregues shumë i rëndësishëm i vëmendjes që i është kushtuar informimit të pedagogëve në lidhje me standardet e cilësisë në mësimdhënie që synohen të arrihen, aspektet e vlerësimit të studentëve, transmetimin e filozofisë së UET-it, format e vlerësimit të pedagogut, si edhe elementë të tjerë me të cilët një pedagog përballet gjatë angazhimit në procesin akademik.

Filozofia e përqaftuar nga UET-i synon formimin e një studenti që:

- ka opinione të forta;
- di të argumentojë për këto opinione;
- di të ofrojë informacion për argumentet mbi të cilat mbështet opinionet e forta që zotëron.

Cilësia e mësimdhënies është objekt i një kontrolli dhe vlerësimi të vazhdueshëm, si nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar prej studentëve për të marrë mendimin e tyre në lidhje me mësimdhënien në të gjitha lëndët; sekretarisë mësimore, nëpërmjet ndjekjes së vazhdueshme të kryerjes së plotë të orëve mësimore; vlerësimit të drejtuesve, nëpërmjet kontrolleve gjatë zhvillimit të orëve të mësimi.

Të gjithë pedagogët kanë detyrimin të përmbushin standardet e kontrollit të njohurive të studentëve, përmes realizimit të provimit të ndërmjetëm, eseve/detyrave të kursit dhe provimit përfundimtar, në varësi të llojit të lëndës që zhvillojnë. Për këtë qëllim janë konceptuar dhe krijuar standarde të cilat lehtësojnë dhe ndihmojnë në rritjen e cilësisë së vlerësimit dhe kontrollit të dijes.

Për hartimin e programeve të lëndëve që janë pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format zyrtar, ku theksi është vendosur paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse. Duhet theksuar se konceptimi i programeve mësimore është i tillë që i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të gamës së gjerë të studentëve, të cilët kanë kapacitete dhe interesa të shumëllojshme.

Seminaret zhvillohen në mënyrë interaktive, me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë gjykime të vlefshme, të analizojnë situata dhe të marrin vendime të arsyeshme, të zgjidhin probleme, të arsyetojnë në mënyrë inteligjente, të formulojnë dhe realizojnë qëllime të caktuara.

Rëndësi e veçantë i është dhënë konceptimit dhe formatimit të eseve dhe detyrave të kursit, ku kërkohet që pedagogu të bëjë një vlerësim të detajuar dhe të argumentuar të cilësive të punimit të esesë, sipas komponentëve të zhvillimit të saj. Ky vlerësim i shërben studentit për të kuptuar se si mund të përmirësojë punën e tij. Sidomos në vitet e para të studimit, temat propozohen nga pedagogu për dy arsye kryesore: së pari, për t'i orientuar studentët në mënyrën se si duhet konceptuar një temë eseje, e cila të jetë e fokusuar

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

dhe e realizueshme; së dyti, për të minimizuar problemin e dorëzimit të eseve të gatshme, të shkruara nga vetë studenti ose të tretë për synime jashtë lëndës.

Thelbësore në suksesin e misionit edukues të UET-it është përkushtimi ndaj parimeve të integritetit akademik. Çdo anëtar i komunitetit universitar është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë. Studentët, si anëtarë të këtij komuniteti, janë përgjegjës për ndjekjen dhe respektimin e parimeve dhe frymës së Kodit të Integritetit të UET-it. Ky universitet është i vendosur të mbështesë standardet më të larta të integritetit, ndershmërisë morale dhe përgjegjësisë, të cilat janë baza e këtij institucioni. Ai pranon përgjegjësinë e tij për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm, pa diskriminim, të bazuar në meritat e secilit.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet qartësisë të studentëve, si për sa i përket çështjeve me karakter akademik, ashtu edhe atyre me karakter social; nxitjes së kuriozitetit intelektual, si dhe inkurajimit të studentëve për të përfituar nga mundësitë që ofrohen në UET, me qëllim që të bëhen vetë-udhëheqës të edukimit gjatë gjithë jetës, si dhe të aftësisë në vendimmarrje.

Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve të rëndësishme është edhe kërkimi shkencor, në përputhje me filozofinë, misionin e UET-it, interesat e tij, të stafit akademik dhe studentëve, si dhe me kapacitetet njerëzore dhe financiare që zotërohen. Kërkimi shkencor është institucionalizuar përmes krijimit të instituteve dhe grupeve të kërkimit.

b) Sistemi i brendshëm i menaxhimit të cilësisë

Sigurohet nëpërmjet (i) strukturave organizative të UET-it dhe (ii) Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC).

Të gjitha strukturat drejtuese (autoritetet dhe organet drejtuese), janë përgjegjëse për ndjekjen e përditshme të sigurimit të cilësisë nëpërmjet planifikimit, organizimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave drejt arritjes së vizionit të UET-it.

KSBC-ja, është ngritur me synim kryerjen periodike të vlerësimit të brendshëm të veprimtarisë së UET-it, publikimin dhe diskutimin e rezultateve të raportit të vlerësimit me stafin drejtues dhe njësitë kryesore dhe bazë, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së performancës në të ardhmen.

KSBC-ja vlerëson efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike, si dhe veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Ai përgatit *Dosjen e Vetëvlerësimit*, pjesë e së cilës është edhe Raporti i Vetëvlerësimit. Objekti i Dosjes së Vetëvlerësimit është që të paraqesë ecurinë e veprimtarisë së UET-it dhe të bëjë analizën e aspekteve e treguesve të rëndësishëm të kësaj veprimtarie, e cila bën të mundur evidentimin e pikave të forta, pikave të dobëta dhe perspektivën e zhvillimit të UET-it.

Ky komision ngrihet nën përgjegjësinë e Rektorit, pasi ky i fundit merr mendimin e Senatit Akademik. Ai përbëhet nga një strukturë organizative në të cilën parashikohet dhe shpërndarja e detyrave të anëtareve të tij.

c) Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Me qëllim rritjen e nivelit të cilësisë dhe shkallës së përgjegjësive për menaxhimin e cilësisë, është garantuar ndarja e qartë e roleve, përgjegjësive dhe kompetencave jo vetëm e organeve drejtuese, por edhe e autoriteteve drejtuese deri në nivel departamenti. Këto janë të shprehura në rregulloret dhe udhëzimet e UET-it, ku një numër i madh kompetencash dhe përgjegjësish u janë dhënë dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve.

d) Dokumentacioni përkatës

1. Udhëzimin mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë;
2. Urdhri i Rektorit për Grupin e Vetëvlerësimit;
3. Dokumente themelore të UET-it;
4. Dosja e vlerësimit të studentëve;
5. Dosja e vlerësimit nga Dekanët;
6. Regjistrat e sekretarisë për prezencën e pedagogëve.

XII. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun e tregun e punës

a) Bashkëpunimi kombëtar

i) Kontaktet dhe bashkëpunimi me IAL brenda vendit dhe koordinimi i aktiviteteve

UET ka kontakte me pothuajse të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë brenda vendit. Kontaktet bazohen mbi aktivitete në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh apo shumëpalësh, kontakte për shkëmbim eksperience që lidhet me botimet universitare, programet e lëndëve dhe kurseve të studimit, realizimin e kërkimit shkencor dhe botimeve, udhëheqje diplomash DNP, diplomash Masteri apo doktoratura, promovim librash, revistash e botimesh të tjera të kësaj natyre, shkëmbim reciprok pedagogësh, bashkëpunim ndërmjet bibliotekave, promovim librash e studimesh, etj.

Një bashkëpunim i veçantë dhe i gjerë realizohet me tre IAL të tjera të organizuara në kuadrin e Concorsiumit Universitar Shqiptar, të krijuar më 21 shtator 2007 konkretisht me IAL-të "Polis", "Luarasi" dhe "Marubi," të cilat së bashku me UET-in janë të organizuara në një konsorcium universitar.

Koordinimi i këtyre aktiviteteve bëhet nga Zyra e Aktiviteteve, në përputhje me planet e departamenteve, dekanateve dhe rektoratit të UET-it. Çdo aktivitet dokumentohet dhe ruhet në arkiv.

ii) Mobiliteti i stafit dhe studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobiliteti i stafit akademik të UET-it brenda sistemit të arsimit të lartë të vendit tonë, është realizuar deri tani nëpërmjet angazhimit të tij në dhënien e cikleve të shkëputura të leksioneve apo kurseve të plota në disa universitete të vendit si p.sh., në Universitetin "Fan Noli" në Korçë, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Tiranës, Polis, "Luarasi", etj.

Në bazë të një Rregulloreje të veçantë për transferimet dhe mobilitetin e studentëve, UET garanton mobilitetin dhe transferimin e studentëve nga/në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

iii) Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, qeveritare, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

UET-i si hallkë të parë të bashkëpunimit mes tij dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, ka aderuar dhe është një nga pjesët integrale të Consorciut të Universiteteve Shqiptare, të përberë prej institucioneve arsimore të konsoliduara në arritjet e tyre akademike, si Universiteti Luarasi, Akademia e Filmit Marubi, Universiteti Polis. Në aktivitetet e tij ky konsorcium bashkërendon aktivitetet akademike dhe shkencore dhe duke qënë një faktor aktiv në arsimin e lartë shqiptar, synon të jetë pjesë aktive në politikëberjen dhe rregullimin ligjor të kësaj fushe.

Pjesë e rëndësishme e aktiviteteve akademike të studentëve do të jenë dhe vizitat studimore në institucione publike e qeveritare, qendra kërkimore-shkencore, universitete dhe qendra të mëdha akademike, vizita në institucione ndërkombëtare jashtë vendit, etj. Në këtë kuadër po realizohet një vizitë

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

në disa universitete në Tetovë, Shkup e Prishtinë për studentët e vitit të parë, një vizitë në institucionet e Bashkimit Evropian në Bruksel, të Parlamentit Evropian në Strasburg, në Bankën Qendrore Evropiane në Frankfurt për studentët e vitit të dytë dhe një vizitë në institucionet e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Vjenë dhe Romë, etj.

UET-i mundëson me mjetet, ambientet dhe pedagogët e tij, organizimin e konferencave, takimeve, forumeve universitare dhe ndëruniversitare. Temat rreth të cilave janë mbajtur dhe do të mbahen këto konferenca, janë të një interesi të përgjithshëm, dhe kanë përfshirë një audiencë shumë më të gjerë se thjesht atë universitare. Pedagogë shqiptarë e të huaj, me reputacion akademik e shkencor, janë ftuar dhe kanë mbajtur konferenca dhe leksione të hapura, të cilat në më të shumtën e rasteve janë bërë pjesë integrale e programit akademik të studentëve të UET-it sipas fushave përkatëse.

Ambientet e UET-it kanë qenë e vazhdojnë të jenë të hapura për ekspozita pikturë e fotografie, koncerte apo shfaqje të tjera artistike, si dhe aktivitete të organizatave të tjera të një profili me interes për fushat e studimit që përfshihen në UET.

Prania e komunitetit të biznesit synohet të bëhet gjithnjë e më e ndjeshme pranë strukturave të UET-it, si pjesë e rëndësishme në hartimin e politikave, e diktuar kjo dhe nga pjesëmarrja e tyre në hallkat e rëndësishme drejtuese të universitetit. Komunikimi me këta operatorë të biznesit, bëhet përmes memorandumeve të bashkëpunimit, si marrëveshjet dypalëshe ku përfshihen krijimi i kushteve të zhvillimit të praktikave, punësim të mëtejshëm të studentëve të diplomuar, bashkëpunime në fushata sensibilizuese në çështje të interesit të përbashkët, etj.

Komunikimi bëhet në disa forma, si ato të kontakteve të drejtpërdrejta, përmes strukturave të UET-it siç janë Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Zyra e Aktiviteteve, por dhe atyre promovionale, prej Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, ku aktivitetet dhe kërkesat e UET-it për bashkëpunim do të njoftohen përmes medias së shkruar dhe televizive.

Përfshirja e përfaqësuesve të këtyre institucioneve në konferencat, tryezat e rumbullakëta, apo prania e tyre si lektorë në diskutime të temave të nxehta të momentit, është një qëllim tashmë i realizuar.

UET-i gjithashtu do të sigurojë lidhje në mes institucioneve, OJQ-ve lokale, Qendrave Rinore, Forumeve Rinore të subjekteve politikë, organizatave dhe shoqatave të tjera të interesit publik, përmes studentëve të tij, lidhje të cilat do të jenë një urë komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të studentëve dhe organizatave studentore me aktorët e lartpërmendur.

iv) Mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar dhe ata të punësuar

Për të qenë sa më afër realitetit dhe për të vlerësuar arritjet dhe vazhdimësinë e studentëve të diplomuar UET-i do të ndjekë një praktikë mbështetjeje dhe këshillimi për studentët e vet, duke filluar që nga informacioni i ofruar për gjendjen dhe sektorët e tregut të punës dhe duke vazhduar me praktikën mësimore.

Për të mbajtur statistika të sakta rreth ish-studenteve mbi vendndodhjen, gjendjen e punësimit, kryerjes së specializimeve dhe të kualifikimeve nga ana e tyre, UET-i ka hartuar formularë të veçantë, të cilët do të plotësohen nga studentët dhe informacioni do të përditësohet prej Zyrës së Karrierës dhe Punësimit, strukturë kjo që do të ngarkohet posaçërisht me monitorimin e këtij aktiviteti.

I diplomuari, do të nxitet të vërë në dispozicion të UET-it, informacione të tilla si:

1. punësimi aktual
2. kualifikime dhe specializime të mëtejshme
3. përditësimin e Curriculum Vitae me informacion të ri.

Synohet që të gjithë brezat e ish-studentëve të shërbejnë si pararojë e një gjenerate të përgatitur, që do të përçojë një frymë të re dhe do të shërbejë për të ngritur në nivele më të larta nivelin akademik të ofruar nga ndjekja e studimeve në institucionet arsimore të larta shqiptare. UET-i synon krijimin e rrjetit të ish-studentëve të tij, dhe për figurat më të spikatura mes tyre do të verë në dispozicion informacionin e duhur dhe do të mundësojë përfshirjen e tyre në vendimmarrje me synim ngritjen e nivelit akademik e shkencor të UET-it.

b) Bashkëpunimi ndërkombëtar

i) Implementimi i objektivave dhe aktiviteteve në kuadrin e procesit të Bolonjës

Objektivat dhe aktivitetet kryesore të UET-it orientohen dhe zhvillohen në përgjigje të kërkesave themelore të procesit të Bolonjës.

(1) Organizimi dhe strukturimi i kurseve të studimit është bërë mbi bazën e tre niveleve të diplomimit universitar, DNP, MNP, DND dhe së shpejti edhe MND dhe Doktoraturë.

(2) Lëndët që zhvillohen në të gjitha kurset e studimit janë të diferencuara në disa kategori, në përputhje të plotë me frymën e procesit të Bolonjës, të tilla si lëndë teorike dhe lëndë praktike, lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje, etj;

(3) Në themel të organizimit të cikleve dhe kurseve qëndron aplikimi i sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS), duke mbajtur parasysh ngarkesën me pikë krediti brenda dhe jashtë auditorit;

(4) Vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet nëpërmjet sistemit të kontrollit të vazhdueshëm që nënkupton kontrollin dhe vlerësimin nëpërmjet disa komponentëve, të tillë si: provimi i ndërmjetëm, eseja ose detyra praktike, niveli i aktivizimit dhe performancës në seminare, pjesëmarrja në leksione dhe provimi përfundimtar.

(5) Pa cënuar individualitetin dhe specifikat e çdo drejtimi të diplomimit, është bërë dhe ndërthurja e mjaft disiplinave në kurse të ndryshme studimi, duke garantuar një shkallë të lartë bashkëveprimi dhe integriteti në rang universiteti.

(6) Në përgatitjen e strukturës së lëndëve për çdo drejtim apo nivel diplomimi janë ruajtur gjerësisht karakteristikat themelore dhe objektivat specifike të tyre duke respektuar nivelin e studimeve, shkallën e natyrës teorike e praktike të lëndëve, ngarkesën, kombinimet dhe kushtëzimet ndërmjet tyre, etj.

(7) Numri i studentëve në seminare është ruajtur në nivelet 25-30 studentë/grup dhe për leksionet 90 studentë/grup.

(8) Lloji i diplomave dhe struktura e tyre është në përputhje të plotë me procesin e Bolonjës dhe legjislacionin shqiptar.

ii) Kontaktet dhe bashkëpunimi me institucione analoge ndërkombëtare

UET-i ka kontakte me disa institucione analoge ndërkombëtare si p.sh., Universitetin e Barit (Itali), Universitetin e Leçes (Itali), Universitetin Ekonomik të Athinës (Greqi); Universitetin e Thesalisë (Greqi), Universitetin e Tetovës (Maqedoni), Universitetin e Ankarasë (Turqi), CIHEAM-IAM Montpellier (France), Universitetin Paris 8 (Francë), Universitetin Paris 10 Nanterre (France), Universitetin e Gjenevës (Zvicër), Universiteti Riinvest (Kosovë), Universitetin "Via del Mar" (Kili), etj.

Me një pjesë të këtyre institucioneve ka filluar procedura e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok institucional me program dhe objektiva të përbashkëta disa-vjeçare. Me disa prej tyre janë realizuar shkëmbime pedagogësh, vizita studentësh, konsultime për lëndë dhe botime të ndryshme, konferenca të përbashkëta shkencore, etj.

iii) Pjesëmarrja ne programe europiane (Cards, Tempus etj) në pesë vitet e fundit

UET-i nuk ka akoma ndonjë angazhim apo pjesëmarrje në programe europiane (Cards, Tempus, etj.) Aktualisht është aplikuar në disa projekte të tilla europiane, në kuadrin e të qenit pjesë e grupeve universitare europiane.

c) Marrëdhëniet me tregun e punës

Për të qenë sa më afër kësaj problematike dhe për të marrë sa më tepër informacion, UET-i ka krijuar një strukturë të posaçme, e cila është e fokusuar vetëm në këtë proces, Zyra e Karrierës dhe Punësimit. Kjo strukturë grumbullon dhe vë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm për tregun e punës, si dhe për kualifikime të mëtejshme të ofruara nga institucione arsimore të larta, si ato për nivelin Master dhe Doktoraturë.

Për çdo student do të krijohet një dosje individuale, pjesë integrale e së cilës do të jenë:

1. Lista e notave të lëndëve të ndjekura gjatë studimeve universitare;
2. Vetëprezantimi i studentit;
3. Tema e Diplomës;
4. Çertifikata dhe dëshmi kualifikimi;
5. Curriculum Vitae nëse studenti ka pasur eksperiencë pune të mëparshme;
6. Informacione të momentit dhe kontaktet me studentët;

Kjo dosje do të plotësohet çdo moment me informacion të ri, në mënyrë që këta studentë të jenë gjithmonë pjesë e UET-it dhe të motivohen për arritje të tjera në fushat e aplikimit të tyre profesional. Për studentë e punësuar jashtë vendit, do të ofrohet informacion më specifik, duke përfshirë vendin në të cilin ky ish-student punon dhe jeton.

Të diplomuarit do të ftohen të marrin pjesë në aktivitetet akademike të organizuara nga UET-i, pasi ata me eksperiencën e tyre, mund të bëhen baze për të ngritur debate në këto aktivitete.

d) Marrëdhëniet me publikun dhe komunitetin në tërësi

Qysh nga zanafilla e tij, Universiteti European i Tiranës, përmes iniciatorëve, drejtuesve dhe gjithë stafit të tij akademik, ka qenë i pranishëm në faqet e medias së shkruar dhe asaj vizive, duke shprehur vazhdimisht dhe hapur mendimet e tyre rreth çështjeve, fenomeneve dhe situatave të caktuara që paraqiten në aktualitetin social-kulturor dhe arsimor në vend.

Për t'u përmendur është raporti intensiv i vendosur mes studentëve dhe medias, sidomos asaj televizive. Studentët e UET-it kanë përfaqësuar jo vetëm bindjet, opinionet dhe qëndrimet e tyre, por edhe të qindra bashkëmoshatarëve të tyre.

Anëtarë të stafit pedagogjik dhe stafit drejtues të UET-it, kanë qenë shpesh të pranishëm me fjalën e tyre në debatet rreth sistemit të Arsimit të Lartë në vend dhe situatave që krijojnë problematika e këtij argumenti, dhe në shumë raste ata kanë qenë aktorë kryesorë dhe iniciues të këtyre debateve mediatike dhe analizave të thella në shtyp, të cilat kanë ndezur menjëherë frymën e diskutimeve të gjata të opinionëve dhe argumenteve kundra dhe pro situatës.

Në aktivitetet e shumta të zhvilluara në UET, të cilat tashmë janë kthyer në një traditë të padiskutueshme, qofshin këto kulturore, sociale, apo akademike, përveç stafit të gjerë akademik dhe drejtues të UET-it, janë gjithmonë të pranishëm aktorët më në zë të fushave respektive, si dhe përfaqësues me emër të grupeve të interesit, të cilët vijnë jo vetëm nga institucionet e larta vendase, por edhe nga ata të huaja, për t'u bërë pjesë e paneleve të diskutimit që ngrihen në UET.

UET-i, përveç aktiviteteve të shumta që inician në funksion të grupeve të ndryshme të interesit, shoqatave, grupeve sociale dhe individëve në nevojë, merr pjesë gjithmonë në iniciativat tyre, si dhe kontribuon për zhvillimin arsimor dhe të interesave të tyre, duke akorduar bursa studimi dhe fonde financimi për to. Këtu përmenden bashkëpunimet e UET-it me Kryqin e Kuq Shqiptar, si dhe Shoqatën e Dhuruesve të Gjakut. Anëtarë të stafit tonë akademik dhe studentët janë bërë vazhdimisht pjesë e nismave për të ndihmuar familjet dhe individët në nevojë, si dhe kanë dhuruar gjak në fushatat e ndërmarra nga shoqata. Rast tjetër është edhe bashkëpunimi me Shoqatën e Jetimëve të Shqipërisë, dhe Shoqatën e Romëve, në funksion të së cilave janë vënë gjithmonë disa bursa studimi në secilin prej tri fakulteteve. Gjithashtu përmenden rastet e ndihmës përmes fondeve ndihmëse dhe bursave të studimit të akorduara për paraplegjikët, fëmijët e policëve të vrarë në krye të detyrës.

e) Dokumentacioni përkatës

1. Dosja e marrëdhënieve me MASH-in;
2. Dosja e shtypit;
3. Dosja e Consorciimit;
4. Dosja e bashkëpunimit me universitetet/institucione brenda vendit;
5. Dosja e bashkëpunimit universitete/institucione jashtë vendit;
6. Dosja e bashkëpunimit me shoqërinë civile.

XIII. Analiza SWOT

Mbas përfundimit të hartimit të Raportit të Vetëvlerësimit, në përputhje me udhëzimet e APAAL, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka evidentuar të gjithë elementët përbërës të një analize serioze SËOT, e cila pasqyron në mënyrë të përmbledhur gjendjen aktuale të IAL – Universiteti European i Tiranës – UET.

1. Oportunitete

- a) Sondazhet tregojnë se UET-i gëzon një imazh pozitiv dhe të mirë në publik, imazh të cilin synon ta përforcojë dhe të ndërtojë mbi të, të ardhmen e tij si Institucion i Arsimit të Lartë.
- b) Proceset integruese në të cilat është përfshirë vendi ynë, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit të UET-it me institucione brenda rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor.
- c) Kuadri ligjor aktual, bazuar në vullnetin politik përgjithësisht pozitiv ndaj institucioneve private të arsimit të lartë, përbën një mundësi të mirë që UET-i të konsolidohet dhe zhvillohet në të ardhmen.
- d) Tendenca në rritje e besimit të publikut ndaj sektorit privat të arsimit të lartë përbën një mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të UET-it.
- e) Fryma aktuale përgjithësisht konstruktive midis institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në vend, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijesh, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm.
- f) Stabiliteti i vazhdueshëm i vendit tonë, në të gjitha aspektet, shton mundësinë e kthimit gjithnjë e më të madh të “trurit”, duke krijuar mundësi për përzgjedhje të akademikëve dhe shkencëtarëve më të mirë dhe të atyre me perspektivë.

2. Rreziqe/Kërcënime

- a) Euforia e stafit drejtues të UET-it, për shkak të sukseseve të deritanishme, dhe shpërqendrimi i stafit akademik në realizimin e përgjegjësisë ndaj studentëve dhe klientëve përbën një rrezik për zhvillimin e UET-it si institucion i arsimit të lartë.
- b) Domosdoshmëria për diversifikimin e burimeve të financimit dhe mosmarrja e veprimeve konkrete në këtë drejtim, mbart rrezikun e asfiksimit të UET-it si institucion i vetëfinancuar në tregun shqiptar.
- c) Mosndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, rajon e më gjerë, dhe mosreflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat, programet e lëndëve, dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e UET-it, rrezikon të vendosë në vështirësi rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të UET-it.
- d) Moszbatimi i strategjive të përcaktuara (si pasojë e ngutjes dhe/ose vonesës) mund të ndikojë në ecurinë normale të jetës akademike në UET.
- e) Mosrespektimi i marrëveshjeve të nënshkuara dhe mungesa e vullnetit dhe përpjekjeve për thellimin e partneriteteve ekzistuese, apo për ndërtimin e partneriteteve të reja, çon në degradimin e misionit të UET-it dhe shndërrimin e tij në një kompani të thjeshtë biznesi.
- f) Ndryshimet e shpeshta dhe kategorike të kuadrit ligjor që ndikojnë negativisht veprimtarinë e shkollave të larta private përbën një nga rreziqet kryesore të konsolidimit dhe jetëgjatësisë së UET-it.

3. Anë të dobëta

- a) Ndryshimet në kurrikulat e ofruara nga UET, në zbatim të Udhëzimit Nr 15, datë 04/04/2008 “Për organizimin e studimeve në Institucionet publike të Arsimit të Lartë”, u shoqëruan me një periudhë intensive reflektimi, sqarimi dhe përshtatjeje për të gjithë stafin drejtues, atë akademik, personelin, si dhe për vetë studentët. Gjatë këtij procesi ndryshimi u vunë re edhe momente çorientimi e pasigurie.
- b) Ndërtimi i sistemit administrues (plotësimi i dokumentacionit rregullues për të gjithë veprimtarinë e UET-it) ka kaluar përmes një procesi dinamik ndryshimesh të herëpashershme. Megjithatë vlen të theksohet se, gjatë këtij viti akademik, është kryer një punë e madhe, ku është përfshirë gjerësisht stafi akademik, administrativ dhe studentët, për t'i dhënë një formë të plotë këtij sistemi.
- c) Raporti mes stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm (në favor të këtij të fundit), ndonëse brenda standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, nuk përputhet ende me vullnetin, filozofinë dhe synimet afatgjata të UET-it.
- d) Ndërtimi dhe funksionimi i departamenteve, deri në nivel seksionesh, ende nuk është i kompletuar plotësisht, kryesisht për shkak të moshës relativisht të re të UET-it.
- e) Pajisja e studentëve me karta studenti u bë e mundur vetëm në vitin e tretë të veprimtarisë së UET-it (2008-2009).
- f) Megjithëse faqja zyrtare e UET-it në internet është tepër funksionale, praktike dhe informative, përditësimi i saj nuk ndjek me të njëjtat ritme dinamikën e ndryshimeve në UET. Kjo për shkak se strukturimi i sistemit ka pak që ka përfunduar. Mbetet që këto ndryshime të pasqyrohen sa më shpejtë.
- g) Nevojitet dokumentim më i mirë me shkrim i komunikimit të brendshëm zyrtar në UET.

4. Anë të forta

- a. *Filozofia* e UET-it përmbledhet në një koncept të vetëm: *qasja analitike*. Misioni themelor është aftësimi i studentëve për të analizuar fenomene, ngjarje, koncepte, ligje, politika apo dukuri të caktuara. Produkti që UET-i synon të nxjerrë pas viteve të shkollimit është një student që ka tre karakteristika themelore: 1) ka opinione të forta, 2) di të argumentojë për këto opinione dhe 3) di të ofrojë informacion për argumentet mbi të cilat mbështet opinionet e forta që zotëron. Është ky produkt që do ta diferencojë studentin e UET-it nga studentët e universiteteve të tjerë, veçanërisht nga ata publike.
- b. *Strategjia e zhvillimit* të UET-it e përcaktuar në tre nivele: (1) *Strategjia afat-shkurtër (1-3 vjeçare)* që synon konsolidimin dhe garantimin e funksionimit të gjithë sistemit; (2) *Strategjia afat-mesme (3-5 vjeçare)* që synon zgjerimin e mëtejshëm të UET-it; (3) *Strategjia afat-gjatë (6-10 vjeçare)* që synon profilizimin e universitetit dhe fakulteteve të tij si: (a) universitet/fakultet i specializuar në lidhjet me biznesin dhe tregun e punës, dhe (b) universitet elitë në fushën akademike dhe shkencore.
- c. *Dokumentacioni i UET-it*: UET-i ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për funksionimin normal të tij konform kërkesave të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. I gjithë dokumentacioni përmbledhet në Broshurën e Dokumenteve Themelore.

- d. *Rekrutimi dhe cilësia e stafit.* UET-i i ka kushtuar rëndësi të veçantë cilësisë së stafit drejtues mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ. Synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve/klientëve nga të gjitha njësitë përbërëse. Kriteret bazë të rekrutimit të personelit akademik janë (i) eksperiencia në mësimdhënien universitare, (ii) grada e titulli shkencor i kandidatit për pedagog dhe (iii) aktiviteti kërkimor shkencor e botues i tij.
- e. *Mësimdhënia.* Qëllimi themelor në fushën e mësimdhënies është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter të theksuar praktik, duke realizuar ciklin «informacion-njohuri-dije-aftësi». Qëllimi bazë i mësimdhënies është përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të aftë që të debatojnë e marrin vendime të sakta, të aftë që të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.
- f. *Format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studenteve.* Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa indikatorëve, me synim vlerësimin e vazhdueshëm për ta vendosur studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit dhe ka natyrë stimuluese.
- g. *Kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik.* Në filozofinë e UET-it, kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik është në funksion të cilësisë së mësimdhënies. Ky është një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë akademike, i cili synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore, që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.
- h. *Kërkimi shkencor,* garanton pjesëmarrjen dhe aftësimin e pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor, angazhimin e tyre sa më të gjerë në botime e studime shkencore, organizimin periodik të konferencave shkencore nga çdo departament, botimin e katër revistave shkencore (“Polis”, “Jus & Justicia”, “Economicus”, “Sociological Analysis” (Studime sociologjike, në anglisht), botimin e monografive, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët, etj. Në UET funksionojnë institute e qendra të mirëfillta kërkimore-shkencore, si edhe grupe kërkimore. Të gjitha këto realizojnë vënien e rezultateve të kërkimit shkencor në shërbim të studentëve, procesit akademik dhe mbarë shoqërisë.
- i. *Përfshirja e studentëve në vendim-marrje.* Gjatë periudhës 2006-2009, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, ka qenë një përparësi konstante dhe e vazhdueshme. Studentët më aktivë dhe me rezultate të larta, përfaqësues të Këshillit Studentor, të rrejtësive të bursistëve të UET-it, studentë të ardhur nga universitete evropiane e amerikane, apo dhe studentët në marrëdhënie pune, të cilët njihin nga afër tregun e punës, janë përfshirë në të gjitha etapat e diskutimit dhe miratimit të programeve të studimit, kurikulave, si dhe në hartimin e dokumenteve themelore të UET-it.
- j. *Imazhi i mirë i UET-it në publik.* Sondazhe e organizuara nga vetë UET-i tregojnë se imazhi që ky institucion gëzon në publik është mjaft pozitiv. Ky imazh vjen si rezultat i punës cilësore në funksion të përmbushjes së misionit të UET-it.

- k. *Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë.* Cilësia e veprimtarisë së UET-it garantohej nëpërmjet një sistemi të brendshëm, të përbërë nga (i) strukturat organizative të UET-it dhe (ii) Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC). Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për ndjekjen e përditshme të sigurimit të cilësisë nëpërmjet planifikimit, organizimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave drejt arritjes së misionit të UET-it. KSBC-ja, është përgjegjëse për kryerjen periodike të vlerësimeve të brendshme të veprimtarisë së UET-it, publikimin dhe diskutimin e rezultateve të raportit të vlerësimit me stafin drejtues dhe njësitë kryesore dhe bazë, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të ardhmen.

Konkluzione

Me cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mund të themi se Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës, UET”, tashmë është pozicionuar midis institucioneve më serioze të arsimit të lartë të vendit e më gjerë.

Pavarësisht moshës relativisht të re, UET-i është duke ecur me hapa të shpejtë drejt konsolidimit si një institucion elitari i arsimit të lartë në vend, duke plotësuar me cilësi nevojat për dije në shërbim të shoqërisë.

Sidoqoftë, ky institucion ka nevojë të ndjekë përvojat më të mira në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të bashkëpunojë me institucione brenda dhe jashtë vendit, të behet atraktiv për studiuesit e shquar në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor brenda vendit, por jo vetëm, dhe të ndjekë nga afër të gjitha ndryshimet ekonomike, sociale e kulturore në Shqipëri e në mbarë botën. Vetëm kështu UET-i do të jetë në gjendje të garantojë gjithmonë e më shumë cilësinë e shërbimeve që ofron.

Emrat dhe Firmat e anëtarëve të Grupit të Vlerësimit

1. Dr. Tomi Treska – Kryetar (Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare)
2. Dr. Kreshnik Bello – Sekretar (Përgjegjës i Departamentit të Biznesit dhe Administrimit)
3. Elda Papa, MA – anëtar (Sekretare e Përgjithshme)
4. Dr. Nevila Xhindi – anëtar (DEBASKON - Këshilli i Ministrave)
5. Ervin Salianji – anëtar (Kryetar i Këshillit Studentor)
6. Migena Leskoviku, Doktorante – anëtar (lektore në Departamentin e të Drejtës Publike).

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

PJESA E DYTË: INFORMACIONE SASIORE

TË DHËNA PËR STAFIN AKADEMIK TË UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS, SIPAS VITIT AKADEMIK

Viti akademik 06-07		Statusi		Gjinia		Ngarkesa në orë mësimore/vit					Grupmosha						
Grada/Titulli	Nr.	I brendshëm	I jashtëm	M	F	<100	100-200	200-300	300-400	Mbi 400	Nen 25	25-34	35-44	45-54	55-64	65-68	Mbi 68
Prof. Dr.	3	1	2	3	0	2	1	0	0	0	0	0	0	2	1	0	0
Prof. Asoc.	3	2	1	3	0	1	1	0	1	0	0	0	3	0	0	0	0
Dr.	2	1	1	1	1	1	0	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
Lektorë	21	3	18	13	8	16	3	2	0	0	1	15	5	0	0	0	0
Totali	29	7	22	20	9	20	5	3	1	0	1	16	8	3	1	0	0

Viti akademik 07-08		Statusi		Gjinia		Ngarkesa në orë mësimore/vit					Grupmosha						
Grada/Titulli	Nr.	I brendshëm	I jashtëm	M	F	<100	100-200	200-300	300-400	Mbi 400	Nen 25	25-34	35-44	45-54	55-64	65-68	Mbi 68
Prof. Dr.	6	3	3	5	1	3	1	2	0	0	0	0	1	3	2	0	0
Prof. Asoc.	3	1	2	2	1	1	1	1	0	0	0	0	1	2	0	0	0
Dr.	11	5	6	9	2	7	2	1	0	1	0	3	5	3	0	0	0
Lektorë	52	10	42	28	24	40	6	2	3	1	2	28	15	4	2	0	1
Totali	72	19	53	44	28	51	10	6	3	2	2	31	22	12	4	0	1

Viti akademik 08-09		Statusi		Gjinia		Ngarkesa në orë mësimore/vit					Grupmosha						
Grada/Titulli	Nr.	I brendshëm	I jashtëm	M	F	<100	100-200	200-300	300-400	Mbi 400	Nen 25	25-34	35-44	45-54	55-64	65-68	Mbi 68
Prof. Dr.	11	1	10	9	2	5	4	1	1	0	0	0	0	6	3	0	2
Prof. Asoc.	9	3	6	5	4	4	3	2	0	0	0	0	1	6	2	0	0
Dr.	27	10	17	14	13	13	11	2	1	0	0	9	9	7	2	0	0
Lektorë	84	21	63	38	46	45	18	11	4	6	1	51	22	6	4	0	0
Totali	131	35	96	66	65	67	36	16	6	6	1	60	32	25	11	0	2

Të dhëna për stafin akademik sipas njësive kryesore dhe bazë/ VITI AKADEMIK 2006-2007

I. Fakulteti Juridik

Stafi akademik	E drejta civile				E drejta publike				Totali	F
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm			
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	0	0	1	0	0	0	1	0
As. Prof.	0	0	1	0	1	0	0	0	2	0
Doktorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lektorë	0	0	3	1	0	0	4	2	7	3
Totali:	0	0	4	1	2	0	4	2	10	3

II. Fakulteti i Shkencave Sociale

Stafi akademik	Deptamenti i Komunikimit				Departamenti Shkenca Politike dhe MN				Totali	F
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm			
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	1	0	0	0	1	0	2	0
As. Prof.	0	0	0	0	1	0	0	0	1	0
Doktorë	0	0	1	1	1	0	0	0	2	1
Lektorë	1	0	6	2	2	1	5	2	14	5
Totali:	1	0	8	3	4	1	6	2	19	6

TOTALI PER VITIN 2006-2007

I brendshëm									
Prof. Dr.		Prof. Asoc.		Dr.		Lektorë		Totali	Femra
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
1	0	2	0	1	0	3	1	7	1
I jashtëm									
Prof. Dr.		Prof. Asoc.		Dr.		Lektorë		Totali	Femra
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
2	0	1	0	1	1	18	7	22	8

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Të dhëna për stafin akademik sipas njësive kryesore dhe bazë/ VITI AKADEMIK 2007-2008

I. Fakulteti Juridik

Stafi akademik	Dept. i të drejtës së biznesit, civile dhe penale				Dept. i të drejtës publike dhe nderkombetare				Totali për Fakultetin					
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		Totali	F
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	0	0	2	0	0	0	2	0	0	0	2	0
As. Prof.	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0
Doktorë	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	2	0	2	0
Lektorë	0	0	13	4	1	1	4	1	1	1	17	5	18	6
Totali:	0	0	15	4	3	1	5	1	3	1	20	5	23	6

II. Fakulteti i Shkencave Sociale

Stafi akademik	Dept. i Komunikimit				Dept. i Shkencave politike & Marrëdhënieve ndërkombëtare				Totali për Fakultetin					
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		Totali	F
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	1	0	1	0	1	0	1	0	2	0	3	0
As. Prof.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Doktorë	1	0	1	0	2	0	1	0	3	0	2	0	5	0
Lektorë	2	0	12	8	5	3	10	4	7	3	22	12	29	15
Totali:	3	0	14	8	8	3	12	4	11	3	26	12	37	15

III. Fakulteti Ekonomik

Stafi akademik	Dept. Finance dhe Banka				Dept. Biznes dhe Administrim				Totali për Fakultetin					
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		Totali	F
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1	1	1	1
As. Prof.	1	0	1	1	0	0	0	0	1	0	1	1	2	1
Doktorë	2	1	1	0	0	0	1	1	2	1	2	1	4	2
Lektorë	0	0	2	1	2	1	1	1	2	1	3	2	5	3
Totali:	3	1	5	3	2	1	2	2	5	2	7	5	12	7

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

TOTALI PER VITIN 2007-2008									
I brendshëm									
Prof. Dr.		Prof. Asoc.		Dr.		Lektorë		Totali	Femra
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
3	0	1	0	5	1	10	5	19	6
I jashtëm									
Prof. Dr.		Prof. Asoc.		Dr.		Lektorë		Totali	Femra
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
3	1	2	1	6	1	42	19	53	22

Të dhëna për stafin akademik sipas njësive kryesore dhe bazë/ VITI AKADEMIK 2008-2009

I. Fakulteti Juridik

Stafi akademik	Dept. i të drejtës private				Dept. i të drejtës publike				Totali për Fakultetin				Totali	F
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm			
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	0	0	1	0	3	0	1	0	3	0	4	0
As. Prof.	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	2	0	2	0
Doktorë	1	1	2	0	1	0	3	2	2	1	5	2	7	3
Lektorë	3	1	3	3	3	3	6	4	6	4	9	7	15	11
Totali:	4	2	5	3	5	3	14	6	9	5	19	9	28	14

II. Fakulteti i Shkencave Sociale

Stafi akademik	Dept. i Komunikimit				Dept. i shkencave politike & Marrëdhënieve ndërkombëtare				Totali për Fakultetin				Totali	F
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm			
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	2	0	2	0
As. Prof.	0	0	1	1	1	1	0	0	1	1	1	1	2	2
Doktorë	4	3	0	0	2	0	2	0	6	3	2	0	8	3
Lektorë	3	2	12	6	6	2	14	8	9	4	26	14	35	18
Totali:	7	5	14	7	9	3	17	8	16	8	31	15	47	23

III. Fakulteti Ekonomik

Stafi akademik	Dept. Ekonomi dhe Finance				Dept. Biznes dhe Administrim				Totali për Fakultetin				Totali	F
	I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm		I brendshëm		I jashtëm			
	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F	Totali	F		
Profesorë	0	0	4	2	0	0	1	0	0	0	5	2	5	2
As. Prof.	2	1	3	1	0	0	0	0	2	1	3	1	5	2
Doktorë	0	0	10	7	2	0	0	0	2	0	10	7	12	7
Lektorë	2	2	24	9	4	2	4	4	6	4	28	13	34	17
Totali:	4	3	41	19	6	2	5	4	10	5	46	23	56	28

TOTALI PER VITIN 2008-2009

I brendshëm									
Prof. Dr.		Prof. Asoc.		Dr.		Lektorë		Totali	Femra
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
1	0	3	2	10	4	21	12	35	18

I jashtëm									
Prof. Dr.		Prof. Asoc.		Dr.		Lektorë		Totali	Femra
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
10	2	6	2	17	9	63	34	96	47

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

Viti akademik	Fakulteti/Dega	Vazhdojnë Studimet	Të çregjistruar	Të Shkëputur përkohësisht	Bursa	Të transferuar	Totali i te regjistruarve
2006-2007	JURIDIK	47	11	3	2	4	61
	M.P. Komunikim	32	5	4	5	3	41
	M. Ndërkombëtare	45	2	4	12	1	51
	SH.Politike	18	3	1	1	-	22
	SHK. SOCIALE	95	10	9	18	4	114
TOTALI		142	21	12	20	8	175
2007 - 2008	JURIDIK	154	21	4	10	19	179
	M.P. Komunikim	60	3	1	9	8	64
	M. Ndërkombëtare	49	4	1	4	8	54
	SH.Politike	41	2	-	4	12	43
	SH.SOCIALE	150	9	2	17	28	161
	Financë Bankë	46	2	-	2	1	48
	Menaxhim Biznesi	21	1	1	-	4	23
	Ekonomiks	2	1	-	1	-	3
	EKONOMIK	69	4	1	3	5	74
TOTALI		373	34	7	30	52	414
2008 - 2009	JURIDIK	172	5	-	25	8	177
	M.P. Komunikim	69	2	1	9	1	72
	M. Ndërkombëtare	71	2	-	6	5	73
	SH.Politike	36	-	-	8	4	36
	SH.SOCIALE	176	4	1	23	10	181
	Financë Bankë	224	2	-	9	6	226
	Menaxhim Biznesi	171	7	-	3	9	178
	Ekonomiks	3	-	-	-	-	3
	EKONOMIK	398	9	-	12	15	407
TOTALI		746	21	1	60	33	765
TOTALI UET		1 261	76	20	110	95	1 354

Pasqyrë e rezultateve për vitin akademik 2007-2008

VITI I PARE	Dega	U regjistruan në qershor		Kaluan në qershor		Kaluan në vjeshtë		Kalojnë në vit të dytë		Nota mesatare	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Qershor	Vjeshtë
	MPK	56	38	38	28	51	35	51	35	6.53	6.71
MN	47	27	26	17	42	25	42	25	5.93	6.23	
SHP	30	18	20	13	26	17	26	17	6.20	6.31	
TOTALI	<u>133</u>	<u>83</u>	<u>84</u>	<u>58</u>	<u>119</u>	<u>77</u>	<u>119</u>	<u>77</u>	<u>6.22</u>	<u>6.41</u>	

VITI I DYTE	Dega	U regjistruan në qershor		Kaluan në qershor		Kaluan në vjeshtë		Kalojnë në vit të tretë		Nota mesatare	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Qershor	Vjeshtë
	MPK	35	18	27	16	32	17	32	17	6.85	6.99
MN	45	27	41	25	44	27	44	27	6.65	6.74	
SHP	27	9	27	9	27	9	27	9	6.68	6.81	
TOTALI	<u>107</u>	<u>54</u>	<u>95</u>	<u>50</u>	<u>103</u>	<u>53</u>	<u>103</u>	<u>53</u>	<u>6.73</u>	<u>6.85</u>	

TOTALI V1 + V2	<u>240</u>	<u>137</u>	<u>179</u>	<u>108</u>	<u>222</u>	<u>130</u>	<u>222</u>	<u>130</u>	<u>6.63</u>	<u>6.76</u>
-----------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	--------------------	--------------------

Pasqyrë e rezultateve për vitin akademik 2007-2008

Viti i parë	<u>Kredite (Qershor)</u>						<u>Kredite (Vjeshtë)</u>				
	0-15	16-29	30-45	46-60	mbi 60		0-15	16-29	30-45	46-60	mbi 60
MPK	6	12	13	18	7		3	2	19	24	8
MN	10	11	11	10	5		5	0	20	17	5
SHP	6	4	6	11	3		4	0	10	7	9
Totali	22	27	30	39	15		12	2	49	48	22

Viti i parë	<u>Nota Mesatare (Qershor)</u>							<u>Nota Mesatare (Vjeshtë)</u>					
	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10		4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10
MPK	8	15	12	14	4	3		5	14	12	16	6	3
MN	17	10	7	4	8	1		13	9	11	5	6	3
SHP	7	8	9	1	3	2		7	5	12	1	3	2
Totali	32	33	28	19	15	6		25	28	35	22	15	8

Viti i dytë	<u>Kredite (Qershor)</u>						<u>Kredite (Vjeshtë)</u>				
	30-59	60-75	76-95	96-120	mbi 120		30-59	60-75	76-95	96-120	mbi 120
MPK	8	5	5	14	3		3	7	6	14	5
MN	4	5	9	22	5		1	4	11	18	11
SHP	0	2	4	12	9		0	2	4	10	11
Totali	12	12	18	48	17		4	13	21	42	27

Viti i dytë	<u>N.Mesatare (Qershor)</u>							<u>N. Mesatare (Vjeshtë)</u>					
	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10		4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10
MPK	9	6	1	7	3	8		7	8	1	7	4	8
MN	9	11	5	7	9	4		8	11	6	8	10	2
SHP	2	8	8	4	3	2		2	7	7	5	3	3
Totali	20	25	14	18	15	14		17	26	14	20	17	13

Fakulteti Juridik

Pasqyrë e rezultateve për vitin akademik 2007-2008

VITI	U regjistruan në qershor		Kaluan në qershor		Kaluan në vjeshtë		Kalojnë në vit të dytë/tretë		Nota mesatare	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Qershor	Vjeshtë
I parë	133	51	85	39	117	47	117	47	5.89	6.05
I dytë	62	28	50	26	58	27	58	27	6.22	6.37
TOTALI	<u>195</u>	<u>79</u>	<u>135</u>	<u>65</u>	<u>175</u>	<u>74</u>	<u>175</u>	<u>74</u>	<u>6.06</u>	<u>6.21</u>

	Kredite (Qershor)					Kredite (Vjeshtë)				
	0-15	16-29	30-45	46-60	mbi 60	0-15	16-29	30-45	46-60	mbi 60
Viti i parë										
Juridik	20	28	36	29	20	10	6	55	40	22

	Nota Mesatare (Qershor)						Nota Mesatare (Vjeshtë)					
	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10
Viti i parë												
Juridik	53	24	26	13	15	2	45	26	28	17	14	3

	Kredite (Qershor)					Kredite (Vjeshtë)				
	30-59	60-75	76-95	96-120	mbi 120	30-59	60-75	76-95	96-120	mbi 120
Viti i dytë										
Juridik	12	9	11	26	4	4	9	13	23	13

	Nota Mesatare (Qershor)						Nota Mesatare (Vjeshtë)					
	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10
Viti i dytë												
Juridik	21	10	13	6	7	5	17	12	13	7	8	5

Fakulteti Ekonomik

Pasqyrë e rezultateve për vitin akademik 2007-2008

Dega	U regjistruan në qershor		Kaluan në qershor		Kaluan në vjeshtë		Kalojnë në vit të dytë		Nota mesatare	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Qershor	Vjeshtë
F.BANKE	46	28	42	25	46	28	46	28	6.67	6.82
M.BIZNESI	23	12	19	10	20	10	20	10	6.52	6.60
TOTALI	<u>69</u>	<u>40</u>	<u>61</u>	<u>35</u>	<u>66</u>	<u>38</u>	<u>66</u>	<u>38</u>	<u>6.59</u>	<u>6.71</u>

Viti i parë	Kredite (Qershor)					Kredite (Vjeshtë)				
	0-15	16-29	30-45	46-60	mbi 60	0-15	16-29	30-45	46-60	mbi 60
F. Bankë	1	3	13	24	5	0	0	14	23	9
M.Biznesi	3	1	6	9	4	3	0	6	10	4
Totali	4	4	19	33	9	3	0	20	33	13

Viti i parë	Nota Mesatare (Qershor)						Nota Mesatare (Vjeshtë)					
	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10	4-5	5-6	6-7	7-8	8-9	9-10
F. Bankë	3	9	19	8	5	2	1	9	19	8	4	3
M.Biznesi	3	8	2	7	3	0	3	8	1	8	2	1
Totali	6	17	21	15	8	2	4	17	20	16	6	4

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR NË MBËSHTETJE TË VLERËSIMIT

Në Dosjen e Vetëvlerësimit përfshihen edhe dokumentet zyrtare ose jozyrtare, statute apo rregullore të funksionimit, dokumente apo materiale informative që UET-i ka prodhuar dhe nxjerrë për qëllimin e vlerësimit dhe që janë materiale të funksionimit normal të tij, si më poshtë vijon:

1. Auditi i institucionit;
2. Bazë të dhënash mbi veprimtarinë kërkimore – shkencore të stafit;
3. Bilanci vjetor;
4. Dokumentacioni i personelit akademik;
5. Dokumentacioni i takimit me të gjithë njësinë për njohjen me Raportin e Vetëvlerësimit;
6. Dokumente të përfshirjes së studentëve në veprimtarinë e UET-it;
7. Dosja e aplikimeve dhe e pranimeve;
8. Dosja e bashkëpunimit me shoqërinë civile;
9. Dosja e bashkëpunimit me universitetet/institucione brenda vendit;
10. Dosja e bashkëpunimit universitete/institucione jashtë vendit;
11. Dosja e Consorciumit;
12. Dosja e dokumenteve themelore të UET-it;
 - Udhëzim mbi Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore;
 - Udhëzimi dhe dosja e internshipit;
 - Udhëzimi i pranimeve në UET dhe dosja e aplikimeve;
 - Udhëzimi mbi Bibliotekën dhe inventari;
 - Udhëzimi mbi diplomat dhe dosja përkatëse;
 - Udhëzimi mbi Institutet dhe Qendrat e Kërkimit Shkencor dhe Planet e Instituteve;
 - Udhëzimi mbi politikat e kërkimit shkencor në UET dhe Plani i punës shkencore 2008-2009 dhe 2009-2010;
 - Udhëzimi mbi kriteret dhe procedurat e pranimit;
 - Udhëzimi mbi rekomandimin e literaturës;
 - Udhëzimi mbi Tutoriatin dhe Këshillimin Akademik;
 - Udhëzimi mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë;
13. Dosja e formularëve për zgjedhjen e lëndëve;
14. Dosja e kontratave i) akademike ii) joakademike;
15. Dosja e kontratave të studentëve;
16. Dosja e marrëdhënieve me MASH-in;
17. Dosja e orareve të mësimit sipas semestrave dhe viteve akademike;
18. Dosja e proces – verbaleve të mbledhjeve;
19. Dosja e proces verbaleve të provimeve;
20. Dosja e rekrutimeve të stafit;
21. Dosja e shtypit;
22. Dosja e trajnimeve në UET;
23. Dosja e trajnimit të APAAL
24. Dosja e veprimtarisë së qendrave;
25. Dosja e vlerësimit nga Dekanët;
26. Dosja e vlerësimit të studentëve;
27. Dosja/paketa e Javës së Orientimit;
28. Dosja e aktiviteteve shkencore, akademike, social-kulturore të zhvilluara;

UET - Raporti i Vetëvlerësimit

29. Formulari i përshtatjes së programit me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 15, Dt. 04/04/2008 "Për organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë";
30. Inventari i UET-it;
31. Libri i pedagogut;
32. Programet e kurseve të studimit;
33. Programet mësimore të lëndëve;
34. Regjistrat e sekretarisë për prezencën e pedagogëve;
35. Regjistri i amzës;
36. Regjistri themeltar;
37. Revistat shkencore dhe botimet e monografive, botimet në proces;
38. Rregulloret e programeve të studimit;
39. Statistikat për kalueshmërinë;
40. Strategjia e zhvillimit UET-it;
41. Tabela e burimeve njerëzore;
42. Tabela e shpërndarjes së lëndëve sipas pedagogëve;
43. Tabela e shpërndarjes së pedagogëve sipas lëndëve brenda programit të studimit;
44. Tabela përmbledhëse e cilësisë së stafit;
45. Urdhri i Rektorit për Grupin e Vetëvlerësimit;
46. Vendimet e Senatit për hapjen e fakulteteve, departamenteve, programeve të studimit, instituteve dhe qendrave.